Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 9 (137). SHTATOR 2017. *(Në qarkullim gjatë gjithë tetorit)* ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.

Profil

Sokoli, njeriu që gjeti suksesin te gurrat e Kovashicës

Nga **Osman Xhili**



7

Portret

Hasan Çipuri, profesori i terminologjisë ushtarake

Nga prof.as.dr. **Bernard Zotaj**



15

Botime

"Halil Alia" i Xhafer Martinit, një roman që sjell të vërtetën

Nga **Hysen Repa**



17

MBYLLET TENDERI PËR RRUGËN E ARBRIT. "GJOKA KONSTRUKSION" DREJT FIRMOSJES SË KONTRATËS

Oferta: 33,6 miliardë lekë

Paraqiten tri kompani; njëra rezulton fiktive, tjetra nuk paraqet ofertë financiare, ndërsa "Gjoka Konstruksion" formalisht me letra në rregull. Komisioni i ofertave po shqyrton dokumentacionin, 60 ditë afat për të dhënë vendimin.

Faqe 3



Lura, kjo Hirushe e harruar...

Reportazh nga Islam Çenga

NË BRENDËSI: ■ **Ç'kemi asaj Dibre** ■ Dibra në një muaj ■ **Xhemal Gjunkshi:** Dibrës i mungojnë mjekët, mësuesit, investimet publike... ■ **Almira Xhembulla:** Mirëpresim çdo nismë ligjore që e lehtëson zhvillimin rajonal ■ Hapet fondi **"Agim Shubleka"** për nxënësit e shquar të gjimnazit të Peshkopisë ■ **Kristo Frashëri:** Gollobordasit, me vullnetin e tyre kanë të drejtën të vetdeklarojnë kombësinë, por toka e Gollobordës është tokë shqiptare ■ **A do t'ia hiqni Dibrës** simbolin komunist Hero i Punës Socialiste? ■ **Të dashur** të rinj! ■ Për fe apo për atdhe thuri lavdi **Skënderbeu?** ■ Mbi përkatësinë etnike të **Vojsava Kastriotit** ■ **Hahn** në Kala të Dodës ■ Regjisori **Bajram Torba** vë në skenë "Fjala gdhend gurin" ■ **Variante** të këngës historike për luftën në Qafë të Kolesjanit ■ **Përse** ma dogje pyllin, të vraftë Zoti? ■ **Dafi Derti:** Dibra ka vlera dhe njerëz të mrekullueshëm ■ **Një herë në njëqind vjet** lind Dibra e Madhe... ■ **Ushtaraku** dhe intelektuali i gjurmëve të fisnikërisë ■ **Shaban Dervishi**, një jetë me krenari dhe dinjitet ■ **Rifat Asllan Vrenezi**, njeriu i sakrificave

Kërkohen korrespondentë në Peshkopi dhe Dibër të Madhe

Të interesuarit për korrespondentë/ menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.

Të interesuarit të shkruajnë email në adresën **<rrugaearberit@gmail.com>** ose të telefonojnë në numrin **069 20 68 603.**

Gazeta "Rruga e Arbërit" është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 9 (137). Shtator 2017
Gjendet në treg gjatë gjithë muajit tetor

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "ë".

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Editor i faqes online: Agim Deva

Korrespondentë të përhershëm:
Abdurahim ASHIKU
Osman XHILI
Alban TUFA
Hysen LIKDISHA
Samet ZAGRADI
Defrim METHASANI

Kontribuan për këtë numër:
Islam Çenga
bernard Zotaj
Hysen Repa
Almira Xhembulla
Xhemal Gjunkshi
Kristo Frashëri
Besnik Alku
Fejzulla Gjabri
Ahmet Çaushi
Murat Koltraka
Selman MEZIU
Hysen Kosovrasti
Metush SKEJA
Mevlud Buci
Faik Xhani

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t'i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t'i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Ç'kemi asaj Dibre!

Nga **BUJAR KAROSHI**



Bulevardi i ri. www.facebook.com/peshkopiaime

Sa herë mungoj, shqetësohet mileti. Kot shqetësohet, sepse dikur kemi pas thënë që: "Kur flet populli, politikanët heshtin". Ndërsa tani është: "Kur flasin politikanët, populli hesht". Dhe unë, si popull, heshta ca muaj! Heshta dhe pushova.

Meqë jemi te politikanët, zgjedhjet, siç e di, mbaruan. Në Dibër i mbaruam të qeta e të suksesshme. I kemi ndarë deputetet në mënyrën më të mirë të mundshme: tre burra e tre gra. Më mirë nuk ka. Nuk ankohen as femrat, burrat jo e jo!

Këto zgjedhje i bëmë më të mira se Amerika. Hashashin e lam, deputetët i kemi ndërruar, korrupsionin po e luftojmë, fletërrufetë i kemi rikthyer, udhëheqësit i janë kthyer muhabetit "gju më gju me popullin" - të paktën në foto, pushtetin po me popullin po e ndajmë. Ne na mbetet veç të jetojmë të lumtur e të gëzuar në Shqipërinë tonë buzë Adriatikut, që marshon drejt fitoreve të reja në Europën e përçarë.

Tani do thuash se nuk je dakord me mua, se deputetët janë bërë si ato që të qajnë ditën e të vrasin natën, por nuk ka problem. Për popullin e bëjnë!

Ka ca dyshime për manipulime andej nga Bulqiza, por nuk ka problem. Pak vota ishin, sa të kalojë stuhia dhe hajduti harrohet. Pastaj vijnë zgjedhjet e prapë hajduti kthehet, na vjedh edhe votën, edhe kokën, por prapë nuk ka problem. Nuk jemi të përjetshëm... Në fund të fundit, ne dele jemi, të tjerat i di qeveria...

Në Dibër bashkia bëri shumë punë të mëdha para fushatës, gjatë fushatës shumë dhe tani pak më pak. Punët thonë se i bënte bashkia, por reklamën ia bënte PDIU-ja...

Zjarret, si gjithmonë, edhe këtë verë nuk munguan në Dibër. Jemi mësuar me to, rrimë që rrimë, ia vendosim një shkrepëse malit... Të paktën, dalim në lajme...

Dhe kur "hyjmë në lajme", nuk kemi të ndalur për të dalë... Hyjmë në lajme se kryefamiljarët e një katundi ndiqen penalisht pse kërkojnë një të drejtë që u takon me ligj e zakon, hyjmë në lajme se shoku vret shokun, por hyjmë në lajme edhe se vramë një arushë dhe, pasi e vramë, "ia nxorëm erzin", duke e shëtitur nëpër katund. Pastaj u justifikuam se na "kishte ngrënë misrin". Por, të kishte arusha "kallashnikov", na kishte vrarë të gjithëve që ia premë pyllin dhe, pasi ia premë, i vumë edhe zjarrin.

Arusha dhe derrat bënë dëme të mëdha edhe andej nga Dibra në arat me grurë e kosheret me bletë. Këto të egrit dalin andej nëpër fshatrat përreth Dibrës së Madhe, sepse, këndej kufirit, nuk ua mban. Këtu i presin kushërinjtë e tyre me dy këmbë, me çarkun ngritur e çiften gati...

Nga Dibra e Madhe ziente kësaj vere problemi i deponisë dhe ujit. Çdo verë e njëjta histori, zjarri në deponi, ajri i pistë dhe mungesa e ujit në shtëpi. Çdo vit dihen përgjegjësit, por historia vazhdon. Atje në Dibër e kanë gjetur zgjidhjen kur vjen puna te problemet. Bazuar të parulla: "Ti moj Dibër mos ki frikë, se ke djemtë në Amerikë", iu drejtuan për ndihmë financiare dibranëve të Amerikës për të blerë një buldozer... Dhe përgjigja erdhi: "Ti moj Dibër kij pak frikë, ua morët shpirtin djemve n'Amerikë". Të njëjtin problem e kishte dhe Struga. Por atje u zgjidh brenda ditës...

"Ujë, ujë, ujë" - ka bërtit mileti gjithë verës edhe këndej në "Dibër të Vogël - siç thuhet tani, por kuçedra nuk don me e l'shue... "Nuk e l'shoj, jo, i kishte thanë dikujt, se nuk kam ka ta l'shoj. Shtroni tubat e pastaj m'thoni". Po rropatet deputetja e re ta zgjidhë këtë punë në takime nëpër zyra, por prapë ujë nuk ka...

Meqë ujë nuk ka e punë jo se jo, kemi gjetur një punë të re: ndërrojmë zyra dhe ndërrojmë mësues.

E mbani mend gjimnazin e Peshkopisë? Mos thoni jo, se u mburrët që godinën nga gjimnaz, e kthyem në universitet. Pastaj universitetin e mbyllëm dhe godinën po e kthejmë në... zyra për bashkinë. Ndërsa nxënësit i kemi nxjerrë jashtë qytetit dhe shkollat i kemi me dy turne... Kot që nuk i mbyllim, se nuk ka kujt i duhen. Sepse të bëhesh zyrtar e arsimtar sot është shumë kollaj, në vend të shkollës duhet të shkosh te tregu... ta blesh një diplomë. Pastaj kemi mësues diplomablerës analfabet që zëvendësojnë mësuesit me 34 vite punë...

Ah, se harrova, hymë edhe në "gojë të Lolitës", pasi në restorant peshku "porosajtëm grosh Muhurri ene jufka të ftajrme hollë"...

Andej nga Dibra e Madhe, pasi zgjidhëm problemin e deponisë, i jemi kthyer zgjidhjes së zgjedhjes së kryekomunarit. Dhe kandidatët mbetën duke u takuar së bashku, në emisione, në kafe e në fund në rrugë... Ata të gjithë e dinë se si do shkojnë zgjedhjet, por sidoqoftë komedia duhet luajtur... Dhe me takimet e përbashkëta në shesh, akti konsiderohet i suksesshëm.

Pyetjet për kandidatët i bëjnë vetëm ata që kanë të mbushin barkun dhe nuk kanë ku çojnë lekët. "Kush je tëj të bujsh pitje, tej s'ke bukë të ashë en s'ke dinar në xhep", i tha një sejmen i një kandidati një qytetari të varfër... Ama, të varfrit që nuk kanë një dinar në xhep, nuk kanë të drejtë me fol, por votën kanë të drejtë me e hedhë te "partia jonë".

Për rrugën mos pyet... Tenderi u bë, të tjerat i di qeveria. Në mos filloftë këtë vit, me siguri vitin tjetër. Në mos në janar, me siguri në shkurt a në maj. Sipas motit...



Diku akollas... *Bulevardi i ri. www.facebook.com/ketumblidhendibranet*

kryesore

Hapen ofertat. "Gjoka Konstruksion" drejt firmosjes së kontratës

Nga shqyrtimi paraprak i Propozimit Financiar rezultoi se operatori ekonomik shoqëria "Gjoka Konstruksion" sh.a kishte propozuar si vlerë projekti shumën prej 33,6 miliardë lekë



Paraqiten dy kompanit; njëra rezulton fiktive, ndërsa tjetra nuk paraqet ofertë financiare. Komisioni i ofertave po shqyrton dokumentacionin, 60 ditë afat për të dhënë vendimin.

Nga **BUJAR KAROSHI**

Kompania "Gjoka Konstruksion" drejt finalizimit të kontratës për ndërtimin e Rrugës së Arbërit. Pas hapjes së dokumentacionit të tenderit më 2 tetor në mjediset e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, rezultoi se kompania e vetme që ka plotësuar dokumentacionin dhe ka dhënë një ofertë financiare është "Gjoka Konstruksion".

Në njoftimin e publikuar nga Ministria thuhet se "Komisioni i dhënies me koncesion të procedurës me objekt "Përmirësimi, ndërtimi, operimi dhe mirëmbajtja e Rrugës së Arbrit", nga shqyrtimi i sistemit elektronik rezultoi se kishin shprehur interes tre operatorë ekonomikë. Dy nga këto kompani kishin mangësi në dokumentacion, ndërsa "Gjoka Konstuksion" sh.a kishte paraqitur gjithë dokumentacionin e kërkuar.

"Operatori ekonomik "Adem Pojani", nga shqyrtimi paraprak i sistemit, rezultoi se kishte paraqitur disa dokumente, të cilat nuk rezultojnë të mjaftueshme për t'u konsideruar ofertë zyrtare", thuhej në njoftimin e Ministrisë. Gjithashtu, edhe "operatori ekonomik shoqëria "Alb-Star" sh.p.k., nga shqyrtimi paraprak i sistemit, rezultoi se kishte paraqitur disa dokumente, por nuk u konstatuan të dhënat e ofertës financiare". Ndërsa "operatori ekonomik shoqëria "Gjoka Konstruksion" sh.a; nga shqyrtimi paraprak i sistemit, rezultoi se kishte paraqitur dokumentacionin teknik, financiar dhe ligjor si dhe kishte paraqitur Propozim Financiar. Nga shqyrtimi paraprak i Propozimit Financiar rezultoi se operatori ekonomik shoqëria "Gjoka Konstruksion" sh.a kishte propozuar si vlerë projekti shumën prej 33,6 miliardë lekë."

Njoftimi i Ministrisë nuk jep hollësi të mëtejshme, por thekson se për dhënien e një vendimi përfundimtar "në përputhje me përcaktimet ligjore, brenda afatit ligjor 60 ditor, komisioni do të kryejë shqyrtimin e plotë dhe të detajuar të ofertave të paraqitura dhe do të dalë me vendimmarrjen përkatëse".

KUSH JANË OPERATORËT E PËRFSHIRË NË TENDER?

Nga tre operatorët ekonomikë që janë paraqitur në tender, duket se vetëm "Gjoka Konstruksion" është e interesuar për procesin, pasi dy kompanitë e tjera, njëra nuk ka lidhje me fare me infrastrukturën rrugore, ndërsa tjetra nuk ka paraqitur një ofertë financiare.

"Adem Pojani", sipas ekstraktit historik të QKR, është një biznes që merret me "Servis automjetesh". Që prej shtatorit të vitit 2016 pajisjet e tij janë vendosur në "sekuestro konservative", pasi nuk ka shlyer detyrimet ndaj OSHEE. Ndërsa aktualisht nuk ka asnjë licencë aktive.

Për shoqërinë tjetër "Alb-Star" nuk dalin të dhëna nga regjistri tregtar i Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, por nga faqja e saj në internet, mësojmë se është një kompani që operon në fushën e infrastrukturës, inxhinierisë dhe ndërtimeve civile. Është themeluar në vitin 1995 në Fier, ku vazhdon të ushtrojë veprimtarinë kryesore. Kompania është e specializuar në fushën e projektimit të punimeve civile dhe industriale dhe ka një veprimtari të gjerë në të gjithë vendin, si dhe është e pranishme edhe në rajon. Ajo ka bashkëpunuar me disa financues të huaj dhe shtetërorë, si Banka Botërore, Grupi bankar gjerman Kfw, Programi Phare, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Qeveria Holandeze, Delegacionit Evropian, qeveria shqiptare etj., në ndërtime ujësjellësash, kanalizime, rrugë etj.

"Gjoka Konstruksion", pas dështimit të negociatave me kompaninë kineze, e cila kishte shfaqur interes për ndërtimin e Rrugës së Arbrit, dha një ofertë të pakërkuar në prill të këtij viti. Qeveria shqiptare i dha 10 pikë bonus, duke e favorizuar kompaninë, e cila, duke u mbështetur edhe në projektin e investimeve të qeverisë shqiptare "1 miliardë për rindërtim", duket se është e favorizuar për të nisur punimet.

Sipas faqes në ëeb të kompanisë, ajo është krijuar në vitin 1994 nga Rrok Gjoka, i cili është pronari i vetëm dhe përfaqësuesi ligjor i kompanisë.

"Gjoka Konstruksion" sh.a. e konsideron veten si një ndër kompanitë që ka vendosur standarde në fushën e ndërtimit në Shqipëri. Sot është një ndër kompanitë më të mëdha në vend. Ata kanë ndërtuar rrugë, autostrada, ura, tunele, hidrocentrale, infrastrukturë ujore, ndërtesa banimi etj.

Kompania ka realizuar disa investime publike në Dibër si rrugën Shulbatër-Gurrë, disa segmente të Rrugës së Arbrit, ujësjellësin e fshatrave të Melanit, si dhe disa rrugë të tjera kombëtare si në Sarandë, Fier, Tiranë etj. Është një ndër kompanitë që po realizo investimet në Ujësjellësin e Tiranës, si dhe ka një bashkëpunim edhe me projektin TAP.

* * *

Ky tender është i pari që parashikon ndërtimin e gjithë segmentit të mbetur të Rrugës së Arbrit si dhe dy akseve lidhëse me Peshkopinë dhe Klosin. Sipas dokumentacionit të paraqitur në tender nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, kompania fituese do të rishohë një plan tërësor të rrugës, duke rritur parametrat e rrugës dhe sigurinë e saj. Kompanisë do t'i lejohet të marrë nënkontraktor për realizimin e punimeve, por kjo gjithmonë do të kryhet me miratimin e qeverisë.

Megjithëse në terma bëhet fjalë për një koncesion, qeveria shqiptare akoma nuk ka vendosur nëse rruga do të jetë me pagesë apo ndërtimin e saj do ta përballojë nga buxheti i shtetit.

Sipas dokumentacionit të tenderit, periudha e koncesionit parashikohet të jetë 13 vjet, duke filluar nga nënshkrimi i kontratës.

TË DHËNA MBI PROJEKTIN.

Autoriteti Kontraktues ka përfunduar analizat e mëposhtme, raportet e të cilave janë vënë në dispozicion për Ofertuesit e Mundshëm në Faqen Virtuale të të Dhënave:

Rruga e Arbrit është: (i) përfunduar plotësisht në 20.12 km, (ii) përfunduar pjesërisht në 15.175 km, si dhe (iii) ka një projekt ekzistues edhe për 26.372 km. Në total janë 61.667 km të projektuar për gjurmën kryesore me standardin C3, nga të cilët 26.372 km nuk janë prekur me punime ndërtimi. Sipas Studimit te fizibilitetit te hartuar rreth vitit 2005 e gjithë gjurma Tiranë-Bllatë sipas këtij varianti pritet të jetë afërsisht rreth 73.5 km e gjatë, çka do të thotë që afërsisht ne total 11.8 km rrugë janë ende të pa projektuar (gjatësi ne skajin e lidhjen me Tiranën dhe gjatësi në skajin e lidhjes me Blladën - pika kufitare).

Në këto kushte Projekt Ideja për "Përmirësim, Ndërtim, Operim, dhe Mirëmbajte e Rrugës se Arbrit" për kompletimin e të gjithë gjurmës së Rrugës së Arbërit qe përfshin: projektet e segmenteve të pa projektuar(skajet lidhëse) , përmirësimin e projekteve të segmenteve ku punimet janë ende të papërfunduar me synimin e përmirësimit të tyre nga standardi C3 te standardit te vitit 2001 në atë C2 sipas standardit te vitit 2015, përmirësimin e projekteve të zbatimit për segmentet ku ka projekt zbatim por qe nuk është ndërtuar duke përmirësuar standardin C3 te rrugës sipas standardit te vitit 2001 në atë C2 sipas standardit te vitit 2015 dhe mirëmbajtjen e segmenteve te ndërtuara.

Ne projekt ide, të nxitur nga rëndësia që ka segmenti Zall Bastar-Dalja e Urës së Vashës, që është sa 1/3 e të tërë Rrugës së Arbrit është studiuar dhe projektuar sipas standardit C2 te vitit 2015 ku është projektuar edhe lidhja e Rrugës së Arbrit me Klosin. Ne projekt ide është marr ne konsideratë distance kohore më e shkurtër, siguria e kërkuar në tunele, pasi parashikon edhe një tub emergjence, krahas atij kryesor dhe aksesi me i shpejt i rrugës nga banoret e Matit përmes lidhjes me Klosin. Kështu, në Projekt Ide, Rruga e Arbrit nga Tirana deri në Bllatë skematikisht në mënyrë të njëpasnjëshme është e ndarë në 8 segmente si më poshtë:

Segmenti 1, fillon në dalje të Tiranës, aty ku mbaron rruge ekzistuese, dhe përfundon tek Ura e Brarit, aty ku kane filluar punimet për ndërtimin e rrugës. Gjatësia e tij është 1.153 km.

Segmenti 2 : Ura e Brarit - Zall Bastar, me L = 5.46 km.

Segmenti 3: Zall Bastar – Dalja e Urës së Vashës, sipas projekt idesë eshte me gjatësi L = 23.188 km.

Segmenti 4: Dalja e Urës së Vashës – Bulqizë, me gjatësi L = 9.715 km.

Segmenti 5: Bulqizë-Ura e Çerenecit, me L = 20.12 km, i përfunduar në v. 2009 dhe 2011.Nuk është pjese e Projekt Idesë.

Segmenti 6: sipas studim-projektim qe lidh Urën e Çerenecit me rrugën Maqellarë-Pika kufitare Bllatë. Gjatësia e tij është L = 9.111 km.

Segmenti D (7): Për të plotësuar nevojat e trafikut të ardhshëm, rruga ekzistuese Maqellarë-Pika kufitare Bllatë duhet të rikonstruktohet në standardin e një rruge urbane për shpërndarjen e të tërë trafikut të Rrugës së Arbrit në Drejtim të Peshkopisë (Maqellarë) dhe Maqedonisë (Pika kufitare Bllatë).

Segmenti K (8) është degëzimi Dalje Ura e Vashës - Klos (Segmenti K) me L = 3.092 km.

Projektet e segmenteve 1 deri 6 (pervec segmentit 5-qe nuk është pjese e Projekt Idesë) janë hartuar sipas Standardin C2 të Manualit për Projektimin e Rrugëve Shqiptare – MPRrSh 2 – Projektimi Gjeometrik (viti 2015). Ky standard kënaq kërkesat që burojnë nga Studimi i Fizibilitetit për Rrugën e Arbëri. Ky standard, kërkesat evropiane të sigurisë për rrugët automobilistike dhe elementëve përbërës të tyre.

Segmenti D është projektuar për të plotësuar nevojat e kalimtarëve, trafikut urban dhe ato në interes të Rrugës së Arbrit. I vetmi Segment i projektuar në standardin C3 është ai i degëzimit për në Klos (Seg. K), kjo në përputhje me volumit e trafikut në atë rrugë.

Djemtë e vajzat e Lurës kanë lënë gjurmë në veprimtarinë shoqërore, politike e shkencore, në kulturë dhe në art.

Lura, kjo Hirushe e harruar...



Nga **Islam ÇENGA**

Rruga nga Rrësheni nëpërmjet Kurbneshit drejt Lurës kalon në reliev sa piktoresk e mbresëlënës, aq dhe të thyer dhe të vështirë. Udha është e paasfaltuar, por gjithsesi e mirëmbajtur, falë dhe stinës së verës pa shira e rrebeshe. Pas një maloreje të lodhshme para nesh u shfaq një pllajë kullote mbresëlënëse, një kullotë e mrekullueshme futur në rrënjë të maleve si një xhep i stërmadh.

- Ndalo këtu, i thotë, bashkudhëtari dhe mikpritësi ynë Rakip Cuku shoferit Shkëlqim, një djalë i ri, muskuloz dhe disi i heshtur, por i qeshur gjatë gjithë udhëtimit, në atë udhë që gjarpëronte mes malesh e rudinave me kullotë e pyjeve të dushkut, tashmë të lavinitur nga thatësira e tejzgjatur e kësaj vere.

- Ja këtu është kufiri që ndan krahinën e Lurës me atë të Mirditës. Ka një histori të veçantë ky kufi, këtu 100 vjet e kusur më parë. Një luras i mençur kishte mbushur opingat me dhé dhe në këtë vend u betua se kishte shkelur në dy toka, në të djathtë kishte dheun e Mirditës e në të majtë dheun e Bajrakut të Lurës. Këtu u vendos kufiri. Para nesh shtrihej një pllajë e ëmbël, me kodrina të vogla, me kullotën tashmë të zhuritur. Ishte tharë bari e lulja, dheu dhe gjurmët e bagëtive dhe të barinjve. Megjithatë, në sytë e mi, në mendjen time këto livadhe e shpijnë shpirtin dhe kurmin, e kurojnë dhe e bëjnë të lehtë si gjeth. Pastaj, 7 - 8 km më tej fillojnë të duken fshatrat e para të Lurës, Krej-Lura e Pregj-Lura, fshatra të futura mes malesh si në folenë e shqiponjës. Kulla të bardha, të hijshme, por të braktisura në këto vite tranzicioni, por që qëndrojnë në këmbë stoike, krenare, të heshtura me dertet e braktisjes së beftë, si pas një dimri që të mpin shpirtin dhe qenien.

Por në verë kullat ndjejnë erën e njeriut, të të zotit që vijnë e kalojnë ditë e muaj në vendlindjen e përmendur për bukurinë, hijeshinë, mrekullinë natyrore të pakrahasueshme të Lurës. Por dhe në dimër Lura ka një bukuri stoike, të ashpër, por të ëmbël, të ftohtë, por një i ftohtë joshës. Ish banorë të këtyre anëve, të shpërngulur në Tiranë, Durrës, e Kamëz nuk u shkulet zemra e shpirti nga këto vise krenare me një bukuri të pashoqe në të gjitha stinët e muajt e vitit...

MBIJETESË E LODHSHME, POR KRENARE

Në dy anët e luginës kanë filluar të bulojnë, të rriten të shëndetshme pyjet e rigjeneruar të pishës e bredhit. Pastaj shfaqen fshatrat e tjera të Lurës, të ndërtuara në një luginë rrethuar nga malet e larta të Bakulinës, Rrunjës, Nezhdës, Kurorës së Lurës. Male me lartësi mbi 2000 metra, të thepisura e me kullota të pasura tërfili e lulesh. Lura e Vjetër, Fushë-Lura, Borje-Lurë e në thellësi të maleve Lashkiza, Arë-Molla, Gjurë-Lura, Sumaj, Vlashe, plot dhjetë fshatra, secili më i bukur se tjetri shtrihen në këtë luginë të përmendur për alternimin magjepës të relievit. Lura, me namin e një perle të natyrës, duket e shastisur këtë fillim vjeshte. E shastisur, sepse pak vizitorë e turistë pati këtë verë, e shastisur nga thatësira e zjarret pafund ndër pyjet me pisha, e shastisur nga indiferenca e shtetit për të bërë diçka për Lurën, për pyjet e liqenet e saj të mrekullueshëm, për njerëzit që gdhijnë netët të papunë e të varfër, por krenarë e të pasur gjer në lokun e shpirtit. Në këtë shastisje ka diçka që Lurën e bën gjithsesi të brishtë e të bukur si dikur.

Mes për mes kësaj lugine kalon në udhën e tij Lumi i Mallës, ku po ndërtohet një hidrocentral më fuqi të konsiderueshme. Janë bukuritë dhe klima karakteristike që e bëjnë Lurën një vend të veçantë pelegrinazhi për turistët e vizitorët, një vend të bekuar nga perëndia. Por infrastruktura, prerja e pyjeve e kanë bërë këtë Hirushe disi të mpaket, të mblidhet në hallet e dertet e veta, në një mbijetesë të lodhshme, por krenare. Lura, aq shumë e përmendur për bukuritë e pashoqe, ku gërshetohet si në një simfoni peizazhi i luginës me malet përreth, tashmë disi të mbetura jetime e pa krahë. Në këto hapësira dikur kanë qenë rreth 13000 ha pyje, nga të cilat 1280 ha përbënte Parku Kombëtar i Lurës dhe rreth 6000 ha kullota. Dallohen lurasit për mbarështimin e blegtorisë, ku spikatin me tufat e deles rudë, me blegtorët e talentuar, Han Gjeçi e Lazam Kaci.

Ngjitur me Fushë-Lurën është ndërtuar një hotel, me pronar Hasan Doçin, administrator aktual i ish komunës së Lurës. Ka kushte të mira, shërbim të kulturuar, me gatime tradicionale të familjeve mikpritëse në mbarë Lurën. Është i vetmi hotel në këto anë. Dikur e në një kohë, shteti monist ndërtoi një hotel që i shërbente nomeklaturës, që sot është privatizuar, por jo i konstruktuar dhe funksional. Pra, Hasani, është mikpritësi i parë në Lurë, që të afron miqësinë dhe shërbimin komod.

BAJRAKTARI I LURËS

Në bisedat me banorët që buajtën për të na takuar në hotelin e Hasanit, flasin me krenari të ligjshme për Lurën, të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen e Lurës, të këtij vendi me bukuri përrallore, me njerëz fisnikë, të dashur, krenarë, fodullë, punëdashur e arsimdashës deri në dhimbje. Rakip Cuku, miku ynë i çmuar si dhe mësuesi me karrierë dyzet vjeçare në arsimimin e vajzave dhe djemve lurjanë, Dedë Llesh Doçi, të flasin me pasionin e ligjshëm për administrimin e krahinës së Lurës në kohën pa shtet e pa ligje në Shqipëri. Lura ishte bajrak më vete në gjithë krahinën e Dibrës dhe si të thuash kishte në vetvete një vetëqeverisje që dominonte ndër banorët e Lurës e në një farë mënyre jehona e saj ndihet ende në konaqet e bisedat e lurasve.

Bajraktari i Lurës ishte nga fisi i Menëve, aq i persekutuar e i lançuar në kohën e diktaturës. Bajraktari nuk ishte më i pasuri, por më i mençuri, më toleranti, më autoritari në Lurë. Shtëpia dhe pronat e bajraktarit nuk ishin mbi shtëpitë e tjera të Lurës dhe kjo është një ndër veçoritë dalluese të bajrakut të viseve të kësaj ane me diell e hënë. Përveç bajraktarit, që ishte ndër figurat më të spikatura të trevës, për zgjidhjen e problemeve te pronës, të mosmarrëveshjeve, të dasive të ndryshme, të gjakmarrjes, ngërçi i mosmarrëveshjes do të zgjidhej më tej nga 6 dhetarë, pleq, që si të thuash përbënte në vetvete një senat të mençurish dhe, më pas, si të vendosej zgjidhja më e mirë, më e paanshme, mbështetur në Kararet e Lurës, këtë vendim të marrë e zbatonin 12 çekiçe, që si të thuash ishin të veshur me zbatimin e ligjit në bajrakun e Lurës. Kishte vendime për pronat, meratë, bagëtinë, kullotat, pyllin. Duke qenë e baraslarguar nga Dibra e Mirdita me kilometra të tërë e pa rrugë, vetadministrimi i Lurës ishte e domosdoshme dhe atë bënë stërgjyshërit, gjyshërit e prindërit tanë, më thotë



Rakipi. Ishte një mbijetesë në Shqipërinë e asaj kohe. Në sytë e bashkudhëtarit tonë, mikut e shokut tonë të dashur, Ahmet Prençi, dallova shkëlqimin e syve.

- Po ty, i dashur, pse të shkëlqejnë sytë?

- Epo unë jam stërnip i Menajve. Babai im është nip dere te kjo familje lavdimadhe. Nga fisi i Menajve, të bajraktarit të Lurës, janë pushkatuar me gjyq e pa gjyq të paktën 11 burra nga regjimi komunist. Ishin kundërshtarë gjer në vdekje të komunizmit, por kurrë bashkëpunues me pushtuesin, në asnjë kohë, në asnjë periudhe kurciale që vendoseshin fatet e Kombit. Përkundrazi, një ndër djemtë e dajës së babait tim, të bajraktarit të Lurës, ka marrë pjesë në Kuvendin e Prizrenit. Janë njerëz paqësorë, të respektueshëm, të dashur e patriotë të thekur. Shumë djem e burra kanë marrë pjesë në shumë ngjarje qëndrese e luftërash për liri e pavarësi. E për këtë kam një krenari të ligjshme.

...Në qendër të Lurës janë dy monumente. Ajo e Dom Nikollë Kaçorrit, ish pjesëmarrës i Kuvendit të Vlorës, për të shpallur mëvetësinë e Shqipërisë, i zgjedhur në këtë kuvend si nënkryetar i qeverisë, dhe ai i Gjok Doçit, Hero i Popullit, që dha jetën fare i ri në përpjekje me pushtuesit nazifashistë. I ka të shtrenjtë bijtë dhe bijat e saj Lura. Fare pranë tyre është ndërtuar një memorial si promemorie në kujtim të burrave lurjanë të përndjekur, të vrarë nga regjimi komunist. Falë djalit të Lurës, biznesmenit Dodë LLesh Doçit, që investoi bujarisht, u ngrit kjo përmendore kujtese që dëshmon për historinë, bëmat dhe antikomunizmin e Lurës e të bijve të saj e që lëshon jehonën në të gjithë vendin. Doda ka investuar, si dhuratë për katolikët e Lurës dhe të gjithë lurjanëve dhe për ngritjen e kishës së re, mbi themelet e ish kishës qindra vjeçare të kësaj treve. Një investim serioz i këtij biznesmeni bujar e filantrop.

Dhe një masakër tjetër nuk e harrojnë lurasit. Rakipi na tregon një vend fare pranë fshatit Fushë-Lurë, një kodër e vogël, ku në vitin 1916, nga pushtuesi austriak, nemcja, brenda një dite u pushkatuan 108 burra lurjanë, sepse nuk u pajtuan me këtë pushtim kolere. Kjo masakër tregon më së miri shpirtin luftarak e atdhedashës të lurjanit. Për një kohë të gjatë të mbetet në mendje masakra, ndër më të rëndat, më të kobshmet në historinë tonë kombëtare.

KRENARITË E LURËS

Djemtë e vajzat e Lurës kanë lënë gjurmë në veprimtarinë shoqërore, politike e shkencore, në kulturë dhe në art. Lurasit janë njerëz kurajozë, të qeshur, të çlirët, krenarë mikpritës, sedërli e bujarë e që i kanë dalë dhe i dalin zot vendlindjes si rrallëkush, vendlindjes aq të përmendur për bukuritë e pashoqe të natyrës. Kujtoj me nostalgji mikun tim, doktorin Preng Doçi, që shërbeu me përkushtim të rrallë në vendlindjen e tij, por për vite me radhë edhe në qytetin minator të Bulqizës. Ai nuk jeton më, por emri i tij është i pashlyer në kujtimin e bashkëfshatarëve të tij, të minatorëve të qytetit të kromtë, që u shërbeu me përkushtim si rrallëkush. Shërbeu në Lurë me një përkushtim të spikatur, derisa shkoi në specializim dhe mori emërimin në Bulqizë. Po kështu dhe mjekët e tjerë të pasionuar si Ndreë Vladi e Skënder Buci, stomatologu Bardh Asllani, infermierët Diamanta Doçi, Dila Vladi, Ruta Moriseni etj., që kurrë nuk u shkëputet mendja dhe shpirti nga shëndetësia, nga Lura.

...Mësuesi Dodë Llesh Doçi flet me shumë pasion, respekt e dashuri, me mirënjohje e mirësi për intelektualët e Lurës, që kanë dhënë kontribute të pashlyera jo vetëm për Lurën e Dibrën, por dhe për kombin. Intelektualë të tillë si Ahmet Kaçori, Ahmet Përleka, Halit Tollja, Leke Rajta, Sali Ajazi, Bardhok e Nikollë Rajta, Ndue e Nikollë Kola, Osman Murati, Tahir Nezha, Llesh Nikolla, Naim Buci, Dodë Doçi, Ali Kaci, Hamit Skana, Gjergj Vladi, Hekuran Vladi, Artan Cuku, etj., etj. Ky i fundit u vra nga dora gjakatare e krimit, për shkak të detyrës si drejtues i lartë i Policisë së Shtetit. Vëllai i Tanit, Kipi, siç e thërriste gjithnjë Tani, mikpritësi ynë energjik, na çoi në kullën ku u rrit dhe kaloi fëmijërinë Tani, kulla e Sul Cukut i thonë, babait të Tanit. Me lot në sytë e tij ngjyrë bjeshke, ai na çoi në dhomën e ndenjes ku mësonte Tani, në oborrin ku mblidheshin çdo pasdite moshatarët e tij, në



reportazh

Diçka po ripërtërihet, po rilind, në Lurën tonë, në pasurinë e lurasve, në pasurinë kombëtare, toka e Lurës, e Hirushës sonë të nëpërkëmbur, të harruar...

Lurasit janë kulturëdashës. Ka pasur një shtëpi kulture, me bibliotekë e sallë shfaqjesh në Lurë. Tashmë shtëpia e artit është adaptuar për zyrat e ish komunës. Në këtë shtëpi kulture ka punuar vite me radhë Ilmi Kolgjegja, një ndër drejtuesit, krijuesit, muzikologët më të spikatur për Lurën e Dibrën.

lumin e Mallës, me të cilin Tani ishte dashuruar pafundësisht, në fushën e futbollit te shkolla ku luante derisa nata të binte në luginën e malet madhështore të Lurës. Djalë çapkën, i dashur, i shkëlqyer në mësime, në marrëdhëniet më shokët e shoqet e fëmijërisë, derisa shkoi në shkollën e lartë të Policisë, pas një kalvari vuajtjesh, diskriminimesh të kohës.

Punoi si refugjat në Greqi, si shumë bashkëmoshatarë të tij. Krenar, i gjallë, hokatar, i sinqertë, i pakorruptueshëm, me sytë që i shkëlqenin nga mirësia, pasioni e dashuria sublime për punën. Dhe ashtu iku Tani, në një natë të prillit të këtij viti, në pusi, në terr, në pabesi, në pusi cubash dhe la pas dhimbjen e madhe në zemër e shpirt për të gjithë ato që e kanë njohur dhe kanë punuar me të. Lura e kujton me respekt e dashuri Tanin, i cili, siç thonë lurasit, bashkëmoshatarët e tij, kishte lidhje shpirtërore, të patjetërsueshme e krenar më Lurën dhe bashkëfshatarët e tij lurjanë, megjithëse punoi e jetoi në Tiranë vite me radhë.

- Tanit duhet t'i jepet titulli "Dëshmor i Atdheut", se sakrifikoi në emër të ligjit, nuk u zmbraps para krimit dhe bandave kriminale dha gjithçka për sigurinë e qytetarëve të tij, dha gjithçka si drejtues i lartë i Policisë së Shtetit, - thotë administratori i Lurës, Hasan Doçi. Ne duhet të bëjmë punën tonë, nderimin tonë për të rënin në krye të detyrës, njeriut, babait, bashkëshortit shembullor bashkëfshatarit tonë të pazëvendësueshëm, Artan Cukun.

NJERËZIT E KULTURËS

Lurasit janë arsimdashës. Të duash arsimin do të thotë të duash të sotmen dhe të ardhmen, të duash jetën cilësore, përmirësimin e saj nëpërmjet shkollës, dijes, kulturës. Në Lurë është shkolla 9 vjeçare dhe e mesme me një bazë të pasur didaktike, me nxënës të zellshëm e mësues të palodhur. Tradita e mësuesve të përkushtuar në këtë shkollë, si mësuesja e parë, bijë e Lurës, Margjela Vladi, Jashar Kaci, Dodë Llesh Doçi, Ali Koçeku, Hajri Begu, Ismail Hoti, Kasem Hoti, e Destan Ajazi, si drejtues shkolle e brezi i sotëm i mësuesve si: Trëndelina Koçeku, Fatmir Hoti, Kastriot Doçi, Muharrem Koçeku, Fatjon Zebi etj. Ato të përmendin në bisedë e sipër nxënësit e talentuar si: Daniela Mena, Henri Vladi e shumë e shumë të tjerë, nxënës që të bëjnë për vete për sjelljen, zellin e përkushtimin e tyre në mësime. Daniela kërkon të bëhet mjeke, ndërsa Henri ka pasion elektronikën...

...Lurasit janë kulturëdashës. Ka pasur një shtëpi kulture, me biblioteke e sallë shfaqjesh në Lurë. Tashmë shtëpia e artit është adaptuar për zyrat e ish komunës. Në këtë shtëpi kulture ka punuar vite me radhë Ilmi Kolgjegja, një ndër drejtuesit, krijuesit, muzikologët më të spikatur për Lurën e Dibrën. Ai pasuroi, mblodhi folklorin e pasur si vetë natyra të Lurës, krijoi valle e këngë të cilat dhe sot përbëjnë një pasuri të madhe kulturore për trevën. Kënga e shtatë liqeneve të Lurës e shumë rubaira të folklorit lurjan janë krijuar nga ky bir i Lurës. Por ndër të spikaturit e ndër talentet e rrallë jo vetëm për Lurën e Dibrën është këngëtari brilant, Arif Vladi. Me këngët himn të tij si "Sef Kosharja", "O prite Azem Galicen", për betejën me serbët në Kolosjan, me këngët lirike dibrane, ai u bë një ndër bijtë më të shquar të Lurës në fushën e muzikës, të këngës. Nuk e di nëse Arif Vladi dhe shumë kontribues të tjerë në fushën e arsimit dhe të artit janë shpallur nder i trevës së Lurës apo të Dibrës. Në qoftë se jo, jemi shumë të vonuar në vlerësimin e figurave të tilla si Arif Vladi i vërtetë apo Ilmi Kolgjegja që ka "udhëtuar" me kohë për në botën tjetër.









BASHKËJETESA FETARE

Lura ka një bashkëjetesë të spikatur fetare e ndoshta është treva e vetme ku në një familje jetojnë, ngrysin ditët e netët, hallet, dertet e gëzimet katolik e myslimanë. I festojnë të gjitha festat fetare, në respekt të njëri-tjetrit, në dashuri e mirësi me njëri-tjetrin. Dikush e ka zonjën e shpisë myslimane, dikush të zotin e shtëpisë katolik e fëmijët të bekuar nga të dy fetë, janë rritur në një ambient ku harmonia fetare është biblike. Në të dhjetë fshatrat e Lurës nuk mund të çuditesh për këtë. Ajo është reale, e prekshme prej dhjetëra e dhjetëra dekadash e ndoshta shekuj. Edhe sot ndodhin martesa midis myslimanëve që përbëjnë mbi 90 për qind të popullsisë dhe katolikëve që banojnë në të dhjetë fshatrat e Lurës.

Në qendër të Lurës, në vitin 1995 është ndërtuar xhamia, si në shumicën e fshatrave. Fare pranë tyre janë ndërtuar kisha. - Jemi krenarë për këtë, - shprehen lurasit, si një gjë krejt normale, krejt natyrale. Kurrë dasi fetare, kurrë përçmim të njëri-tjetrit, gjithnjë respekt e mirësi ndaj njëri-tjetrit! Këtë gjë e ndjen e rrok në çdo bisedë, në çdo shtëpi në Lurën Hirushe, që jeton e gëzon të mirat e dhimbjet e kësaj jete në 1050 metra lartësi mbi nivelin e detit. Drurët frutorë janë të paktë në Lurë, prodhimet janë doracake për shkak të dimrit të egër e të gjatë, por jeta është e bukur, e shëndetshme e pasur në vlera e tradita shekullore të patjetërsueshme për Lurën e lurjanët.

RINGJALLJA E PYJEVE

Lura do ta marrë veten nga masakra mjedisore. Në shpatet e maleve të saj duken pishat, bredhat e ahet që kanë dalë nga dheu si Anteu. Është një mrekulli e natyrës që pyjet që duhen vite e ndoshta dekada për t'u ripërtërirë, të mbushin me shpresë, me optimizëm. Dashuria e lurjanit për pyllin është si copa e bukës. Kush e hedh, kush e shkel është haram dhe i nemur nga Krijuesi. Në Lurë thonë se masakrën e pyjeve, duke përfshirë dhe Parkun Kombëtar, është bërë jo nga vendasit, por nga pushtetarë të lartë të monizmit, në gërhamat e fundit të sistemit diktatorial. Si ujqër dhe çakej, si shejtanë e djaj ju sulën sistemit ekologjik e të paparë mjedisor të Lurës, mrekullisë të natyrës me liqene e pyll si në përralla, me një klimë të ëmbël si mjalti, me njerëz krenarë, mikpritës, të besës, të respektit, të mirësisë. Punëtorë e qejflinj, jaranë të dashurisë e dhembshurisë janë lurasit...

...Ka të drejtë Hasani, administratori i Lurës, kur flet me optimizëm për të ardhmen e afërt të Lurës së dikurshme. Duhet pak vëmendje nga bashkia Dibër, pak vëmendje nga shteti për fonde pyjore për mbjellje, shërbimet e domosdoshme, pastrimin, se pyjet në Lurë nuk kanë nevojë të vaditen e as tjetërsohen. Duhet pak investim në infrastrukturë, në pastrimin e pyjeve, në ruajtjen e tyre nga sëpata, motosekat, nga ujku, çakalli, dhelprat e djalli... Hasani flet me siguri për ringjalljen e Lurës, të liqeneve të mrekullueshëm të Kurorës së Lurës, për Parkun Kombëtar, për hotelet dhe bujtinat, për gatimet gjithë shije të kuzhinës lurjane. Të një mendje janë dhe tekniku i pyjeve, tashmë në pension Elez Doçi, Haziz Mena, Selman Vladi, Ramazan Skana, Sefer Murati...

Padyshim që, sytë e mendja e biznesmenëve të Lurës duhen kthyer nga vendlindja e tyre që të mrekullon me hirin e bukuritë që i ka falur pa kursime e pa ja da, Nëna Natyrë.

Shtatë liqenet e Lurës, dikur si shtatë sy shqiponje, të rrethuara me pishën e bredhin lozonjar, siç e thotë kënga e mrekullueshme e kënduar nga këngëtarja dibrane, Liri Rasha. Por sot ato kanë mbetur si sy bualli, pa vetulla, pa qepalla e qerpik të gjelbërt. Kanë mbetur të shushatur në shkretinën që solli diktatura në fundin e palavdishëm të saj, për prerjen pa asnjë kriter e cak pyjet pafund të këtyre anëve me bukuri mahnitëse. Por me shpresë, me ëndrrën e lurjanit, tonën, që shumë shpejt ato do të ndjenë nusërimin e natyrës për vizitorët, turistët, për miqtë e banorët vendas.

PISHA DHE AHU PO RRITEN

Lurasit janë të ndjeshëm. Të ndjeshëm për një fjalë që e thua pa menduar e pa u përtypur. Por mbi të gjitha janë të ndjeshëm për natyrën. Janë binom lurasit me natyrën, për hijeshinë, për krenarinë dhe fisnikërinë që u ka falur ajo, me bujarinë e pashoq të saj. Ahmeti thotë se natyra bën çudira. Ja, në vend të sëpatës, motorsekës, në vend të ujkut, çakallit, të lugatit, të dreqit e shejtanit, po rritet, disi ngadalë, por pa ju da një pyll pishe, ahu e bredhi joshës e i gjelbërt si kurrë më parë. Ka të drejtë poeti dhe stërnipi i Menajve dhe Lurës, Ahmet Prençi.

Këtu ka nevojë dhe për një pistë për ski në sezonin e dimrit, - vazhdon ai. Ka nevojë për bujtina kullash, ka nevojë për rrugë të përshtatshme e për vizion për të ardhmen e afërt. Lura do të bëhet përsëri hanëm, si Hirushja e përrallave, si Borëbardha, mjafton të menaxhohen mirë investimet e shtetit, që do Zoti e kujtohet për Lurën tonë, për Lurën e të gjithëve. Jo tolerancë ndaj sëpatës, piromanëve, hajdutëve të natyrës së mrekullueshme të kësaj treve mahnitëse...

Por prapë se prapë, megjithëse diçka po ripërtërihet, po rilind, në Lurën tonë, në pasurinë e lurasve, në pasurinë kombëtare, toka e Lurës, e Hirushës sonë të nëpërkëmbur, të harruar, përsëri e përsëri djeg, shpupuriset si prush e ende digjet nga ethet e katër stinëve, e ditëve dhe netëve që ngrysen e zbardhin në bajrakun e kësaj treve mbresëlënëse, të papërsëritshme për hijeshinë dhe bukuritë e saj.

Rruga e Arbërit nr. 137

Një pyetje për Ramën-kryeministër dhe Bashën-dibran
Dhe për dibranët ku janë e ku s'janë...

opinion

A do t'ia **hiqni Dibrës** simbolin komunist Hero i Punës Socialiste?

Nga **Abdurahim ASHIKU**

Të dy si një pendë qeshë vënë në zgjedhë nga dreqi me të birin janë hedhur në sulm për të ç'bërë historinë, atë histori të shkruar me gjak partizanësh dhe djersë populore si asnjëherë në ekzistencën e shqiptarëve, si gjak e gjini, si komb e qëndrueshmëri.

Tash 26 vjet, si në atë skeçin "Hap sirtarë e mbyll sirtarë" luajtur me përsosmëri artistike nga Aleko i Korçës, nxjerrin e hedhin fletë të zverdhura mediave të shkruara e fluturake në rishikim të kohës së diktaturës.

Kësaj radhe rihodhën atë që është hedhë e rihedhë, çuditërisht fill pas zgjedhjeve e këmbimit të vendit në kularin e zgjedhës së buajve në brazdë, heqjen e dekoratave të atyre që bënë luftën, ata që e radhitën Shqipërinë pjesë të koalicionit të madh antifashist, i vunë kockën në grykë shovinizmit sllavo-grek për copëtimin e vendit, përveshën krahët dhe ndërtuan hekurudha (a ka ndonjë hekurudhë të ndërtuar këto 26 vjet?), ndërtuan hidrocentrale të rangut botëror, thanë këneta, e çuan arsimin e mesëm deri në skajet më malore të vendit, e...

Po zbres në Dibrën e kohës, atë Dibër që e kam në gjen të jetës, e mbaj mend mirë në etapat pas Luftës së Madhe Antifashiste, si mësonte të shkruante e lexonte për të zhdukur analfabetizmin, si punonte duke e ngritur lart traditën e njeriut punëtor sa "Po të digjej Stambolli Dibra e ngrinte të ri nga themelet...", siç thoshte një historian i huaj, duke vlerësuar e ngritur lart një vlerë të jashtëzakonshme të dibranit e të Dibrës.

A do t'i hiqet Dibrës dekorata e lartë simbolike e Heroit të Punës Socialiste? Sipas AliBeut që kërkon të shkulë rrënjët e vlerave të mëdha të popullit shqiptar në betejën e jashtëzakonshme historike antifashiste fitimtare dhe në betejën e madhe të rindërtimit e ndërtimit të vendit, PO. Ai që Fieri i dha shuplakën më të madhe në jetën e tij, i inatosur, sulmon simbolet, kërkon t'i rrëzojë e nëpërkëmbë. Don Kishoti do e duartrokiste në mënyrë frenetike... Dibrës vlerësimin e lartë "Hero i Punës Socialiste" ia dha puna e saj, përkushtimi i mjeshtërve të dorës e të dijës në ndërtimin e veprave të mëdha, të prekshme edhe sot, edhe nesër, në të gjithë Shqipërinë.

A mund t'i hiqet titulli i lartë "Hero i Punës Socialiste" Gani Tuçepit, njeriu që "piketoi" Gjalicat me karabinë e bashkë me Çidhnakët i dha jetë heroizmit të pashoq të çarjes së tuneleve me "barut fishekësh" për ta dërguar ujin për ujitje deri në Reç e Vakuf? Njeriut emri i të cilit është skalitur në kujtesën e njerëzve në ndërtimin e veprave të mëdha ujore në Dibër, Mat e deri në Sarandë?

Po Beqir Kalisë, inxhinierit asistent, pa diplomë universitare, por me diplomën popullore të projektimit e zbatimit të veprave ujore që nga Kanali i Çishnës e deri tek vepra ujore e Liqeneve të Kacnisë, uji i të cilëve rrodhi nga Balgjaj në fushën e Maqellarës, a i hiqet titulli simbol i asaj kohe "Laureat i Çmimit të Parë të Republikës?

Po Sefedin Qorlazes, kryegjeologut të Bulqizës që i dha jetë dhe hap të gjatë minierës së Bulqizës dhe Batrës a i hiqen dy herë radhazi titulli "Laureat i Çmimit të Parë të Republikës"?

Po Todo Manços, kryeinxhinierit dhe drejtorit të minierës së Bulqizës që pas pushkës partizane mori "martelin" për t'i dhënë atdheut një ndër vendburimet më të mëdha të kromit në botë ku nxirreshin deri në 500 mijë tonë krom në vit, a do t'ia hiqni titullin e lartë "Hero i Punës Socialiste" siç i hoqët minierës emrin e tij?



Aksioni i 14 dhjetorit 1969

Po 11 heronjve të gjeologjisë të Batër Martaneshit që dhanë jetën për t'i dhënë atdheut një minierë po kaq të madhe sa ajo e Bulqizës, a do t'ua hiqni titullin e lartë, ashtu si i hoqët minierës emrin e tyre?

Po Ismail Loshës simbol i punëtorit të gjeologjisë e më pas drejtues i ndërmarrjes gjeologjike të Bulqizës, a ka forcë kush t'ia heqë simbolin e lartë të njeriut të përkushtuar të punës?

Gollobordasit ndërtuan Shqipërinë. Nuk ka vepër që nga themelet e deri në majë të oxhaqeve të lartë që të mos ketë djersën lumë të ndërtuesve duarartë të kësaj treve të Dibrës ku, siç thonë, "Fëmijët lindin me mistri, sqepar e nivelë uji në dorë".

Njëmbëdhjetë heronj të punës socialiste ka Trebishti. Po përcjell një fotografi të katër prej tyre, të katërt me yllin e artë të Heroit të Punës Socialiste në gjoks. A ka burrë nëne në politikën shqiptare që të shqyej gjokset e tyre punëtore si askush dhe tua marrë yllin e lartë, fryt i dijes dhe i djersës së tyre mbi vepra të mëdha ndërtimore?

"Luan i tuneleve" quhej Sabri Shini. Çau tunelin e Dajtit dhe i dha Tiranës "Ujë e dritë në dhjetëvjetor" (1951), siç thotë kënga. Çau edhe tunelet e Shkopetit ku ishte edhe drejtor i punimeve në të dytin hidrocentral të madh të kohës (1962) dritën e të cilit e marrim edhe sot, megjithëse nëpërmjet blerësve të lidhur me politikën e allishverisheve mbushje xhepash të pistë.

"Luanë të tuneleve" ishin Darnjanët, Çidhnakët, Reçjanët, Katërgrykasit, Muhurrakët, Luznakët...që çanë tunelet e Vaut të Dejës, Fierzës dhe Komanit duke derdhë jo vetëm djersë por edhe gjak që u bë dritë për të gjithë Shqipërinë; dje, sot dhe nesër. Pa këta njerëz, pa këta "Luanë të maleve të Dibrës", mund të them me plot gojën, se sot nuk do të ekzistonin këto tre vepra të mëdha fryt, dije e djersë e një treve dhe një populli punëtor.

Asnjë trevë, jo e Shqipërisë por e Evropës, nuk është përgjakur, shkatërruar ekonomikisht, shkulur rrënjësh sa Dibra nëpër të cilën kaluan të gjitha ekspeditat osmane drejt Krujës, Albulenës e viseve të tjera. Me dhunën e ushtruar as bari nuk pritej të mbinte në Dibër.

Epo Selim Alliut nuk mund t'i preket, madje as mund ta marrë nëpër gojë kush e të thotë t'ia heqim simbolin "komunist", "Mësues i Popullit". Se ai ishte me të vërtetë Mësues i Popullit, i Dibrës dhe më gjerë. Ai e mori arsimin në Dibër me 32 shkolla fillore me 1280 nxënës e 62 mësues (dhe me themelet e shkulura të Internatit të Kastriotit") për ta ngjitur në vitin 1966 në 192 shkolla fillore e tetëvjeçare me 17.012 nxënës e 604 mësues, me një shkollë pedagogjike me 187 nxënës e 7 mësues (1947) dhe me një shkollë të mesme bujqësore me 217 nxënës e 14 mësues (1959). (Shemsi Hoxha: Vjetari statistikor i rrethit të Dibrës 1966)

Për ta vazhduar Ai dhe brezi i nxënësve të tij, tashmë mësues, deri në 188 shkolla fillore e tetëvjeçare me 28.700 nxënës e 1.244 mësues dhe 19 shkolla të mesme shtrirë deri në zonat më të thella të Dibrës si Reçi, Lura, Klenja, Selishta... me 2.419 nxënës... (Flamur Cena, Vjetari statistikor i Dibrës 1980, dorëshkrim).

Në këtë dritare të madhe të dijes në Dibër vlerën e pishtarit e ka Mësuesi i Popullit Selim Alliu. A mund të shuhet ky pishtar vetëm e vetëm sepse u vlerësua dhe u ngrit në piedestalin më të lartë të arsimit masiv shqiptar nga shteti "komunist"?

Dibra që mposhti me një heroizëm të pashoq pasojat e tërmetit të 30 nëntorit 1967, që e bëri "orën minutë e hapin kilometër" me aksionin e 14 dhjetorit 1969 në ndërtimin e kanalit Fushë Alie – Vakuf, kanal që vuri nën ujë të bollshëm tokat më pjellore të luginës së Drinit të Zi, e të tjera dhe të tjera, e ka merituar yllin e artë të heroit të punës

Jo zoti Rama, kryeministër, as ti z. Basha "dibran" dhe as ti z. AliBeu, e bashkë me ju tërë kopeja blegëruese antikomuniste nuk mund t'ia hiqni Dibrës "Yjet e Artë" të punës e të trimërisë në shekuj e në katër dekadat e regjimit komunist, ndaj mos llapni me gjuhën jashtë.

Dibra është një ndër trevat që në shekuj ka folur me shpatë, pushkë e me kazmë e mistri, me gjak e me djersë.

Tetëmbëdhjetë beteja numëron historia që Gjergji i Gjon Dibranit, siç e ka thërrit Voltarreno, i ka zhvilluar në Dibër, që nga e para, Torviolli, e deri tek e fundit, pas vdekjes tij, pushtimi i vendorigjinës së Kastriotëve, Çidhnës nga hordhia më e madhe e kohës, turqit osmanlinj. Masakra e paimagjinueshme për kohët ku një trevë e tërë u dogj dhe u kalua me pleq e fëmijë në tehun e shpatës, flet për sakrifica supreme të Dibrës në historinë e Shqipërisë.

Asnjë trevë, jo e Shqipërisë por e Evropës, nuk është përgjakur, shkatërruar ekonomikisht, shkulur rrënjësh sa Dibra nëpër të cilën kaluan të gjitha ekspeditat osmane drejt Krujës, Albulenës e viseve të tjera. Me dhunën e ushtruar as bari nuk pritej të mbinte në Dibër. Megjithatë ajo qëndroi duke treguar se e donte vendin e të parëve duke mprehur shpatat e mbushur hutat me barut, ndër të tjera duke lënë nam me betejën kundër Hajredin pashës e Hysni pashës, e më vonë kundër Serbisë në vitet 1913-1922 që lakmonte të dilte në Durrës nëpërmjet Dibrës e për ta zhbë Shqipërinë.

Segmente që nuk e kanë dashtë, nuk e duan dhe nuk do ta duan asnjëherë, kërkojnë me shkrim e me gojë vesh më vesh, t'i heqin Gjergj Kastriotit Skënderbeut titullin e lartë Hero Kombëtar. Presidentë të shtetit shqiptar ka ndodhë që në pritje të ndonjë delegacioni turk të heqin bustin e Skënderbeut nga salla zyrtare e pritjes në Pallatin e Brigadave (!)

Rama, Basha dhe Meta, çuditërisht nga ky sulm i egër ndaj Heroit tonë Kombëtar, nuk kanë reaguar në sallën e Kuvendit apo atë të Presidencës (!)Në Luftën e madhe Antifashiste Nacionalçlirimtare Dibra derdhi gjak heronjsh e dëshmorësh në themelin e luftës botërore antifashiste.

A mund t'i hiqet titulli i lartë Hero i Popullit, Gjokë Doçit i cili në nëntor 1943 ra në një betejë të pabarabartë me forcat gjermane në Symizë të Mallakastrës e që populli i kësaj zone, në respekt për Dibranin trim e ruan lapidarin si vlerë të një lufte të madhe antifashiste shqiptare.

Po Nazmi Rushitit që i tha federalit fashist: "Me ngadalë fashist i qenit/ T'ka ardh' sahati mos luej prej venit/ Se ky popull ka djem me huqe/ Këmishën e zezë ta bën të kuqe", a mund t'i hiqet ylli i artë pesëcepësh pse ai ishte komunist?

Po Ramiz Varvaricës, heroit të Spanjës që ra në përpjekje me nazifashistët që do t'i bënin gjëmën Evropës a do t'ia merrni yllin e artë?

Haxhi Lleshit, krijuesit të Çetës së parë në Dibër, e të dytë në Shqipëri, mund t'ia merrni ato pesë gram arë që ka ylli i Heroit të Popullit, por do të duhet tu ktheni pasardhësve të tij mushkat me florinj që dha për Luftën e Madhe Antifashiste për Çlirimin e Shqipërisë dhe radhitjen e saj midis fitimtarëve të mëdhenj antifashistë botëror.

Me bashkimin e votës së zezë në parlament (nuk po them Kuvend) ju mund të bëni çfarë të doni, por vetëm një gjë nuk mund ta bëni, të shuani nga kujtesa e popullit heroikën shqiptare në shekuj dhe në dyzet vjetët e diktaturës komuniste. Populli tashmë e ka në gjen atë kohë dhe ata njerëz që hynë dhe mbetën në kujtesën e tij.

Athinë, 25 shtator 2017



Heronjtë e Trebishtit

profil

Nga investimet në rezervatet e peshkut, te turizmin e tregtia. Investimet e Sokol Shtrezit, që po ngjallin shpresë se fshatrat e Dibrës kanë të ardhme

Sokoli, njeriu që gjeti suksesin te gurrat e Kovashicës



Nga **Osman XHILI**

Sokol Shtrezi as që e kishte menduar ndonjëherë, se do t'i futej një sipërmarrje të tillë apo do të ndiqte rrugën e biznesit. Bashkë me dy vëllezërit e tjerë, Gëzimin dhe Xhevahirin, ishin rritur me shumë varfëri, në fshatin e Kovashicës, në Shupenzë. Teksa ndiqte shkollën e mesme në komunën e tij, mësonte shumë mirë dhe "raskazet" e rusishtes, duke marrë vlerësime maksimale nga mësuesi i kësaj lënde, Jashar Demiri. Por vitet nëntëdhjetë ishin sa të bukur, aq dhe të vështirë për shqiptarët. Djaloshi i atëhershëm plot ëndrra dhe energji, ishte i etur për dije, por dhe për para. Kë do të zgjidhte? Për çudi vrapoi pas të dytës, se ndoshta e dyta do ta sillte sërish të parën. La në mes shkollën dhe vitet studentore dhe u nis në Greqi, ku zgjodhi ishullin e bukur të Kretës. Natyrisht, jo për turizëm, atij luksi nuk ia kishte ngenë për momentin. Punoi jo pak, por dhjetë vjet, bashkë me vëllezërit. Sokoli kujton pronarin, një njeri i mrekullueshëm. Super i pasur dhe superhuman, kështu e portretizon njeriun që i dha punë, strehë dhe ushqim. Pas kaq shumë vitesh punë, ishin grumbulluar jo pak para dhe djali mendonte ç'do të bënte me to. Mendja i thoshte të blejë një shtëpi në Tiranë. Kishte ardhur koha që dhe ai të jetonte si një qytetar i zakonshëm i këtij vendi, larg fshatit provincial, ku hodhi shtat e u burrërua. Të dukej në sy të të tjerëve që kishte bërë pak prokopi. Pronari e nuhati dilemën e djalit dhe e pyeti si do t'i përdorte paratë e fituara. Djali nuk e fshehu idenë që kishte, por tjetri e kundërshtoi fort.

- Paratë janë të tuat, je i lirë të zgjedhësh, por unë të këshilloj të blesh tokë në bregdet. Do t'i vijë koha turizmit. Djali ishte disi skeptik për këtë, ndaj ai vazhdoi. – Po fshati juaj, nuk ka ndonjë gjë të veçantë?

Sokoli kujtoi fshatin e tij të varfër, atë pak tokë, rrugën gropa-gropa, kodrat e malet që e rrethonin, por dhe tre gurra që buronin një ujë të kristaltë. Kur i përmendi gurrat, pronari u entuziazmua.

- Keni një pasuri të tillë në fshat dhe më rrin këtu! Ti mund të bësh atje një rezervat të mrekullueshëm peshku. Unë të mbaj gjithë jetën me punë, por më mirë shko në vendin tënd dhe ngrije atje folenë. Punëso veten dhe të tjerët në biznesin tënd, në fshatin tënd.

Për pak minuta Sokoli fërkonte ballin, ku lëvrinin mendime të shumta. Plani i shtëpisë në Tiranë u la mënjanë. I tregoi vëllait, Gëzimit, bisedën me pronarin dhe ai e mbështeti pa hezitim.

- Hajde vëlla, ta provojmë njëherë. Greqinë e kemi sërish këtu.

Trastat e kurbetqarit në krahë dhe u kthyen në vendlindje. Pyeti dhe studioi jo pak rreth këtij biznesi dhe krijoi ca njohuri të përgjithshme. Më pas u ngritën vaskat e para, pak poshtë burimit të ujit dhe nuk mbetej gjë tjetër, veçse të gjente rasatin e ta hidhte në vaskë. Sokoli tregon peripecitë e shumta dhe marrjen e rasatit në Vërtok të Gostivarit. Ndërsa hidhnin peshqit e vegjël në ujin e oksigjenuar, Sokoli pyeste veten nëse do mundej, që dhe ai të prodhonte vetë rasatin e peshkut, ndonjë ditë. Një zë i brendshëm i jepte forcë dhe i thoshte se po, ai mundej. Dy javë më vonë u kthye sërish në Gostivar. Kishte mbushur dy çanta me ushqime dhe pije për punëtorët që shërbenin aty. Shkurt, donte t'u "vidhte" zanatin. Në fakt, ata i treguan shumë gjëra, si pastroheshin vaskat, si vilej peshku, si fekondoheshin vezët e vjela e plot të tjera si këto. Njëri nga punëtorët i tha: "Mbaje mend, po nuk u bëre ti që të vijmë ne të marrim rasat prej teje". Vite më vonë u vërtetua profecia e punëtorit. Rasati i prodhuar nga Sokoli furnizon vaskat e tij dhe shpërndahet në Shqipëri e më gjerë.



Në faqen e kodrinës, përmbi ujin e gurrës së Kovashicës, biznesmeni i ri do që të ngrejë shtëpitë e para për turistët. Mishi i peshkut,i kecit, i shpendëve, bashkë me ushqimet e fshatit e mikpritjen e banorëve, do të jenë një tundim i papërballueshëm për të huaj e vendas.

PËRVOJA E ÇMUAR NGA DANIMARKA

Ishte viti 2007 dhe Sokoli kishte pesë vite që punonte në biznesin e tij dhe bashkëpunonte me një kompani holandeze, duke marrë prej tyre ushqimin e peshkut. Kompania kishte menduar që të organizonte një tur të vogël me bashkëpunëtorët e saj në shtatë shtete të Europës, kryesisht në ferma që kultivonin peshkun.

"Më pëlqeu një fermë në Gjermani, - tregon Sokoli, - por pastaj mësova se Danimarka është numri një në botë, në këtë drejtim. Shpreha dëshirën për të shkuar atje dhe vërtet kompania ma mundësoi e ma bëri realitet. Por projektet u vonuan për nja gjashtë muaj, pasi duhej perfeksionuar më tepër gjuha angleze, për të komunikuar me të huajt".

Herën e parë Sokoli qëndron tre muaj në Danimarkë. Teknologjia e lartë dhe disiplina e fortë ishin shtyllat e suksesit të atyre njerëzve. Ferma ku qëndronte Sokoli prodhonte 800 ton peshk në vit me vetëm tre punëtorë. Për të prodhuar 500 ton peshk pronarit të fermës i duheshin jo më shumë se 36 litra ujë për sekondë dhe jo më shumë se tre punëtorë. Duke qenë se vinte nga një vend me teknologji të dobët, shqiptarit iu dukën disi të pabesueshme shifrat dhe i thotë danezit mendimin e tij. I huaji nuk nguroi t'i tregonte se me pak marifete të vogla,duke shtuar fuqinë e ujit me anë të rrymës, apo duke e ngopur ujin me oksigjen të lëngët, gjërat e pamundura në dukje, bëheshin të mundura. Në mendje i shkoi uji i gurrës së tij atje në fshat, që kishte gati 150 litra ujë për sekondë dhe oksigjeni i tretur arrinte deri në 11 ppm. Temperatura e ujit ishte konstante prej 9, 8 gradë celsius. Sokoli nuk kishte nevojë t'i përmirësonte parametrat e ujit të tij, vetë Zoti i kishte rregulluar në mënyrë të përsosur. Prej tij kërkohej vetëm pak punë e përkushtim.

Në fermën tjetër, në Alborg, qëndroi 45 ditë. Ndërsa tek e para mësoi plot gjëra, si bëhej rritja e peshkut për konsum, tek e dyta mësoi teknologji të reja për prodhimin e rasatit. Atje i përzgjidhnin femrat që prodhonin vezët. I shihnin nga trupi, që të mos kishin bark të fryrë, ti kishin velëzat e rregullta, lëkura të shkëlqente e plot tipare të tjera. I shihnin nga mosha, të mos kalonin vitin e gjashtë e për më tepër, të mos kishin bashkëgjakësi me meshkujt, që pllenonin dhe fekondonin vezët e vjela. Po të mos kishte shkuar në këtë vend të mrekullueshëm, ca gjëra prej tyre nuk do t'i kishte mësuar, sikur gjithë jetën të merrej me rritjen e peshkut. Atje pa se si punohej e vrojtohej me mikroskop, për detaje që syri i njeriut nuk mund t'i kapë, kur asnjë nga fermat e kultivimit të peshkut në Shqipëri, nuk e përdor këtë mjet të domosdoshëm.

Këmbëngulja dhe përkushtimi i tyre në punë, thotë Sokoli, ishin vërtetë për t'u admiruar. Ai kujton një rast kur bashkë me danezin po bënin vjeljen e vezëve nga femrat, duke shtypur lehtë barkun e tyre. Të nesërmen kjo procedurë përsëritej sërish, pasi përfitohej dhe një numër vezësh ekstra. Kishim punuar gjithë ditën dhe mezi prisnim të pushonim. Një peshk rrëshqet akoma pa i vjelur vezët. Nuk ishin vetëm se diku tridhjetë vezë dhe i thashë ta linte se nuk përbënte ndonjë problem të madh. Por jo, danezi nuk më dëgjoi, shkoi ta kapë sërish peshkun që i shpëtoi vjeljes dhe pse iu desh,diku tek çerek ore kohë.

Sokoli u habit, kur mësoi se ushqimi që përdornin këtu në Danimarkë ishte gati një me një, që do të thoshte se një kilogram ushqim i konsumuar, prodhonte gati një kilogram peshk. E përse të merrte akoma ushqim nga Holanda e të mos e merrte këtu. Jo vetëm kaq, por u bë distributor zyrtar i firmës "Alleraqua", për të sjellë ushqimin e peshkut në Shqipëri. Një mirënjohje e një falenderim del thellë nga zemra e Sokolit për këtë vend të bukur e miqësor, për këta njerëz të mrekullueshëm, që dinë të bëjnë gjëra të mëdha dhe kur kanë vetëm pak mjete në dispozicion.

SYTË NGA E ARDHMJA: INVESTIME NË TURIZËM

Pronari grek i pat folur për turizmin shqiptar, por atëherë i qe dukur pak herët. Tani Sokoli mendon që është koha për turizmin malor në fshatin e tij, në Kovashicë. Plot të huaj kërkojnë të vizitojnë dy rezervatet e tij në këtë vend, që vetë Zoti e ka bekuar. Uji i gurrës rrjedh përmbi vaska me një nanurimë të këndshme, siç derdhen notat në pentagramin e kompozitorit. Lugina e Kovashicës plot lule në pranverë dhe verë, kodrinat me shkozë e dushk, mali i Bllacës, ai i Homeshit dhe mali i Bardhë, i qëndrojnë si kurorë këtij peizazhi mahnitës. Në faqen e kodrinës, përmbi ujin e gurrës së Kovashicës, biznesmeni i ri do që të ngrejë shtëpitë e para për turistët. Ndoshta do të jenë të punuara prej guri me damarë të bukur, të punuar nga mjeshtra të këtij zanati. Mishi i peshkut, i kecit, i shpendëve, bashkë me ushqimet bio, bashkë me mikpritjen e banorëve, do të ishin një tundim i papërballueshëm, për të huaj e vendas. Fshati me historinë e tij, me lashtësinë e tij, me mullirin dyqind vjeçar të fisit Leka, me "gropat e Ukut", ku u mblodhën fshatarët kryengritës dhe plot asete të tjera, flet shumë. Ata që duan më tepër se kaq, mund të shfletojnë librat e profesorit dhe historianit Bajram Xhafa, bir i këtij fshati dhe të shuajnë kuriozitetin e tyre.

Sokoli ka krijuar miq, lidhje dhe hapësira të reja. Një pjesë e kohës së tij kalon në Ukrainë, Kirgiztan, apo vende të tjera ruse, me të cilat e lidh një biznes i ri, tregtia e frutave të thata. Ai sjell prej andej ara të thata, lajthi, pse jo dhe fasule, të gjitha këto me një cilësi teje të lartë. Ndoshta në të ardhmen mund të punojë dhe në sensin e kundërt, të dërgojë në tregun rus prodhime të fermerëve shqiptarë. Sa herë i shkon mendja te mësuesi i dikurshëm i rusishtes dhe raskazet që kishte mësuar në rini të tij. Asgjë nuk shkoka kot në jetë, duhen koleksionuar gjuhët, zanatet, dituritë.

Koha rrjedh në shtratin e saj si ujët e gurrës së Kovashicës. Sokoli do vetëm pak infrastrukturë dhe ndihmesë të vogël nga shteti. Për të tjerat kujdeset vetë, pasi ashtu siç ka dhe emrin, është një "Sokol" i bizneseve të reja dhe të suksesshme në Dibër.

Rruga e Arbërit nr. 137

Shirat e rënë gjatë këtij muaji ndihmuan ndjeshëm në shuarjen e zjarreve që shkatërruan masivisht mijëra hektarë pyje e kullota.

SHTATOR 2017

Dibra në një muaj

Nga **Samet ZAGRADI**

DITA E KURBAN BAJRAMIT

Data 1 shtator këtë vit erdhi ndryshe për të gjithë besimtarët myslimanë në të gjithë botën, njëkohësisht edhe në Dibër. Dihet tashmë që pjesa dërmuese e popullatës së rrethit janë të besimit mysliman dhe rrjedhimisht kjo ditë ka qenë ditë festive për të gjithë. Stadiumi i qytetit u zgjua ndryshe të premten e 1 shtatorit, kësaj rradhe jo me lojtarët e Korabit, por me qindra qytetarë dhe besimtarë myslimanë, të cilët vendosën të falnin Bajramin pikërisht aty.

Festa e Kurban Bajramit është një nga dy festat më të rëndësishme të besimtarëve myslimanë. Sipas traditës islame kjo festë nderon gadishmërinë e Ibrahimit që flijoi djalin e tij Ismailin si vepër e nënshtrimit ndaj urdhërit të Zotit, para se Zoti të ndërhyjë përmes ëngjëllit të tij Xhebrailit dhe të njoftojë Ibrahimin se flijimi i tij është bërë tashmë.

Me pak fjalë fjala Kurban Bajram është festa e mposhtjes së nepsit që gjithmonë kërkon të jetë para. Pas faljes së namazit qytetarët u drejtuan në shtëpitë e tyre duke bërë kurban një kafshë të imtë e më pas duke e shpërndarë mishin te familjet që nuk kanë mundësi ekonomike ta kenë atë në këtë ditë të shënuar. Vizitat në familje të dashamirësve dhe shokëve nuk munguan gjatë gjithë ditës duke uruar dhe drekuar.

Atë ditë një pjesë e madhe e bizneseve dhe të gjithë institucionet ishin të mbyllura duke qenë që kjo festë është festë shumë e rëndësishme dhe festë kombëtare. Zyrtarë, përfaqësues se komitetit mysliman dhe myftynia e Dibrës uruan qytetarët për këtë ditë. Festa e Kurban Bajramit ndikoi pozitivisht për tregtarët, sepse puna ato ditë u shtua ndjeshëm duke qenë që qytetarët shpenzojnë më shumë se ditët e tjera për konsum.

ULJA E TEMPERATURAVE

Me ardhjen e muajit shtator duket se trokitjet e para të vjeshtës u dëgjuan tashmë. Vapa iku me gushtin, kjo tashmë është vërtetuar mjaft mirë në muajin shtator, ku vapa përvëluese që ishte këtë verë i la radhën aromës së vjeshtës. Ulja e menjëhershme e temperaturave dhe rreshjet e shijut dhe pse jo me një intensitet të lartë kanë bërë që dibranët të nxjerrin nga garderoba e tyre rrobat e tyre të dimrit.

Shirat e rënë gjatë këtij muaji ndihmuan ndjeshëm në shuarjen e zjarreve që shkatërruan masivisht mijëra hektarë pyje e kullota. Ndryshimi i menjëhershëm i klimës duket se ka ndihmuar ndjeshëm virozat dhe gjendjet gripale, duke bërë që vizitat në urgjencat dhe në qendrat shëndetësore të jenë më të shumta. Më të prekurit kanë qenë fëmijët dhe të moshuarit, por sipas mjekëve nuk është diçka serioze, pasi ndryshimi i menjëhershëm i temperaturave sjell këto viroza. Sipas sinoptikanëve ulja e temperaturave në këtë periudhë është diçka normale, pasi tashmë jemi në një stinë që karkaterizohet nga ky lloj moti. Stina e vjeshtës i paraprin një dimri të gjatë dhe të ftohtë, ku gjatë kësaj periudhe të gjithë bëjnë përgatitjet për të përballuar me sukses dimrit.

VJESHTË...

Stina e vjeshtës erdhi dhe për të gjithë dibranët duhet të themi që kjo periudhë është periudha e përgatitjeve për t'i përballuar me sukses dimrit të ftohtë dhe të acartë. Detyrat disa herë janë të ndara e disa jo, por e rëndësishmë është që të gjithë po përpiqen që të kontribojnë sadopak. Përgatitjet nisin nga sigurimi i lëndës drusore për të gjithë stinën e dimrit, sigurimi i ushqimit të bagëtisë apo dhe sigurimi i të mirave materiale të nevojshme. Gratë e zonës janë të njohura si mjeshtre të gatimit dhe përgatitjeve të zahireve të dimrit. Vjeshta njihet ndryshe dhe si stina e të vjelava dhe për këtë arsye këto gra përgatisin specialitete të ndryshme me perimet dhe frutat e stinës.

FILLOI VITI I RI SHKOLLOR

Të hënën e 12 shtatorit startoi viti i ri shkollor 2017-2018. Një ditë mjaftë e veçantë për të gjithë nxënësit e shkollave fillore, 9-vjeçare apo të gjimnazeve, të cilët i dhanë një ngjyrim tjetër qytetit dhe fshatrave. Drejtoria Arsimore Rajonale Dibër në bashkëpunim dhe me aktorë të ndryshëm, bënë që kjo ditë të jetë sa më e veçantë për çdo nxënës që ulet në bankat e shkollës. Organizata të ndryshmë dhe Shërbimi Social Shtetëror dhuruan një numër të madh çantash dhe mjetesh shkollore për fëmijët e familjeve me pamundësi ekonomike. Një sasi e konsiderueshme mjetesh kancelarike të mundësara po nga organizatat u shpërndanë në pothajse gjithë shkollat kryesore të qytetit dhe komunave rreth saj. Drejtoria Arsimore Rajonale Dibër së bashku me Zyrat Arsimore Mat dhe Bulqizë ka nën juridiksionin e saj dhe administron në arsimin parashkollor 145 kopshte me 4238 fëmijë nën kujdesin e 247 edukatoreve. Ndërsa në arsimin 9 vjeçar 96 drejtori shkollash me 25,160 nxënës dhe 1580 mësues. Në arsimin e mesëm me kohë të plotë 24 shkolla, 8 gjimnaze, të mesme të bashkuara 14 dhe 2 shkolla tekniko-profesionale me 6603 nxënës dhe 318 mësues.

KORABI DEBUTON NË STADIUMIN E TIJ ME FITORE

Ekipi i futbollit të qytetit të Peshkopisë që vitin e kaluar debutante në më të mirët e Shqipërisë është rikthyer të luajë në stadiumin e qytetit të tij, kësaj radhe si ekip i kategorisë së parë. Klubi në bashkëpunim me Bashkinë Dibër organizoi një festë mikpritje ekipit.

Ndeshja kundër ekipit të Burrelit ishte ndeshja e dytë e ekipit të Korabit për sezonin futbollistik 2017-2018. Një pjesë e parë tërësisht dominuese e ekipit tonë ku u fiksua dhe rezultati i pastër 3-0. Në minutën e 11 i riu dhe i talentuari i Korabit Armend Murrja shënoi golin e parë, më pas është Peci që dyfishoi shifrat në të 28-tën. Në minutën 28 sërish Murrja shënoi golin e dytë personal në ndeshje. Një pjesë e dytë disi e balancuar pa ndonjë rast shënimi. Të pranishëm në stadium ishin një numër i konsiderueshëm tifozësh, të cilët duket se nuk e kanë tradhëtuar ekipin e tyre më të dashur, pavarësisht kalvarit të vuajtjeve dhe rezultateve aspak pozitive që ka pasur.

Tani që fushata elektorale ka mbaruar, deputetët e zgjedhur, kryesisht të Dibrës, shihen shumë rrallë me votuesit. Edhe në rrjetet sociale, kryesisht në Facebooku, që shfaqeshin orë e çast gjatë fushatës, tani janë rralluar. Megjithatë, tani e rëndësishme edhe për votuesit, por edhe për publikun, është se çfarë qëndrimi po mbajnë ata në parlament në lidhje me ligje që miratohen dhe si interesat e komunitetit dibran përfaqësohen aty.

Ne mbetemi të hapur që qëndrimet e tyre të vijnë drejtpërddrejtë në faqet e gzetës sonë, gjë që nuk ndodh. Ndaj, ne e ndjejmë për mision, që herë pas here, në faqet e gazetës sonë të përcillet fjala e tyre. Si një domosdoshmëri e mbajtjes të hapur të kanaleve të informimit e komunikimit mes të zgjedhurve dhe zgjedhësve.

Redaksia

Mirëpresim çdo nismë ligjore që e lehtëson zhvillimin rajonal



***Nga* Almira XHEMBULLA**

Grupit i Miqve të Parlamentit Rulal do të mbështesë këtë nismë me fokus lobimin dhe advokimin për politika efektive të zhvillimit rural, të harmonizuara me legjislacionin e BE-së me qëllim që axhenda rurale dhe prioritetet e saj të reflektohen në politikat lokale, rajonale dhe kombëtare.

Si advokuese dhe lobuese e të drejtave të fermereve për më shumë se 10 vjet, i përulem me respekt punës, përpjekjeve dhe mundit e djersës tuaj. Për vite me rradhë të gjithë bashke jemi përpjekur të nxisim zhvillimin në zonat rurale duke promovuar produket dhe potencialet natyore.Sot une i kam hyre këtij rrugëtimi të ri, por me mendje dhe zemër ne bashkëpunim me kolegët do të punoj për të ndikuar në krijimin e një kuadri ligjor sa më të përshatshëm në favor të politikave zhvilluese rurale, sepse puna me ju më solli mua këtu dhe fati e deshi qe të takohemi edhe në këtë sallë.

Desha të ndalem në disa çështje që i konsideroj kyce për zhvillimin rural dhe që për fat të mirë janë pjesë e programit të qeverisë shqiptare ku fokus këtë mandat do te ketë rilindja rurale.

Finalizimi i reformes se prones ne zonat rurale do te nxise padiskutim inisiativat afatgjata ne zhvillimin e sipermarrjeve ne bujqesi dhe turizem. E drejta e paqarte e prones ka qene nje faktor pengues kyc ne zhvillim duke qene qe edhe te gjitha llojet e mbeshtjeve qofshin ato grante apo kredi e kane si kriter certifikaten e pronesise.

Permiresimi i infrastruktures ne pergjithesi, por ndertimi i kanaleve vaditese dhe rrugeve te prodhimit ne vecanti do te rrisin akoma me shume prodhimin dhe aksesin ne treg.

Certifikimi i produkteve, marka lokale, zhvillimi i agroindustrise dhe rritja e paketes se sherbimeve turistike ne zonat rurale do te ndikojne ndjeshem ne rritjen e te ardhurave te fermereve apo sipermarresve ne zonat rurale.

Por ajo qe do ta konsideroja sfide per ne edhe per ju mbetet konsolidimi i fermes dhe rritja e aksesit ndaj fondeve te bashkimit evropian. Skemat e subvencioneve dhe incentivat e deritanishme nuk kane arritur te bejne aq sa duhet ne kete drejtim prandaj te gjithe bashke duhet te shikojme duke ju referuar edhe praktivave te mira nga vendet europiane per menyren me te mire per ta adresuar kete prioritet.

Nese ka nje gje qe ka ndikuar direkt ne fuqizimin ekonomik te grave dhe permiresimit te pozites sociale te tyre eshte pikerisht mbeshtetja e grupeve prodhuese apo grave sipermarrese ne zonat rurale. Por ajo qe dua te them eshte qe drejta e tokes per grate krijimi i lehtesirave fiskale dhe dhenia e kredive te buta duhet te jene pjese e politikave tona ne kete drejtim.

Vitet e fundit gjate pjesemarrjes ne panaire dhe ne aktivitete te ndryshme ne te gjithe Shqiperine me ka bere pershtypje nje fenomen shume pozitiv. Vajza dhe djem te rinj perkrah prinderve te tyre duke u kujdesur pa komplekse per marketimin e prodhimeve dhe shitjen e tyre. Eshte rritur interesi i tyre padyshim por duhet te jemi te vemendshem ndaj kesaj dukurie. Arsimi professional i te rinjve duhet te bazohet ne nevojat qe kane familjet rurale dhe nevojat per permiresim paketash e sherbimesh.

Ne ministrine e ceshtjeve rurale ne Suedi kishte edhe fonde te vecanta per rritjen e interesit te rinise per te jetuar ne zonat rurale. Fillimi i mbare gjysma e punes. Qasja juaj nga niveli lokal drejt atij kombetar padyshim do jete celesi i suksesit te kesaj nisme.

Bashkepunimi me universitetet apo trupat profesionale dhe riaktivizimi i sherbimeve te ektensionit eshte nje domosdoshmeri ne kushtet ku duam te rrisim cilesine dhe sasine e prodhimit pa ulur vlerat per te arritur tregjet nderkombetare.

Ka shume per te bere dhe jemi te gjithe koshient per kete por sot jemi ketu, parlamenti rural eshte me i paster se kurre, i mbushur me njerez qe me punen e tyre te palodhur gjenerojne te ardhura per familjet e tyre, prodhojne produkte cilesore per konsumatorin shqiptar e jo vetem dhe promovojne e nxisin zhvillimin e turizmit duke ruajtur natyren dhe duke u kujdesur per mjedisin.

Nuk dua te zgjatem ne teknikalitete se jam e bindur qe te gjitha hallkat e zinxhirit te vleres te zhvillimit rural jane diskutuar me se mire keto dite.

Por ne emer te grupit te miqve te parlamentit rural ju shpreh edhe njehere gadishmerine tone per te bashkepunuar me te gjithe ju per krijimin e politikave favorizuese ndaj zhvillimit rural dhe zhvillimit te strategjive sipas standarteve evropiane. Ne do te mirepresim cdo inisiative ligjore qe e lehteson kete zhvillim.

(Botuar me shkurtime. Fjalë e mbajtur gjatë seancës së Parlamentit Rural, një veprimtari e organizuar nga Rrjetin Shqiptar për Zhvillimin Rural)

këndi i deputetit

Qarku Dibër futet në ato zona ku mungojnë mjekë të domosdoshëm për jetën. Një problem i prekshëm është ai i të sëmurëve me hemodializë.

Fjala e mbajtur në seancën e prezantimit të programit të qeverisë,13 shtator 2017



Dibrës i mungojnë mjekët, mësuesit, investimet publike...

Nga **Xhemal GJUNKSHI**

Si një deputet i ri në Kuvendin e Shqipërisë, e ndjej për nder dhe privilegj të përfaqësoj zgjedhësit e mi, popullin e Qarkut te Dibrës në këtë tempull të demokracisë shqiptare. Gjej rastin t'i falenderoj sot ato nga zemra dhe tu premtoj se do të jem zëri dhe zëdhënësi i tyre në këtë Kuvend, e së bashku me deputetët e tjerë të Partisë Demokratike, do të bëjmë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur problemet e tyre dhe realizuar idetë.

Qeveria e Rilindjes që erdhi në pushtet katër vite më parë duke j'u premtuar shqiptarëve parajsën ekonomike, stabilitetin ekonomik, rend dhe qetësi, luftë krimit, korrupsionit dhe trafiqeve, integrimin euroatlantik, etj, do të mbahet mend si e vetmja qeveri postkomuniste që nuk mbajti asnjë nga premtimet elektorale që e sollën në pushtet.

Sot me mandatin e siguruar me votat e blera nga paratë e drogës, kjo qeveri n'a paraqet të ashtuquajturin pseudo program qeverisës për katër vitet e ardhëshme. Nga prezantimi i këtij programi qe nga Kryeministri vërehet se mashtrimi dhe fasada e kësaj qeverie vazhdon.

Kështu, n'a paraqitet sikur qytetarët shqiptarë në katër vitet e qeverisjes së rilindjes, kanë përjetuar një parajsë ekonomike. Këto mund të tregohen vetëm si përralla, ky është një turp ku realiteti tjetersohet në mënyrë të tillë duke e bërë të pa besueshme cdo gjë që u tha nga Kryeministri.

Realiteti është krejtësisht ndryshe. Në vend të 200 mijë vendeve të punës të pretenduara si të shtuara, janë 200 mijë të larguar nga Shqipëria në vendet e BE- së, për shkak të pamundësisë për të siguruar kushtet minimale të jetesës.

Gjatë katër viteve të qeverisjes së Rilindjes janë shtuar personat që jetojnë në varfëri, janë përkeqësuar shërbimet publike, kjo edhe si rrjedhojë e të ashtuquajturës Reformë Teritoriale. Kështu, në Qarkun e Dibërs, për të përfituar një shërbim qytetarëve u duhet të bëjnë dhjetra kilometra rrugë nga zona e thella rurale. Ne Lure mungon sherbimi stamatologjik (nuk ka dentist). Per te hequr nje dhemballe nje fshatari ju desh te shkoje nga Lura ne Peshkopi dhe te kthehet ne nje rruge dhe ne nje teren shume te thyer malor.

Kujdesi shëndetësor është përkeqësuar. Kjo si rrjedhojë e mungesës së përsonelit mjeksorë në të gjithë qarkun, kushteve të këqija në qendrat shëndetësore, mungesës së ilaceve dhe medikamenteve mjekësore, mungesës së pajisjeve, investimeve në infrastrukturën mjeksore, korrupsionit etj.

Qarku Diber futet në ato zona ku mungojnë mjekë të domosdoshëm për jetën. Një problem i prekshëm është ai i të sëmurëve me hemodializë. Zoti Kryeminister nga koncensionet e dhena nga qeveria Juaj eshte dhe ai i hemodializes. Per kete ju keni ngritur pese qendra, nga keto dy ne veri. Nje ne Shkoder dhe nje ne Lezhe.

Ne Diber mungon sherbimi i hemodializes. Dibra eshte harruar. Jane mbi 80 persona nga dibra te cilet vuajne nga hemodializa. Jane dhjetra familje te cilat kane ardhur dhe kane marre shtepi me qira ne Tirane per te mare kete sherbim. Jane me dhjetra familje te tjera te ciat shkojne ne Oher dhe ne Shkup per te mare kete sherbim shendetesor. Kerkoj nga ana e juaj ofrimin e ketij sherbmi per qarkun Diber.

Të ardhurat reale të punonjësve gjatë katër viteve të kaluara nuk u rritën sic pretendohet, por përkundrazi u ulën. Për katër vite qeveria e rilindjes jo që nuk rriti pagat e pensionet, por nuk bëri as kompensimin e tyre për efektet e inflacionit, e për rrjedhojë pagat e pensionet pësuan ulje për çdo vit të qeverisjes së rilindjes. Pensionistët marrin pensione minimale pasi Dibra si një vend bujqësor shumica e pensionistëve kanë përfituar pensione mbi bazën e viteve të punës në ish Koperativat Bujqësore. Edhe këto pensione realisht u ulën si rrjedhojë e mos kompensimit real të tyre nga ndikimi i rritjes të energjisë elektrike. Banorët e këtij qarku janë ndër më të varfërit në Shqipëri, ndoshta më të varfërit.

Niveli arsimor në Qarkun e Dibërs jo që nuk është përmirësuar por është përkeqësuar në krahasim me vitin 2013. Kështu, u mbyll filiali i Universitetit " A. Moisiu " në Peshkopi duke u mohuar të drejtën qindra nxënësve për t'u diplomuar në një degë universiteti. Dibranët janë shumë arsimdashës, por për arsye ekonomike jo të gjithë kanë mundësi të vazhdojnë një degë në universitet. Filiali u hap nga qeveria e Partisë Demokratike si nje domosdoshmëri për kushtet e Qarkut Diber, kurse qeveria e Ririndjes e mbylli këtë filial për shkak të të ashtuquajturës reformë në arsim.

Gjendja e shkollave dhe infrastruktura e tyre në Qarkun e Dibërs është përkeqësuar. Mungojnë ambientet e përshtatëshme, pajisjet mësimore, sistemi i ngrohjes apo lënda drusore. Gjithashtu, ka rënë niveli i mësimdhënies në shkollat e ciklit fillor e nëntëvjecar. Si rrjedhojë e spastrimeve politike janë hequr dhjetra mësues me eksperiencë dhe të kualifikuar dhe janë zëvendësuar me persona pa arsim përkatës. Në shumë shkolla japin mësim në lëndë të ndryshme mësues që nuk kanë diplomë për të dhënë këto lëndë mësimore, japin lëndën e gjuhës së huaj mësues që nuk dinë asnjë fjalë në atë gjuhë.

Në katër vitet që kaluan qeveria ka mbajtur një qëndrim armiqsor me biznesin. Si rrjedhojë e kësaj politike në qarkun e Dibrës janë mbyllur qindra biznese. Bisnesi i vogël ka marrë një goditje edhe për shkak të paksimit të konsumit familjarë si rrjedhojë e uljes së fuqisë së tyre blerëse. Këtij biznesi jo vetëm nuk i janë hequr taksat sic pretendohet, por i janë rritur. Goditjen më të madhe në këtë qark e ka marrë agrobiznesi. Në qeverisjen e Partisë Demokrtike në qarkun e Dibërs mori një zhvillim të kënaqshëm agrobiznesi, kjo si rrjedhojë e politikave të donacioneve qeveritare në bujqësi e blegtori. U mbollen plantacione të tëra më frutikulturë, u ngrit infrastruktura për blektorinë, u shtuan tufat e bagëtive të imta, u financua ngritja e infrastrukturës së përpunimit dhe ruajtjes së prodhimeve bujqësore dhe blegtorale. Ndërprerja e donacioneve nga shteti për bujqësinë, frutikulturën dhe blektorinë ka bërë që shumë nga fermerët dhe blektorët t'i mbyllin këto aktivitete, duke pësuar humbje të konsiderueshme dhe rritur papunësinë e zonave përkatëse. Këtu ka ndikuar edhe mos mbrojtja e këtyre prodhimeve nga konkurenca e prodhimeve të importit.

Propagandoni dhe synoni një Shqipëri integruese drejt Europës edhe përmes zgjedhjeve të lira dhe votës së lirë. Dibra është modeli më i keq i kësaj perspektive duke dhënë modele të cilat janë kthyer në humor rrjetesh socilae dhe bisedash të përditshme. Në dy zgjedhjet e fundit ato lokale dhe të fundit u demonstrua në mënyrë të frikshme blerja e votës, përmes parave të drogës. As Dibra nuk i shpëtoi në katër vitet që kaluan kultivimit në masë të drogës duke shkaktuar edhe dëme ne blegtori dhe në bletari. Kryeminstri i vendit vetë ka deklaruar që pastruam Shqipërinë nga mortja (droga kanabisi). Po zotëri pasi e mbolle e korre dhe bleve votat, tashmë po e pastron. Të shohim...

Do ndalem pak më shumë këtu pasi Dibra u përdor për të dhëne këtë model që në zgjedhjet lokale duke përdorur në fushatat adminstratën shtetërore, duke përdorur haptazi policinë e shtetit si në asnjë rast tjetër të mëparshëm. Dibra u deklarua si vendi ku mund ta blesh votën dhe të bësh pazare. Në zgjedhjet e fundit kësaj skeme iu bashkëngjiten edhe dy partitë e tjera të cilat luftuan po të njëjtat mënyra.Drejtuesit e Policise se Qarkut Diber jane thellesisht te lidhur me krimin dhe ne sherbim te zellshem te krimit dhe te grupeve krimanele.Te vetmit drejtues qe ju zoti Kryeminister nuk mundet ti ndryshonit para fushates. Edhe gjate fushates me gjithe propozimin e Ministrit te Brendshem teknik ju i mbajtet. Tregoju dibraneve se cfare do te thote kjo! Si mundet qe ne Diber dhe ne gjithe Shqiperine do te kete siguri!

Madje u shkua edhe më tej. Për votën nuk u përdorën vetëm paratë e drogës por u rrit fiktivisht dhe në afate parazgjedhore numri i njerëzve që merrnin ndihmë ekonomike ne mijra persona.

Ndërkohë për të pasur sa më shumë mbështetës u shtuan po fiktivisht vende pune në administratë.Bashkia Peshkopi ne vitet 2014-2015 ka patur gjithsej 249 punonjes (administrate, artiste, çerdhe, konvikt, sport, roje) njesite vendore kane patur mesatarisht 10-12 punonjes per njesi. D.m.th rreth 140 punonjes per te gjitha njesite. Nga kjo llogaritje,totali per rrethin Diber (bashki + komuna) ka qene rreth 390 punonjes ne vitet 2014-2015 .

Nderkohe, sot aktualisht ka rreth 869 (235%) punonjes me shume ose le te themi me shume se dyfish. Shtoj qe njesite administrative jane pa asnje funksion e kompetence, jane vetem çerdhe militantesh.

Qarku i Dibres ka burime te konsiderueshme hidrike. Nga qeveria aktuale është miratuar dhënia me koncension e ndërtimit mbi lumin Setë të një HEC-i , " SETA 4". Miratimi i koncensionit ka hasur në resistencën dhe protestat e banorëve të zonës, për arsye se nga ministria përkatëse është ndryshuar projekti fillestar. Ndërtimi i këtij HEC-i dëmton rëndë mjedisin, historine e zones dhe zhduk një specie të rrallë peshku. Siç jeni në dijeni banorët e fshatit Arras janë ngritur në protestë dhe 20 kryefamiljarët e fshatit janë dhënë për ndjekje penale. Si përfaqësues i banorëve të kësaj zone u bëj thirrje instancave përkatëse që të ulen me banorët e saj për zgjidhjen e këtij problemi. Në zonën e Dibrës ka mungesë të theksuar të insfrastrukturës vaditëse e cila nuk lejon zhvillimin e zonës.

Dibra është ndër zonat më të pasura të vendit me burime të ujit të pijshëm. Këto burime janë nga më cilësoret në shkallë vendi. Janë ujëra si kristali, që burojne nga bjeshkët e Korabit, Lurës etj. Me këto burime mund të plotësohen jo vetëm nevojat e banorëve të Dibërs por edhe më gjërë. Por fatkeqësisht sot këto ujëra, kjo pasuri e cmuar që n'a ka falur natyra, derdhën në lumin Drin dhe shumica e dibranëve vuajnë për ujë të pijshëm. Kështu, mungon uji i pijshëm në qytetin e Peshkopisë dhe në dhjetera fshatra anembane Dibres. Fondet e dhëna nga buxheti për ndërtimin e ujësjellësave, janë shpërdoruar. Kjo qeveri edhe për katër vitet e ardhshme nuk ka një program konkret për furnizimin me ujë të pijshëm të banorëve të Dibres.

Në programin e paraqitur është parashikuar ndërtimi i Rrugës së Arbërit, rrugë që ishte premtim elekroral i kësaj qeverie për t'u ndërtuar në katër vitet që lamë pas. Por populli i Qarkut të Dibërs e përshëndet dhe e pret me padurim ndërtimin e kësaj rruge qe është jetike për atë qark. Më mirë vonë se kurrë thotë populli. Por ne jemi dyshues për mënyrën se si po veprohet për ndertimin e kësaj rruge për dy gjëra: - Pse financimi i saj nuk u bë nga buxheti i shtetit por u ndoq rruga e koncensionit? Deri më tani ka shprehur interes vetëm një subjekt për ndërtimin e Rrugës së Arbërit. A do veprohet vetëm me një ofertues për t'a shpallur fitues atë? – Në kriteret për ofertuesit është vënë kushti që koncensioneri nuk vendos taksë për mjetet, po shteti do vendosë një taksë të tillë ? Nga Ministri i Energjise dhe Infrastruktures u deklarua se do te duhen dhe 100 dite te tjera per te perfunduar procedurat. Punimet nuk do te fillojne kete vit sipas premtimit elektoral qe eshte bere.

Populli i Qarkut të Dibërs kërkon fillimin dhe mbarimin sipas premtimit të bërë të Rrugës së Arbërit si dhe qarkullimin pa pagësë të mjeteve në këtë rrugë.

Nevojat e qarkut Dibër nuk fillojnë dhe mbarojnë me rrugën e Arbrit. Dibra nuk ka rruge. Nevojat janë të shumta për rrugë të tilla si: Rruga Cerren-Kalaja e Dodë- Rodomirë-fushë e Korabit, Arras – Lurë, Lis-Muhurr, Staravec- Zimur, Lixha-Bellovë (ndërtimi i urës në këtë fshat)-Cerjan-Zagrad-Ravdishtë, Luzni-Lishan i epërm, Luzni-Hotesh dhe lidhje me Liqejtë e Lurës. Rruga Kurbnesh-Lurë është mjaft e rëndësishme.

Ndërtimi i këtyre rrugëve do të bënte të mundur zhvillimin e turizmit malor dhe të kulinarisë. Do t'i jepte hapësirë ekonomisë dhe mirëqenies së këtyre zonave. Zona e Dibrës ka resurse mjaft të vecanta turistike si; Lura, mali i Korabit dhe Lugina e Drinit, të cilat po të ishin rrugët do të ndikonin direkt në promovimin dhe ekonominë e zonës.

Në qeverisjen Rama 1, " Rilindja Urbane " ishte një fasadë që u trumbetua si ndër sukseset më të mëdha. Kësaj fasade nuk i shpëtoi as qendra e qytetit të Peshkopisë.

Nuk jemi aspak kundër përmirësimit estetik të qëndrave të banuara, vecanërisht të qyteteve pasi ata janë kontakti i parë i cdo vizitori, por qendra e qytetit të Peshkopisë ka qenë ndër qendrat më të mira të tyre. Bulevardi kryesor me pemët e blinit ishte ndër më të bukurit dhe shumë relaksues.

Në kuadrin e fasadës së " Rilindjes Urbane ", qeveria e Rilindjes në bazë të një projekti shumë të kushtueshëm e ka shëmtuar qendrën e bukur të qytetit të Peshkopisë. Projekti i rikonstruksionit të qendërs së qytetit është një nga projektet më të këqinj të mundshëm. Ky projekt i shëmtuar i ka kushtuar miliona Euro taksapaguesve shqiptarë. Me këtë projekt u shëmtua qendra e qytetit vetëm për përfitime korruptive elektorale nga ky investim. Për të rritur shpenzimet e projektit gurët për shtrimin e bulevardit jane marre nga mali i Tomorrit, thua se nuk kishin gurë dekorativ malet e Dibres. Por është harruar një gjë shumë e rëndësishme se këta gurë përvec faktit se ngjyra e tyre nuk shkon me ambientin, këta nuk i rezistojnë klimës së ftohtë të Dibërs e për rrjedhojë që tani kanë filluar të thërmohen.

(Botuar me shkurtime)

Rruga e Arbërit nr. 137

105 vjetori
i Luftës së Qafës së Kolesjanit, 1912

histori

Variante të këngës **historike** për **luftën** në Qafë **të Kolesjanit**

Nga **Dr.Fejzulla GJABRI**

Beteja e Qafës së Kolesjanit, e cilësuar si "Termopile Shqiptare" u zhvillua në truallin Nangë-Bicaj-Kolesjan. Organizatori është prijësi popullor Islam Spahia. Ndaj dhe personazhi kryesor në këngë është po ky Islam Spahia, person e familje me mjaft ndikim në ato vite të vështira të kombit shqiptar. Gjithesi jemi te kënga.

Brenda Lumës ka disa variante që nga Vermica e deri në Veleshicë, që nga Drini i Zi e deri në malet e Sharrit. Variantet nuk mungojnë në Dibër, Kosovë, Has, Mirditë e më tej. Përgjithësisht nuk mungojnë 4 vargje, gati si të eposit: "Sheja e Vogël kullon gjak,/ po i thotë Drinit:-Nihmom pak" dhe "Kllade t'mdhoja jam te çue,/ N'Shkodër t'Vogël me i kalue". (Bicaj) Kënga bazë e Luftës së Lumës më 1912, pothuajse është e njohur, ndaj duke i kaluar disi anash në ketë material, tani për tani, hyjmë në organizatorët, luftëtarët dhe shehitët e kësaj beteje. Populli të gjithë të rënëve në luftë kundër serbit, u thotë shehitë. Të gjithë këtyre organizatorëve dhe të rënëve, folklori i ka shpërblyer me këngë. Së pari, Islam Spahinë, organizatorin dhe luftëtarin më pranë betejës: "Islam Spahia burrë i thajm,/ me Serbien tajm e n'tajm,/ Tajm e n'tajm mu te kulla,/ E mtoj Serbia se paska burra./ .../ "(Kolesjan). (mtoj-e pa).

PËRTEJ TRUALLIT TË LUFTËS

Lusna kishte prijës Ramadan Çajkun, që "s'u ndanë asnjëherë me Islam Spahinë" (T.Kolgjini, Luma dhe luftërat e saj, shënimi i Agim Spahisë). Vargjet: "Huxhum Lusna e Ramadani,/Bini gjem se shkoi vatani,/Ç'ka me ba Ramadani i zi,/Te luftu me di krajli,/ Karadak e me Serbi./.../," (Lusën). Një këngë radomirase ngre lart figurën e Ibrahim Haxhi Zeqirit: "Radomira me bajrak,/S'nalet sërpi jo pa gjak,/..../Brahim Haxhi Zeqiri,/Pushkë e kollan,/mirë i lidhi,/Merr avdes e del n'mejdan,/Jo për nesër, po sot ban bam./.../." (Radomirë)

Riti i abdesit sikur forcon besimin në fitore, si shprehje e psikikës së luftëtarëve. Ankimet e armikut janë të kreut të tij: "Qysh se u nisa nga Beligradi,/Nuk kam pa ksi mahlukati,/..../ Nuk ka udhë e nuk ka shtek,/Ven për ven pushka kërset./Tan serbia ktu me ardhë,/Sall te nja s'pështon i gjallë." (Lumë)

Kënga veçon e përgjithëson. Veçon organizatorë, vlerëson shehitë, ngjall vrull: "Qazim Lika e Bajraktari,/Qazim Lik'e e Beram Gjana,/Rrallë ksi trimash i ban nana,/.../ (Bushtricë).

NDIHMA E ELEZ ISUFIT

Në Bicaj: "Pak pa plasë boumes ia ngjiti,/ Stojniçit ia kthej opet,/ e la dekun me gjyle t'vet...". Është fjala për Nexhip Dullën. Një këngë e këtyre kohëve tregon për lidhje me Hasan Prishtinën e në ndihmë të tij të dyqind djemëve lumjanë: "N'kullë të Lumës janë bashkue,/Dyqind gjem kanë bisedue,/Sulë Elezi foli ni fjalë:/-Kush asht burrë e kush asht gjalë,/Hasan Prishtinës zot me i dalë,.../ (Morin). Ndihma e Elez Isufit dhe e Baftjar Dodës vlerësohen në këngën lumjane, si organizatorë e si luftëtarë. Duke përmendur topat, duket sikur rritet vlera e ndihmës: "N'Kolesjan kallet baroti,/Ndihmë po vjen Elez Isufi./ Vjen Elezi me di topa,/ ki Sen Daci



Kënga bazë, siç mund ta quajmë atë të krijuar e kënduar afër një shekull në Lumë, (Ka 69 vargje e botuar në "E.Historike 3), ka më tepër se të gjitha variantet, heronj që veprojnë e nxisin luftën. Veç Islam Spahisë, Dy Ramadanëve e të tjerëve, janë Molla Xhema, Hoxhë Bicani, Ali Bakalli si dhe kundërshtarët Krajl Nikolla e Petro Krajli.

i komandoka." (Kalis). Këngë me ketë tëmë gjen për çdo fshat. Ka Bardhoci, Shtiqni, Pobregu, Ujmishti, Surroi, Mamëzi, etj.

DHIMBJA PËR TË RËNËT

Grimcat e shënuara janë vetëm ilustrim i një qëndrese, ndoshta pas gjëmës së madhe të masakrave serbe, ndoshta si kundëpeshë e dhimbjes së madhe. Dhimbja e parë është humbja e luftëtarëve e drejtuesve popullorë në këtë luftë, të cilët nuk janë pak. Ne jemi mësuar vetëm të dëgjojmë humbjen e 12 mijëve të serbit, po, me që kënga i ka përjetësuar njerëzit tanë, duket si lehtësim i dhimbjes për ta. Ata janë shumë. Do jetë nder e shenjë kulture e qytetërimi, sikur t'i kemi të shënuar të gjithë në një memorie të veçantë, ku të lexohen në raste përkujtimore. Kjo, se kënga duket pak a më saktë, një rreth i ngushtë njeh vetëm të vetët. Dhimbja e dytë janë masakrat pas 1912-ës. Tash më jo me burra, po me "cullë e gra". Këtu bien këngët dhe shtohet pesha e dhimbjes. Memoriali i cekur më parë, për të parët e të dytët (të masakruarit), do ishte shenj qytetërimi, ku dhe të tjerë do mësonin gjëmën.

VARIANTE DHE LUFTËTARË

Deri këtu janë cekur vargje të këngës lumjane. Dihet se ushtima e kësaj beteje i kalon caqet lokale. Me këtë lëndë (të Betejës Lumës), janë thurur këngë nga dibranët, gjakovarët, mirditorët, në mbarë Kosovën etj. Këngët e cituara janë në funksion të identitetit, që folklori e ka detyrë parësore të japë këngë për bëma të tilla, po gjithnjë sipas ligjeve të veta. Në Dibër këndohet: "N'at Stamoll këndon gazeta,/Mjer dovleti për ilçe t'veta,/..../

N'Prizren po ban kuven,/I thotë Lumës:-Lirom ven,/Lirom ven, lirom vatan,/Të piqëmi n'Kolesjan". (Dibër, 1944). Në Kosovë: "Ça kan' kodrat qi gjimojnë?/Has e Lumë, medet po luftojnë,/N'at Serbi shumë vajtojnë,/.../ Shum' askeri ma myt n'Dri,/Shumë milet m'ka metë n'Shqipni,/Me tefter dymdhet mijë!" (Kosovë, 1939).

Në Shupenzë të Dibrës, një variant përmend emrat e luftëtarëve Ramadan Selmani e Hoxhë Mehmeti, duke marrë thelbin e këngës "Luma e serbi po luftojnë": "..../Kur fikati Ramadan Selmani,/Bini, voca, se shkoi vatani,/Kur fikati Hoxhë Mehmeti,/ Ka krisë pushka, gjimoi kepi./.../.(E.Historike 3, F.79). Në Mirditë kënga përmend Reç e Dardhë që: ".../Luftojnë trimat malsisë,/Për të drejtat e Shqipnisë./Prej Reçi e n'Kolesjan,/ Për liri e për vatan,/.../". (Kurbnesh, 1960). Në fshatin Grevë të Dibrës me një variat të kësaj kënge, shton shehitët e Betejes së Lumës me Has Fidën e Xhemali Ramën, që vihen në krah të Islam Spahisë: "-Ku i ka shokët Islam Spahia,/N'at Gjalicë e nër frengjia,/Nër fregjia tuj çënrue,/Hikën sërpi, majtet n'prrue./.../Çaj Has Fida n'tum'të ferrës,/Sa ma shpejt i jep manzerres,/.../Kur bërtajti Xheladin Rama,/N'Stamoll i ka shkue xhama." (K.Historike 3,f.84).

KËNGA NDËR BOTIME

Kënga bazë, siç mund ta quajmë atë të krijuar e kënduar afër një shekull në Lumë, (Ka 69 vargje e botuar në "E.Historike 3), ka më tepër se të gjitha variantet, heronj që veprojnë e nxisin luftën. Veç Islam Spahisë, Dy Ramadanëve e të tjerëve, janë Molla Xhema, Hoxhë Bicani, Ali Bakalli si dhe kundërshtarët Krajl Nikolla e Petro Krajli. (E.Historike 3,f.80).

Para se të japin vlerat përgjithësuese të këngës së 1912-ës, që shtrojnë çeshtjen e sakrificës në altarin e atdheut, si kërkesa të shejta e legjitime, të ndalemi pak në atë gëzim të pakët të ngritjes së flamurit. Brenda trevës së Lumës çështja e flamurit ishte vetë lufta. Haberet nga Vlora nxjerrin urimin: "/.../Tungjatjeta, Smail, qysh thue,/Për flamur n'kam jem çue,/.../" (Shalqin, 1978).

Siç kuptohet edhe nga këto vargje, lufta bëhet për flamur. Duket si një mesazh i dyzuar. Së pari urimi dhe së dyti njoftimi. Urimi për flamurin dhe së dyti se edhe ne po për ketë luftojmë. Disa krijime të tjera, të thurura vonë, nuk e marrin vlerën e qarkullimit, pasi kanë në kompozimin e tyre pjesë shkollareske. Ja një shembull: "..../Bashkë me trima, bijë të Arbërit,/Nga Dyrrahi, n'bjeshkë t'Korabit,/E prej Shkupit në Janinë,/ N'Vlonë shpallën Pavarësinë,/.../"(K.Historike, 1985). Me gjithë konceptimin e qartë, duket dora e thurjes jashtë ligjeve të folklorit.

MESAZHI REFERENCIAL DHE ESTETIK

Këto do të ishin disa vargje të këngës me temë Luftën kundër serbit më 1912, që po të sistemohen do ishte një epos në vete. Kënga e plotë, me të gjitha variantet jep mjaft mesazhe. Mesazhi i parë është referencial: Po bëhet luftë kundër një ushtrie të organizuar: "Xhit kanë malet që gjëmojnë?/-Gjemt e Lumës po luftojnë". Thirrjet "bini burra!", "bini gjem" e të tjera të këtij lloji kanë karakter emotiv dhe hynë natyrshëm në kompozicionin e këngës. Shpesh këngët kanë edhe mesazh urdhërues-betues, kjo veçmas për armikun: "Tan Serbia ktu me ardhë,/Sall te nja s'pështon i gjallë!". Mesazhi estetik synon të tërheqë vëmendjen e marrësit, gjegjësisht të lexues – dëgjuesit. Vetë struktura e këngës është e tillë që rrëfimi kombinohet me elemente lirike, që zhvillojnë imagjinatën, të bën të meditosh. Do t'ia vlente ta ilustronim me shumë vargje, të cilat nuk mungojnë, ndër të cilat po veçojmë : "Po rrjedh Sheja plot me gjak,/Po i thotë Drinit: -Nihmom pak!". Ky përfytyrim eposi, na çon në hershmëri, na bën të mendojmë për fenomenet e natyrës dhe mrekullitë natyrore, huazime të njeriut modern, që i merr nga lashtësia. Me ketë gjuhë, me gjuhën e artit, këngët shfaqin fakte kulturore të një populli të lashtë, siç është populli shqiptar në Ballkan. Këto mesazhe janë kode të kulturës tonë në përbërje të gjithë kulturës ballkanike e më gjerë. Do të ishin këto disa fakte me të cilat ne komunikojmë me historinë tonë, e cila flet se është më shumë e dhimbshme e pak e gëzueshme.



Më shumë mund të shikoni në faqen e gazetës në FB: Rruga e Arbërit ose ndiq linkun:
https://tinyurl.com/lcc3e2f

Bëj një abonim online ose në print...

Kushton vetëm 600 lekë në vit...

email: rrugaearberit@gmail.com

opinion

E ndërsa pyjet prej dushku shungullonin nga flakët e tmerrshme, të frikshme, inatçore të përbindshme, fshatarët ngritën kokën nga qielli dhe hapën dy duart të shtrira në formë lutëse dhe filluan me kor të bërtisnin me zërat e dhimbsur, por revoltues...

Përse ma **dogje pyllin,** të vraftë Zoti?

Nga **Dr. Selman MEZIU**

Ulargova i pezmatuar nga fshati midis ujërave, kodrave majëmprehta e të rrumbullakta, luginave të shtruara e lëndinave të shumta. Njerëzit ishin zgavëruar nga pesimizmi, dukeshin nga fytyra, por edhe nga bisedat. Dritat e shpresës ishin shuar si vetëtima në të mijtën e sekondës edhe pse bubullimat të zgjonin edhe nga një gjumë i thellë. Por unë lashë prapa kodra, shpate, qafa, lugina të gjelbërta nga dushkajat të harlisura. Kurorat e larta, trupin e drejtë me rrënjët e tyre të e shumta ngulur thellë në tokën e trashë, i rezistonin vapës përvëluese të kësaj vere të pazakont për mrekulli. Ndaj në shpirtin tim u mboll pema e besimit dhe e mirënjohës e njerëzve të fshatit të lindjes që punonin e gëlonin të kalonin ditët muajt e vitet përmes dhimbjes së papunësisë e varfërisë, sëmundje që po vazhdon me kohë tejet të gjatë.

Por ja, ndjellakeqit nuk i shpëtuan masivet prej bunge, shpardhi, qarri, frashëri, dëllinje etj. Ato u thanë, u vyshkën, u përzhitën, morën ngjyrën e mykut të bukës nga gjuhët e zjarrta të flakëve të pabesisë. Po kush ishte ajo dorë e zezë, ajo ndërgjegje e shfytyruar? Njeriu që u shit për para! Ndoshta! Apo nga ato që morali u ishte shëndruar në mace të zezë! Pse jo ishte ndonjëri që në sofrën e drunjtë nuk kishte as bukë për fëmijë! Bari nuk ishte, sepse këndej nuk rekton as edhe një këmbë dhie apo deleje! Mundet të ketë qenë një i ri, mesoburrë, ku një ziliqar partie e ndërsej për hakmarrje, për të mbjellë panik nëpërmjet tokës së djegur. Hamendjet bredhin në hapësirën e mendimeve si yjet e shuar nga retë e zeza sterrë që përgatitin shtërngata shkatërrimtare shiu e furtune.

Nuk thotë kot populli: "Mali ka veshë, fusha ka sy..." Vërtet kështu ndodhi një orë para dreke, kur banorët e pakët të Fushë Muhurrit lajmëruan me za të dridhur e telefonat e xhepit se në faqen lindore të malit të Mollës mbi Duksën e Vogël kishte filluar një zjarr në pyjet e dushqeve. Ishte e enjte, njëzetë e katër gusht të vitit dymijë e shtatëmbëdhjetë. Tymi dhe flaka filluan aty ku kalon rruga këmbësore që fillon në Fushë Muhurr, kalon përfund Kodrës së Balle, pastaj përshkon mes për mes zabelet e Hoxhe, Duksën e Vogël, burimin e ujit në mes dy Duksave e lënë sipër saj, pastaj kalon Rrafshën e Merke, ku lidhet me Qafën e Shëne Premtes. Aty ku historia fsheh ende nën qyrkun e saj të zi, banorët e këtyre dy emrave me domethënie të madhe. Pra, të Dukës si njeri i pasur, me mend dhe me banorët e shumtë përreth, në këto pyje madhështorë, të dendur e trup lartë të dushqeve ndoshta qindra e qindra vjet më parë.

Ndërsa zjarri i filluar në tre vatra përgjatë kësaj udhe po pushtonte me shpejtësi murrani e gjuhëza flakësh tmerrndjellëse, pyjet e dushqeve drejt tre majave të Mollës, të Shqutit e të Rame në kujtesën dhe historinë e këtij fshati të shkruar në libra apo të transmetuara ndër brezni, mbinë si pishtar heroizmi i fshatarëve, e cila përbën një akuzë të rëndë për të kaluarën jo dhe aq të largët dhe të sotmen shkatërrimtare të natyrës me mori të pafund ngjarjesh, përleshjesh, dyluftimesh për të mbrojtur pasuritë e gjelbërta të këtyre pyjeve.

Rreth viteve 1800, pikërisht këtu pranë zjarrit përvëlues, ndodhen mbetjet arkeologjike dhe toponimet si dëshmitare të pakundërshtueshme ku jetonin me shtëpia përdhese fiset Mikli e Rama në Kudhane, Kurti Preçi Balla në Degjane, ndërsa Hoxha e Lala në Kullane. Pikërisht është faqja



lindore e këtij mali, nga ku kufizohen me Prroin e Sul Muliut e deri tek Prroi i Gjonit ishin tokat e tyre bujqësore, vreshtat dhe pyjet ku jetonin në harmoni me pronësit dhe prodhimet e tokës së tyre, ndërmjet fiseve dhe familjeve.

Në këtë periudhë krahina e Muhurrit sundohej nga beu i Karasanit të Brezhdanit, të cilët ishin të lirë të bënin drutë e zjarrit për gatim, ngrohje për dimrat e ashpër, në pyjet e këtyre familjeve e fiseve, pasi banorët të kishin prerë gjeth dushku si ushqim dimërore për blegtorinë. Por vuajtjet e tejzgjatura e me plot dhimbje, trajtimi i keq me gjithçka sa mundte Karasani, shtoi urrejtjen që rritesh si ortek dita-ditës, vit pas viti, duke i shtyrë që ta hiqnin qafe zgjedhën mallkuese e drobitëse. Një ditë prej ditësh iu zunë prit hyzmeqarëve në pronat e tyre ku ato erdhën për të pre dru zjarri, fisi Hoxha dhe Lala. Atëherë kur zgjidhja paqësore dhe marrëveshja me biseda e problemeve nuk dhanë rezultat, krisi pushka me shkëmbim zjarrit në mes dy palëve. Në luftime e sipër trimi Elmaz Lala vrau të 13 hysmeqarët e beut. Lisat në trungje e kurora u lanë me gjak dhe plumbat mbetën disa në drurët dhe degët e pyjeve të dushqeve. U deshën vite e vite të mbylleshin plagët e hakmarrjes.

E ndërsa sot në këto ditë gushti zjarri po zhduk gjithçka me drurët dy deri në tre metra, me shkurre, kafshët e shumta e insektet që ikin të lemerisura ose shkrumbohen bashkë me dushqet e njoma e të thata, me humusin etj. Zjarri, pasi pushtoi majat, kaloi në faqet perëndimore dhe jugore, duke përfshirë faqen mbi Kodrën e Balle, Rrafshën e Madhe dhe të Vogël, shpatet mbi Manin e Mustafës dhe Lisin e Aliut, vazhdoi mbi Arën e re, duke kaluar atë të Menës. Në këto anë u ndalua vazhdimi i djegjes nga një aeroplan i mbrojtjes civile, që e fiku me ujin e marrë nga Drini, që pikërisht këtë pasdite kishte shtuar fatmirësisht shumë. Njerëzit vetëm mallkonin, punonin në arat, kopshtet e tyre ose pinin kafe në klubet që nuk janë të pakta. Çuditërisht, fatkeqësisht, askush nuk mori kazmën, lopatën apo sopatën për të hapur kanale apo hapur korridore që të ndalohej vazhdimi i këtij shkatërrimi barbar të kurorës së gjelbërt të lagjes Hoxhe, Prençe, Kurte dhe Mëzeze dhe gjithë fshatit Fushe Muhurr.

Por gjatë natës zjarri u riaktivizua, ndoshta nga djegja nëntokësore e humusit dhe legushës, ose zjarrvënësi kriminel dhe armik i betuar i pyllit dhe i fshatarëve ia vuri zjarrin përsëri. Kështu që ai vazhdoi me plot energji, forcë e vrullpushtues, shkatërrues, zhdukës, shëmtues i peizazheve, duke u përhapur ditën e dytë edhe në qindra e qindra hektarë të tjerë pyjesh, si shpateve të stërmëdha të përroit të Derrit, kurrizit të Kuajve, gjithmonë zjarri vazhdonte triumfator mbi rrugën e re automobilistike, ndërtuar aty rreth mesit të viteve shtatëdhjetë të shekullit që kaloi. E kapërceu përroin e Gurit të Kuq, shpatet e arës së Seferit, ose Gjetanet mbi Gurin e Zi dhe kaloi te kufiri tokësor e pyjor me fisin Cane. Kështu që gjuhët e flakëve kaluan mbi ish Minierën e Mermerit buzë rrafshës së Merke, ku u ndërprenë aty, sepse pyjet e dikurshme janë shkulur deri me cungje për të hapur toka buke në vitet '80 të shekullit që perëndoi, pra, shkretëtira e ndaloi marshimin përbindësh, zjarrshkatërrues.

E gjithë kjo hapësirë pyjesh prej afërsisht treqind e pesëdhjetë hektarësh, e bërë kurban e shkretuar ditën e dytë që përbëhej nga masive dushkajash cungishte mbi tridhjetëvjeçare, me lartësi mbi dy metra e gjysmë, me relieve të buta, por me shumë kodra, lugina, shpate, dikur peizazhe mahnitëse që të ndillnin veçse kënaqësi,



sot krejtësisht të kthyera në hi të zi dhe panorama rrënqethëse. Më shume se një shekull nuk mbahet mend apo të jetë shkruar mbi ndonjë zjarr në këto pyje, qoftë pyje private apo shtetërore.

Këto pyje janë të fiseve Mëziu e Krrashi, të përcaktuar qartësisht me kufij prej gurësh të zgjedhur. Këto të ndara sikur të ishin inxhinierë ose teknikë mbarështues të vendosura në kurrize, maje kodërzash, përrenj e prroskash, pra, të dallueshme, të dukshme, të pazhdukshme, sepse janë kufij natyrorë. E megjithatë, secili prej këtyre ndarjeve është i shoqëruar me kufij prej një guri të madh në formë shpatulle i ngulur thellë, me drejtimin e pjesës së mprehtë nga vazhdon kufiri dhe dy gurë anash që i mbështeten në dy anët gurit kufi. Sigurisht këto nuk janë djegur, ato e kryen në shekuj dhe do ta kryejnë funksionin e tyre ndarës të pronave mbi sipërfaqet pyjore. Por ato nuk e mbrojtën atë nga zjarrvënësi zullumqar e gjakhumbur. Sepse shteti komunist dhe aspak, ai njëzetë e shtatë vjeçar i vetëquajtur demokratik, nuk e njeh me ligje pronën private mbi pyjet. E prandaj masive të tëra u shkrumbëzuan e nuk u shfrytëzuan për të mirën e pronarëve, pra, popullsisë fshatare përqark.

Por si kanë mbetur të ngulitur në mendjen e fshatarëve dhe të kohërave këto kufij? Janë linja, virtuale, idesh, përfytyrimesh, hamendjesh apo reale, të prekshme, të materializuara mbi sipërfaqe apo objekte prodhuese?

Për këto kufij, shenjtërinë e tyre, ndarjen me drejtësi urtërore nga vetë këshilli pleqnor ose ligjet kanunore të fshatarëve të varfër ekonomikisht, por të gjerë e të pasur shpirtërisht, tregohen histori e ngjarje nga më të dhimbshmet, gjurmëlënëse, tejet të zgjuara, por mbi të gjitha mësimdhënëse për sot dhe për nesër. Sipërfaqet me pronësi private pyjesh, secila prej tyre janë shitur për kafshatën e gojës, për t'i shpëtuar vdekjes nga uria familjarisht, për të ndërtuar shtëpi ose martuar etj. Ndërsa janë blerë me djersën, vuajtjet e pashkruara e treguara me gjakun e kurbetlinjve në Turqi, Egjipt, Siri, etj. Por janë larë edhe me gjakun e luftërave ndërmjet ngatërrestarëve, grabitqarëve të druve për shtylla, lëndë shtëpish apo sherreve të kufijve që i lëviznin natën ose kohën kur ndonjë burrë i familjes emigronte për dhjetëvjeçar e nuk dukej këtyre anëve. Prandaj ato janë të shenjtë dhe do të mbeten të tillë për jetë të jetëve. Por mjerisht pseudodemokratët e qeveritarët nuk e njohin psikologjinë e fshatarit, nuk njohin aspak lidhjen jetësore të tyre me tokën bujqësore, pyjore, livadhore që ka qenë e mbetet, burim ushqimi jetese për ato.

Por këto ligje, ngjarje, shkëmbimi prone private me para, kufijtë tokësorë të pronave mbi pyjet nuk janë vetëm në Dibrën e Poshtme, jo kurrën e kurrës, ato njihen në pronësinë e pyjeve me gështenja të Reçit, të Shkodrës, të pyjeve me dushqeve të Skurajve - Shkopet të Lezhës e Matit, në masivet e ndryshme të pyjeve të Zagorisë në Gjirokastër, në Baldushk, Fark e Kashar të Tiranës, në Bogovë të Skraparit, në Xibrake e Poroçan të Librazhdit. Në pishnajat e Voskopojës, Korçë, etj. etj.

E ndërsa pyjet prej dushku shungullonin nga flakët e tmerrshme, të frikshme, inatçore të përbindshme, fshatarët ngritën kokën nga qielli dhe hapën dy duart të shtrira në formë lutëse dhe filluan me kor të bërtisnin me zërat e dhimbsur, por revoltues, kumbues në Grykën e Murrës e Drinit plak: Përse ma dogje pyllin, të vraftë Zoti i madh?

10.09.2017

Silva është shumë praktike në çdo aspekt të jetës dhe normale që po i mëson mjaft mirë traditat dhe gatimet e Dibrës, madje ajo ka mësuar të flasë si dibrane.

Dafi (Defrim) Derti:
Dibra ka **vlera** dhe njerëz **të mrekullueshëm**



Nga **Samet ZAGRADI**

Dafi Derti është një nga këngëtarët më të kërkuar në tregun muzikor shqiptar. Ai ka lindur dhe është rritur në fshatin Blliçe të Dibrës. Emri i tij i vërtetë është Defrim Derti. Suksesin më të madh e pati në hitin absolut me bashkëshorten e tij, këngëtaren e mirënjohur, Silva Gumbardhi. Kënga "Të ka lali shpirt" u bë një super hit, duke thyer rekorde klikimesh. "Kur isha vogël dëgjoja shumë hip-hopin dhe me kalimin e kohës, ky zhanër muzikor m'u kthye në profesion".

Gjatë një interviste për rubrikën tonë "Të rinj - të talentuar", Dafi thotë se "Jam krenar që jam dibran, sepse Dibra ka vlera dhe njerëz të mrekullueshëm".

Dafi, je një nga këngëtarët dibran më të njohur. Mund të na flasësh pak për fëmijërinë tuaj në Dibër?

Unë kam kaluar një fëmijëri të jashtëzakonëshme, sepse jam rritur në fshat dhe dihet që jeta në fshat është shumë aktive. Unë jam nga fshati Blliçe, ku kam kujtime të paharrueshme, që kudo që jam, dua t'i ndaj me çdo njeri. Kudo që jam kujtimet më rrinë para syve. Më kujtohet vera që gjithmonë iknim të laheshim në Dri apo kur mezi prisnim të binte borë dhe dilnim me "cullt e katundit me shqit", e pafund gjëra të tjera që jam i bindur që çdokush që po lexon këtë intervistë i kujtohen.

Dibra ka pasur, ka dhe do të ketë artista që jo vetëm unë, por të gjithë i vlerësomë shumë. P.sh., Stine, që më ka përkrahur në fillimet e mia, dua ta falenderoj shumë.

Pastaj janë emra të paharrueshëm si: Liri Rasha, Vera Laçi, Arif Vladi, Noyzi e shumë të tjerë. Ka shumë të tjerë që u kërkoj ndjesë që nuk më kujtohen emrat. Duhet të ndjehemi të gjithë krenarë për ata artisë që na kanë përfaqësuar denjësisht.



Cilat ishin disa sfida që hase kur ike në Tiranë e derisa u bëre i famshëm?

Sfida? Eh jeta e gjithë është një sfidë, por realisht ne që kemi ardhur nga rrethet kemi pasur shumë vështirësi. Edhe në karrierë kemi hasur vështirësi, por vullneti dhe ambicia ime s'më ka lënë kurrë që unë të ndalem. Sfida nuk kisha vetëm unë si person, por sfidë të madhe hasën edhe prindërit e mi, që lanë gjithçka që kishin ndërtuar në Dibër dhe erdhën në Tiranë dhe ia filluan nga zero, që unë të filloja shkollën dhe të kisha një jetë më të mirë. Vështirësi ka pasur pafund, sidomos në kohën kur sapo mbaroja mësimin ikja në punë, pas punës në studio dmth, netë të tëra pa gjumë, e shumë e shumë gjëra të tjera që më mirë mos i kujtojmë.

Kush është Dafi jashtë profesionit të këngëtarit dhe a përshtatet Silva me traditat dibrane?

Dafi jashtë profesionit është një njeri që bën shumë gjëra. Jam një njeri i thjeshtë në përgjithësi. Momentalisht po vazhdoj studimet e larta për Shkenca Politike dhe një pjesë të madhe të kohës ia dedikoj dhe djalit, i cili na ka ndryshuar jetën. Silva është shumë praktike në çdo aspekt të jetës dhe normale që po i mëson mjaft mirë traditat dhe gatimet e Dibrës, madje ajo ka mësuar të flasë si dibrane (qesh).

Kush janë artistët dibranë që ti i vlerëson me të vërtetë?

Dibra ka pasur, ka dhe do të ketë artista që jo vetëm unë, por të gjithë i vlerësomë shumë. P.sh., Stine, që më ka përkrahur në fillimet e mia, dua ta falenderoj shumë. Pastaj janë emra të paharrueshëm si: Liri Rasha, Vera Laçi, Arif Vladi, Noyzi e shumë të tjerë. Ka shumë të tjerë që u kërkoj ndjesë që nuk më kujtohen emrat. Duhet të ndjehemi të gjithë krenarë për ata artisë që na kanë përfaqësuar denjësisht.

Një nga projektet e tua në bashkëpunim me Silvën u bë hit absolut. Kush ishte ndjesia juaj për këtë?

Kënga jonë që u bë hit ndërkombëtar "Të ka lali shpirt" realisht ne e prisnim për një këngë të suksesshme, por jo në ato përmasa që mori ajo këngë. Normal që u ndjemë shumë mirë, sepse ëndërroja që një këngë ta kishim hit dhe ajo tejkaloi çdo limit të suksesit. Faleminderit Zot!

Ti je shembull për t'u ndjekur nga të gjithë të rinjtë. Cili do të ishte një mesazh që do t'u jepje atyre?

Mesazhi im për rininë dibrane është që të punojnë sa më fort dhe të arrijnë qëllimet e tyre në jetë dhe kudo që të shkojnë duhet ta bëjnë krenar Dibrën dhe veten e tyre. Kurrë mos e harroni Dibrën, çfarëdo që të bëni dhe kudo që të shkoni.

Mesazhi im për rininë dibrane është që të punojnë sa më fort dhe të arrijnë qëllimet e tyre në jetë dhe kudo që të shkojnë duhet ta bëjnë krenar Dibrën dhe veten e tyre. Kurrë mos e harroni Dibrën, çfarëdo që të bëni dhe kudo që të shkoni.

Cilat do jenë disa projekte në të ardhmen që mund t'i ndash me ne?

Siç e përmenda dhe më sipër, tani po studioj për Shkenca Politike dhe përkushtimi ndaj familjes dhe djalit më detyruan që të bëja një pauze në muzikë. Por tani kam filluar që të punoj më shumë në studio për të publikuar albumin tim të parë. Kënga që sapo kemi lançuar ka ecur mirë.

Çfarë do të bëje për Dibrën, në qoftë se do të ishe kryetar bashkie?

Eh, po të isha unë kryetar bashkie, sa ndryshime do të bëja në Peshkopi nuk ka fund, ama do e nisja me fiksimin tim, tek gropat tek karburanti, që i kam pasur gjithmonë inat (qesh), që i mbaj mend që 11 vjet që kam ikur nga atje. Normal spitalin do e kisha pikën kryesore, plus në shkolla do të investoja shumë, sepse baza e një shoqërie është arsimi. Do shtroja çdo rrugicë të qytetit dhe në çdo qoshe do ta bëja më ndriçim. Mos vazhdoj më shumë, sepse kam aq shumë gjëra për të ndryshuar, saqë nuk do të mbaroja kurrë.

cyan magenta yellow black

BOTIME M&B

www.facebook.com/ M&B - Botime dhe Studio Grafike
Për porosi: botimemb@gmail.com/Cel: 069 20 68 603
www.mbbotime.com / I gjeni te libraria M&B *(te Selvia)*, Adrion *(te Pallati i Kulturës)*, Libraria Fleta XXI *(Peshkopi)*



KANUNI I DIBRËS

Trashëgimi etnojuridike

XHAFER MARTINI

Kanuni i Dibrës vjen si dëshmia më e madhe dhe më e plotë e tipologjisë së civilizimeve lokale shqiptare. I njëkohshëm dhe i barabartë për nga rëndësia me "Kanunin e Lekë Dukagjinit" dhe me "Kanunin e Skënderbeut" (me variantet dhe invariantet e tij), – "Kanuni i Dibrës" ka të përbashkëta dhe dallime nga dy të parët. Më hollësisht këto dallime do t'i gjeni në "Hyrjen" e mbledhësit të këtij Kanuni, shkrimtarit dhe kulturologut të mrekullueshëm, Xhafer Martini. Këtu vlen të përmend vetëm një veçori dalluese të Kanunit të Dibrës – papraninë (mospërfshirjen) e institucioneve religjoze (kishës e xhamisë) duke mos privilegjuar e favorizuar në sanksionet kanunore as klerin. Nga ana tjetër, përpos barazisë së rreptë të rregullit, të cilit duhet t'i nënshtrohet gjithkush njëlloj, pa dallim, – Kanuni i Dibrës spikat për një elasticitet më human e vetëpërmbajtje më të thellë në shumë çështje "të nxehta" si "gjakmarrja", "hakmarrja", "gjaku", "xhipi"etj.
Një tjetër "avantazh" i këtij Kanuni është sasia e bollshme e fakteve, detajeve dhe e rrëfimeve të vërteta që ballafaqohen e pranëvihen gjegjësisht me tabutë e sanksionuara dhe përkufizimet e së drejtës, duke i dhënë Kanunit dimension të gjallë sintetik.
"Kanuni i Maleve të dibrës" është dëshmia monumentale e asaj "atlantide" civilizimi të kredhur në memorien dhe etnopsikikën e dibranit.



PËLLUMBAT E RRUGËS

RAMIZ GJINI

Romani më i fundit "Pëllumbat e rrugës", vjen si përmbyllje trilogjisë groteske mbi një vend imagjinar sa edhe real, Bibollin, një provincë në Shqipërinë postkomuniste, po aq edhe kryeqytet i paradokseve, paranojës dhe megallomanisë, të përfaqësuara nga romanet "Rrëketë" (2007) dhe "Bibollasit" (2009). Pjesa e tretë e trilogjisë "Pëllumbat e rrugës", është në të njëjtin stil grotesk, të njëjtët personazhe, të njëjtin topos, por në shkallë më të avancuar të sëmundjeve të postkomunizmit.
Romani ka disa pika të forta të tij, siç kemi bindjen, dhe pikë e fortë para së gjithash është uniteti, kompaktësia e linjës së rrëfimit ironik mbi Tushin dhe Lushen në sfondin e panairit grotesk të Bibollit gjithë personazhë simulakër, që përfaqësojnë instancat shoqërore e shpirtërore të kësaj topike të njohur tashmë edhe në dy romanet e mëparshme të autorit.
Në letërsinë tonë të sotme, bashkëkohore, nuk kemi ndeshur ende me nje projekt të përmbyllur suksesshëm të një trilogjie të romanit grotesk, siç janë tre romanet e Ramiz Gjinit.



TOPONIMIA E ÇIDHNËS

HAKI PËRNEZHA, RRUZHDI BITRI

Në librin e këtyre dy autorëve janë ndërthurur meritat e mbledhësit, tejshkruesit dhe të studiuesit. Aty janë bashkë edhe filologu, edhe dialektologu, edhe antropologu e historiani. Libri i tyre është një arritje etnogjuhësore, në të cilën fjala dhe bartësi i saj nuk ndahen...
Pa dyshim, në duart e studiuesve albanologë më të njohur: E. Çabej, A. Buda, K. Frashëri, po dhe të një brezi pasuesish të tyre, ky libër do të merrte dhe do të marrë vlerë tjetër një surplus të padiskutueshëm...
Libri përmban edhe një fjalës të fjalës së rrallë ose në zhdukje të shqipes nëndialektore të këtyre anëve. Të shpëtosh një fjalë nga vdekja është një shërbim i paçmueshëm për një gjuhë.



THEMRA E AKCILIT

AGRON TUFA

Prozat e shkurtra të këtij libri kanë një dallim thelbësor nga krijimtaria ime artistike në poezi, prozë të gjatë apo ese. Diku më shumë, diku më pak, në këto proza të shkurtra ndërthuren elemente dhe të poezisë, dhe të prozës romanore, dhe të esesë. Kështu, përgjatë viteve kur u shkruan prozat e shkurtra të këtij vëllimi interesi im ka qenë kërkimi i një forme sa më të përshtatshme, duke patur si impuls parësor jo më imagjinatën e pastër letrare, sikundër ndodh në poezitë, romanet, tregimet apo novelat, por me të ashtuquajturën "lëndë e gjallë", e përftuar nga kontakti i drejtpërdrejtë me realitetin. Pra, ndryshe nga procedimet e kulluara letrare, në këto proza jam rrekur të paraqes atë realitet që kam parë dhe që e njoh mirë dhe vetëm në bazë të këtij materiali të vërtetë, të mund të krijoj një kornizë letrare të përshtatshme. Nëse në krijimtarinë e kulluar letrare përparësi ka qenë imagjinata dhe fiction-i, në këto proza të shkurtra përcaktues është fraktura e realitetit konkret, të marrë drejtpërdrejt apo tërthorazi, në dorë të parë.
Nxitje për këtë ka qenë një frazë e ndeshur në një tregim të Vladimir Nabokovit: "Jeta është shumë herë më e papritur dhe më e talentuar se ne".



SABRI CAKA, KRAHU I SHQIPES NË FLAMUR

HALIL TEODORI

Zona jonë ka nxjerrë heronj dhe figura të shquara, personalitete të rëndësishme të kulturës dhe dijes, guximit dhe vendosmërisë, traditës dhe atdhetarisë.
Kjo kolanë e gjatë dishepujsh të vlerave dhe krenarisë ka shërbyer vendit, por ata kanë ngelur pa u bërë të njohur, përfaqësuar dhe vlerësuar. Është detyrim i gjeneratave që në emër të mirënjohjes, në emrin e thirrjes së gjakut, në emër të më të shtrenjtës që na ndjek nga pas kudo që të shkojmë, në emër të plisit, t'i njohim, t'i promovojmë dhe ta çmojmë kontributin e tyre.
Është kjo përpjekje, është ky angazhim, është kjo detyrësi, ajo që na nxit të jemi ne ata që do të shkruajmë ato faqe të historisë që trualli na i ka besuar ne, sepse vetëm ne mund ta matim dhimbjen e kësaj toke, ta dëgjojmë kushtrimin e këtyre maleve, t'u bindemi këshillave të etërve flokëbardhë, ta lehtësojmë dhimbjen e kësaj plage".



NGA HIRI I TË VDEKURVE

AGRON TUFA

"Nga hiri i të vdekurve", një libër me ese kulturologjike.
Në këto ese shkrimtari trajton raportet e tij me fëmijërinë, vendlindjen, kulturën, traditën, ideologjinë, gjuhën, historinë dhe artin e të shkruarit.
Përmes stilit të tij ekspresiv, dinamik e sugjestiv, Tufa në këto ese bën një guidë meditative nëpër stacione të trazuara të së shkuarës dhe bashkëkohësisë dhe në sëmundjet e qytetërimit tonë.



TË JETOSH NË PAQE

NAIM BERISHA

Në këtë roman trajtohet tema e qëndresës së popullit të arbërit në kohën e Skënderbeut. Duke glorifikuar familjen e lashtë të Berishëve të Mazrekave në Gardh të Poshtëm, dmth, në Muhurrin e sotëm të Dibrës së Poshtme dhe të dy gjeneralëve të Skënderbeut, vëllezërve Dhimitër dhe Nikollë Berisha, djem të Gjergj Berishë Mazrekës dhe Majra Kastriotit) ai, në të njëjtën kohë, glorifikon gjithë qëndresën heroike të Arbërisë nën udhëheqjen e Skënderbeut kundër tiranisë së pashembullt turke. Ky roman me bazë historike të vërtetë është sa tërheqës dhe intrigues, aq dhe me interes e domethënës. Si i tillë, ai lexohet me një frymë.



DIBRA NË SHEKUJT E SUNDIMIT OSMAN

MUNIR SHEHU

Askush nuk mund të thotë se këto këngë e gojëdhëna u trilluan ashtu, kot së koti nga populli. Ato e kanë një burim, për këtë as që mund të dyshohet.
Në to shihet qartë vringëllima e shpatës, lufta për mbijetesë, për liri.
Burimi është populli, vetë historia e tij. Pra, mund të konsiderohen si dokumente historike për ngjarjet që përshkruhen në to.
Çështja e folklorit me burim shumë të vjetër është si puna e muzikës. Nuk mund ta lexosh melodinë pa parë më parë çelsin e muzikës në krye të pentagramit.
Ashtu si për muzikën, që, këtë çelës nuk mund ta gjesh gjëkundi, vetëm në muzikë, po ashtu edhe për folklorin, këtë çelës nuk mund ta gjesh gjëkundi, vetëm në folklor, d.m.th., në popull.



UDHË NË PASQYRË

AHMET PRENÇI

Besnik Mustafaj: Unë e kisha njohur prej shumë vitesh si lexues të pasionuar Ahmetin, gjë që, siç e shihja, kishte ndikimin e vet mbi qasjen e tij ndaj njeriut, natyrës, politikës, historisë. Tashmë nuk do të ketë vend të shprehim habinë, qoftë kjo edhe një habi e bukur, sepse ai na është shfaqur edhe si një prokuror ndryshe, hetues ndryshe dhe kryepolic ndryshe ... Ahmet Pençin e ka "zbutur" dhe vazhdon ta "zbusë" e ta përsosë poezia që ka brenda vetes.
Agron Tufa: Vargje të çlirëta, me muzikalitet spontan, që rrjedhin natyrshëm, me shpengimin karakteristik të frymëzimit origjinal, ato kanë ajrin e lirë të bjeshkëve dhe peizazheve të vendlindjes. Metaforat e freskëta që i hapin udhë përfytyrimit dhe ndjenjës..



PO TË MOS ISHTE DRINI…

NAIM PLAKU

Në përmbledhjen rrëfimore "Po të mos ishte Drini…", Naim Plaku shkëlqen si prozator. Me një gjuhë mjaft elegante dhe të përpunuar, me një stilistikë të qëruar e plot kolorit të idiomave dhe frazeologjisë popullore dibrane, na paraqet një botë të trazuar kujtesash dhe emocionesh, që kanë në bazë të tyre rrëfimet mitologjike, parahistorike dhe historike dibrane.
Etiketuar si "urtësi dibrane", ky libër është një mozaik narrativ, me themele në të folmen popullore dibrane, në kujtesën kolektive dibrane, ku autori merr ngjarjet, të ndodhurat dhe i rikrijon e i përpunon me një gjuhë të latuar e të përpunuar hijshëm. Duke përdorur një gjuhë të vrullshme, me një sens të fortë përshkrues dhe rrëfimtar, plot ngjyrime dhe stolisje me fjalë e idioma lokale, autori na çon në rrugëtime mitologjike dhe parahistorike si në rrëfimin e gjatë e të mrekullueshëm "Po të mos ishte Drini, ku do të mbytej Seta", ku tregohet historia e dy ujërave të Dibrës, në një marrëdhënie të shpirtëzuar njerëzore, me fuqi sugjestive metafizike dhe transhendente.

Rruga e Arbërit nr. 137

nisma

Grupi iniciator i Maturës 1992 i fton të gjithë bashkëmoshatët e tyre, ish nxënësit e tjerë të gjimnazit të Peshkopisë, dashamirës dhe përfaqësues biznesi, që të mbështesin me kontributin e tyre këtë fond, që lartëson vlerat dhe talententet dibrane në shkollën ku u maturuam dhe do të maturohen brezat e ardhshëm.

Skicë

Të dashur të rinj!

Nga **Samet ZAGRADI**

Duhet të kuptojmë që kafenetë nuk mund të jenë justifikim së po bëjmë diçka. Nuk duhet të pajtohemi me realitetin së këtu nuk jetohet apo se vetëm "toka e premtuar" mund të na nxjerrë nga situata. Tymosja nuk sjell zgjidhje, madje as alkooli apo lëndët e ndaluara nuk do të na shpëtojnë. Modelet që ne ndjekim nuk duhet të ndiqen. Mjaft mallkuam pedagogët. Ne nuk mësojmë, nuk punojmë, nuk përpiqemi. Ne përtojmë e më pas ushqejmë vrullshëm korrupsionin, pastaj ankohemi. Bëhemi gënjeshtarë, shfrytëzues dhë lypës të fatit të një provimi të cilin e blejmë njësoj si qimet e kokës. Askush nuk mundet të të mohojë atë që ti meriton. Askush nuk ka shans të përfitojë mbi djersën tonë, në qoftë se ajo djersë është derdhur me punë dhe përkushtim.

Të dashur të rinj.

E di, ne pëlqejmë të jetojmë mirë. Pëlqejmë lukset, makinat, festat, teknologjinë e fundit, por harrojmë detaje që në të vërtetë s'duhet të harrohen. Të mendojmë më gjatë! Ti, që vetëm telefoni të kushton sa dy rroga të prindërve të tu, apo ti që çdo mëngjes zemërohesh se nuk t'u plotësua teka, a ke menduar ndonjëherë duart e çara të babait tënd teksa rropatet në kantiere ndërtimi? Apo ti e dashur e re! Mendon ndonjëherë për nënën që punon dy turnë që ti të mbarosh universitetin, të bëhesh dikush në jetë dhë të mos kesh dhe ti fatin e saj? E, ti ndërkohë, çfarë bën? Lë orët e mësimit për kafe, netët e studimeve për party apo ato pak para të qerasë duhet ti marrë pedagogu? Të duket vendim i drejtë ky?

Jo! Jemi gabim kështu të dashur të rinj! E ardhmja jonë varet vetëm nga ne. Duhet të besojmë fort në ëndrrat dhe në vlerat tona. Ne kemi shumë dhe për këtë duhet të jemi të bindur. Duhet të lëvizimi, të punojmë pa pushim pa llogaritur kurrë lodhjen. Atë nuk duhet ta njohim. Suksesi që vjen pa vuajte nuk është sukses, është vetëm një fasadë e lyer më burokraci që koha shumë shpejt do ta zbehë. Koha është mjaftë e vyer. Ajo ikën shpejt duke të hequr shancin të reagosh pas pendimit.

Ne nxitojmë të rritemi, nxitojmë të pasurohemi dhe harrojmë të shijojmë pjesën më të bukur të jetës, fëmijërinë! Kur rritemi kuptojmë që kemi humbur shumë. Duhet të kuptojmë që arma nuk të bën të fortë dhe droga nuk të bën të të pasur. As prostitucioni, të dashura goca, nuk mund të jetë biznes. Është kaq e trishtë, e ulët...

Të dashur të rinj,

Duhet të kuptojmë që nuk është turp të dashurojmë, të dashurohemi. Turp është të flakësh tutje ndjenjën, respektin për arsye instikti apo interesi. Duhet të përpiqemi fort të jemi pjesë e një shoqërie të shëndoshë, e një familje me baza të gjalla morale dhe të bëjmë të pamundurën që të jetojmë me nder.

Të punosh nuk është turp. As të jesh i varfër nuk është ulje. Turpi qëndron në mendjen tonë. Në mënyrën se si ne i perceprojmë gjërat dhe në mënyrën se si ne ëndërtojmë jetën tonë. Është shumë e rëndësishme mënyra se si ne e ndërtojmë jetën tonë dhe sesi ne ecim përpara...



NISMA E MATURANTËVE TË VITIT 1992 TË GJIMNAZIT TË PESHKOPISË

Hapet **fondi "AGIM SHUBLEKA"** për nxënësit e shquar të gjimnazit të Peshkopisë

Nga **Besnik ALKU**

Një grup ish-maturantësh të gjimnazit të Peshkopisë në vitin 1992, pas 25 viteve u mblodhën dhe e festuan këtë ngjarje nostalgjike në Peshkopi. Me vite eksperiencë në profesione të ndryshme, të shpërndarë anembanë botës, malli dhe nostalgjia për Peshkopinë dhe gjimnazin i bëri që këto ish-maturantë jo vetëm të mblidhen, por të mendojnë edhe ndryshe për shkollën e tyre.

Gjimnazi i Peshkopisë për këtë brez dhe gjithë brezat e tjerë, përveç një institucion arsimor, mbart në vetvete një vend të veçantë në memorien e të gjithë brezave dhe emocionin e nxënësve që kanë studiuar në këtë shkollë. Ai nuk është thjesht institucion arsimor, por një mjedis i shëndetshëm që ka sjellë dhe sjell një ndryshimin pozitiv të jetës së vetë komunitetit të Dibrës, si një institucion me vlera të larta edukative dhe prestigji për dibranët.

Për të memorizuar dhe lartësuar vlerat e pashterushme arsimore të gjimnazit Peshkopi, grupi i ish-nxënësësve të maturës 1992 morën inisiativën për të hapur një fond kontributi në institucionin e shkollës për të promovuar nxënësit që kanë veti apo cilësi të spikatura, që i japin shkollës imazh krenarie dhe prestigji.

Iniciatorët kanë menduar të kontribojnë financiarisht për hapjen e këtij fondi, dhe për të memorizuar këtë fond t'i japin emrin e mësuesit të matematikës të gjimnazit të Peshkopisë z.Agim Shubleka, i cili ka kontribuar për rreth 30 vjet si mësues matematike dhe drejtues në këtë shkollë dhe është dalluar për vlera dhe norma të larta mësimdhënie, edukative dhe formimi të karakterit dhe personalitetit kërkues, inteligjent, konkurrues dhe rezultativ të nxënësve, duke zënë një vend të veçantë në memorien e tyre për nga njohuritë e dhëna dhe mësimet për jetën.

Këto çmime do të jenë për nxënësit që shkëlqejnë me talentin e tyre në sport apo fusha të tjera; për nxënësit që kanë rezultate të mira në ciklin akademik shkollor dhe për nxënësit që spikasin me karakterin e tyre human, miqësorë, altruist, bëjnë përpjekje specifike në çështje apo tema të ndryshme, apo kontribojnë në zhvillimin e mjedisit dhe komunitetit.

Fondi do të ketë si qëllim që të vlerësojë me çmim nderi nxënësit më cilësorë, që tregojnë me rezulatet e tyre vlerat më të mira dhe rrisin krenarinë e shkollës, duke e bërë atë të spikatur dhe konkurruese me shkollat e tjera.

Këto çmime do të jenë për nxënësit që shkëlqejnë me talentin e tyre në sport apo fusha të tjera; për nxënësit që kanë rezultate të mira në ciklin akademik shkollor dhe për nxënësit që spikasin me karakterin e tyre human, miqësorë, altruist, bëjnë përpjekje specifike në çështje apo tema të ndryshme, apo kontribojnë në zhvillimin e mjedisit dhe komunitetit.

Modeli i kësaj nisme është shumë e njohur në shkollat amerikane dhe europiane, që komuniteti dhe dashamirësit e shkollës kontribojnë me donacione financiare, dhe që mbajnë emrin e njerëzve të spikatur që kanë kontribuar me punë ose mësime në këtë shkollë. Pikërisht këtë model kanë zgjedhur iniciatorët e Maturës 1992 dhe që e pagëzuan me emrin e mësuesit të tyre të shquar Agim Shubleka.

Një përfaqësi nga Matura 1992 në bashkëpunim me drejtuesit e shkollës së mesme "Seit Najdeni" po punojnë për detajet dhe modalitetet e operimit dhe menaxhimit të fondit, i cili së shpejti do të ketë llogarinë e tij, strukturat menaxheriale dhe kriteret vlerësuese dhe bashkë me strukturat e vlerësimit dhe operimit të tij.

Grupi iniciator i Maturës 1992 i fton të gjithë bashkëmoshatët e tyre, ish nxënësit e tjerë të gjimnazit të Peshkopisë, dashamirës dhe përfaqësues biznesi, që të mbështesin me kontributin e tyre këtë fond, që lartëson vlerat dhe talententet dibrane në shkollën ku u maturuam dhe do të maturohen brezat e ardhshëm.

Së shpejti do të keni të publikuara të gjitha detajet rreth fondit "Agim Shubleka", në median lokale në Dibër dhe median sociale online.

Prof.Dr.Hasan Çipuri la pas emër dhe punë të arrira, që do të vlerësohen në shekuj nga brezat e rinj të Forcave të Armatosura.

HASAN ÇIPURI, profesori i terminologjisë ushtarake

Prof. Asoc. Dr. **Bernard ZOTAJ**

Fotografia që më ngeli pa dhuruar...

Në bibliotekën e Akademisë të Forcave të Armatosura gjendet një koleksion mjaft i pasur i serisë së literaturës së shkruar në vite. Duke punuar për një studim historik për historinë ushtarake, midis të tjerave gjeta në gazetën "Luftëtari" një foto ku shkruhej: "Skënderbegasi Hasan Çipuri, ka dalë vazhdimisht shkëlqyeshëm në të gjitha mësimet, është lavdëruar dhe shpërblyer shumë herë me radhë dhe fotografia e tij është vendosur në tabelën e nderit. Për suksese në punë dhe për ndihmë që ju është dhënë shokëve, mori pjesë në Konferencën e III të të dalluarve të Ushtrisë dhe u dekorua me shenjën "ushtar i dalluar".

Këtë foto e shkëputa nga gazeta, dhe e takoj profesorin, ku i them se gjeta një foto të tij, si dhe të prof. Shahin Leka, të cilit ia dhurova se m'u krijua mundësia, ndërsa prof. Hasanit nuk arrita t'ia dhuroja... këtë foto tashmë po e bëj publike pas më shumë se 65 vitesh.



Skënderbegasi Hasan Çipuri, ka dalë vazhdimisht shkëlqyeshëm në të gjitha mësimet, është lavdëruar dhe shpërblyer shumë herë me radhë dhe fotografija e tij është vendosur në tabelën e nderit. Për suksese në punë dhe për ndihmën që u ka dhënë shokëve mori pjesë në Konferencën e III-të të dalluarve të Ushtrisë dhe u dekorua me shenjën «ushtar shembullor».

Prof.Dr. Hasan Çipuri në Forcat e Armatosura ka lënë një pasuri të madhe, hulumtuese e botuese, me shumë vlera për historinë e tonë, dhe ushtarake në veçanti. Ai do të ngelet gjithmonë një vlerë e shtuar për Forcat e Armatosura që i deshi fort dhe dha shumë për to, ai ishte krenaria e tyre, krenaria e historisë ushtarake shqiptare.

RRUGA DREJT DIJES USHTARAKE

Hasan Çipuri ka u lindur në vitin 1935 në Tomin të Dibrës, në një familje atdhetarësh të njohur, në luftërat për liri dhe pavarësi. Aty kreu shkollën 7-vjeçare "Demir Gashi" (1946-1950), skënderbegas që 13 vjeç 1950-1952, duke ndjekur studimet e mesme në shkollën ushtarake "Skënderbej", të cilën e përfundoi me rezultate të shkëlqyera në vitin 1952.

Ndërsa në vitet 1952-1954 përfundoi studimet në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve në Tiranë, më tej përfundon në vitet 1963-1967 Fakultetin Histori-Filologji, në degën Gjuhë-letërsi. Studimet pasuniversitare në UT i kreu në periudhën 1985-1986.

Në vitin 1987 mbrojti me sukses njëherësh gradat shkencore "Kandidat i Shkencave" dhe "Doktor i Shkencave", ndërsa në vitin 1995 mori titullin akademik "Profesor".

Shërbeu në Forcat e Armatosura, mësoi serbokroatishten dhe u bë specialist i kësaj gjuhe. Punoi me ngulm për të zotëruar mirë edhe gjuhë të tjera të huaja, si rusishten, anglishten, italishten, frëngjishten. Me vullnet të paepur për të ecur më tej në rrugën e dijes, ndoqi studimet e larta dhe u diplomua në degën e gjuhës dhe letërsisë shqipe në Universitetin e Tiranës (1967). Këtu kreu edhe studimet pasuniversitare dhe mbrojti me sukses doktoratën e shkallës së dytë (1987). Monografia e tij "Terminologjia ushtarake e gjuhës shqipe" (1993) mbetet punimi themelor në fushën e terminologjisë ushtarake.

Hasan Çipuri ka qenë për disa vjet me radhë pedagog titullar i serbishtes dhe kroatishtes në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja dhe ka botuar fjalorë serbisht-shqip, kroatisht-shqip e anasjelltas dhe metodën e mësimit të serbishtes dhe tekste të tjera mësimore.

NË FUSHËN E TERMINOLOGJISË USHTARAKE

Puna e gjerë dhe cilësore e Hasan Çipurit në fushën e terminologjisë ushtarake, të leksikografisë, të enciklopedisë, të historisë ushtarake është themelvënëse dhe e pakrahasueshme. Ai do të mbetet një shembull i madh në historinë e shkencës shqiptare. Ai mbante gradën madhore ushtarake në Forcat e Armatosura të kolonelit.

Ndër veprat kryesore të tij janë: "Terminologjia Ushtarake e Gjuhës Shqipe",





"Fjalori Ushtarak serbokroatisht-shqip", "Fjalori ushtarak italisht-shqip", 15 Fjalorë terminologjikë disa-gjuhësh të llojeve të forcave, armëve e shërbimeve (Tiranë 1985-1992), "Fjalori i termave ushtarake të NATO-s" (tri-gjuhësh), "Fjalori i shkurtesave dhe akronimeve të NATO-s", "Fjalori i termave të përgjithshme ushtarake" shqip-anglisht dhe anglisht -shqip, fjalori 5 gjuhësh për fëmijë (me figura), "Fjalori serbisht-shqip" me 40.000 fjalë, Fjalor shqip-serbisht me 45.000 fjalë dhe 25.200 shprehje frazeologjike, fjalori shpjegues i termave të biografisë ushtarake (bashkautor), Fjalor 3-gjuhësh dhe shpjeguesi termave të ndërlidhjes (bashkautor dhe kryeredaktor, Tiranë, 2008, libri historik "Çlirimtarët shqiptarë nga Dibra në Zagreb" (bashkautorë, red. përgjegjës), 6 punime kriptografike, 76 buletine e manuale ushtarake, 6 tekste mësimore, 100 zëra enciklopedik për Fjalorin Enciklopedik Ushtarak, 60 zëra enciklopedik për Fjalorin Enciklopedik Shqiptar, botim II dhe 12 libra me karakter historik e ushtarak të përkthyer nga kroatishtja e serbishtja për interesat e mbrojtjes.

Gjatë viteve të hartimit të "Fjalorit enciklopedik shqiptar" në tri vëllime (2008-2009), me përkushtimin e tij në punë, me përvojën dhe dijet e tij në fushën e historisë ushtarake prof. Hasan Çipuri dha një ndihmesë themelore që historia ushtarake e popullit dhe e vendit tonë të zërë vendin e duhur e të merituar në atë fjalor.

Ka kryer edhe kurse e specializime jashtë shtetit, si seminar në Komandën e NATO në Bruksel (prill 2000), kurs për terminologjinë e Agjencinë e Standardizimit, terminologjinë Ushtarake të NATO-s, në Bruksel (qershor 2000), kurs për Terminologjinë Ushtarake të NATO, në krahun Jugor të NATO-s në Napoli, Itali (dhjetor 2003), seminar ndërkombëtar dhe provime pasuniversitare për Kroastikën, në Dubrovnik (Kroaci)-diplomë. Zotëron gjuhën ruse, kroate, serbe, angleze, italiane etj.

ANËTAR I DISA REDAKSIVE DHE SHOQATAVE

Prof. Hasan Çipuri ka qenë anëtar i Këshillit Shkencor të Akademisë së Mbrojtjes (1983-2000), anëtar i Redaksisë së Përgjithshme të Fjalorit Enciklopedik Shqiptar-2 në Akademinë e Shkencave (1997-2010), sekretar shkencor për Fushën e Mbrojtjes, Rendit dhe Historisë Ushtarake në Qendrën e Enciklopedisë Shqiptare në Akademinë e Shkencave (1996-2010), anëtar i Shoqatës së Historianëve Ushtarakë (nga viti 1995), anëtar në Bordin Drejtues të Kërkimeve Shoqërore në Institutin Biografik Amerikan, Drejtor i Përgjithshëm Nderi për Evropën i Qendrës Biografike Ndërkombëtare në Kembrixh, punon si pedagog i jashtëm në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, është emëruar anëtar i Bordit të Këshilltarëve të Institutit Biografik Amerikan (në Karolinën e Veriut). Ka kryer detyrën e dekanit të Fakultetit të Mësuesisë në Universitetin Privat "Mbretëresha Gjeraldinë", në Burrel.

VLERËSUAR ME ÇMIME NË ARENËN NDËRKOMBËTARE

Prof. Dr. Hasan Çipuri ishte Drejtor i Përgjithshëm Nderi për Europën, i Qendrës Biografike Ndërkombëtare në Kembrixh, anëtar i Bordit të Këshilltarëve të Institutit Biografik Amerikan (në Karolinën e Veriut). Nga Universiteti i Kembrixhit është shpallur "Personalitet Ndërkombëtar i vitit 2000" dhe po nga ky institut i është dhënë Titull Nderi "Evropianët e shquar të shekullit XX" (2003) ndërsa Instituti Biografik Amerikan i ka akorduar "Çmimi Universal i realizimeve shkencore" (2001).

Ndërsa nga shteti shqiptar ishte vlerësuar dhe dekoruar me 8 urdhra, medalje pune e shërbimi.

GJITHMONË NË MEMORIEN E FORCAVE TË ARMATOSURA

Prof.Dr. Hasan Çipuri në Forcat e Armatosura ka lënë një pasuri të madhe, hulumtuese e botuese, me shumë vlera për historinë e tonë, dhe ushtarake në veçanti. Ai do të ngelet gjithmonë një vlerë e shtuar për Forcat e Armatosura që i deshi fort dhe dha shumë për to, ai ishte krenaria e tyre, krenaria e historisë ushtarake shqiptare.

Prof.Dr. Hasan Çipuri gjithmonë do të jetë i pranishëm në auditoret e shkollave ushtarake dhe të Akademisë, pasi pas ai ka lënë një pasuri të madhe shkencore, por ka lënë dhe sjelljen e urtë prej një të dituri, mendjen e një shkencëtari të ushtrisë.

Ndaj dhe pjesëtarët e Forcave të Armatosura, ndjehen krenar për veprën e tij, për njohuritë dhe për punën e madhe shkencore që ai realizoi me shumë përkushtim, profesionalizëm dhe korrektësi gjatë gjithë jetës së tij të vyer.

Ndaj këto ditë atij ju dha lamtumira fizike, ndërsa vepra e tij e shkruar do të jetë, se la pas emër dhe punë të arrira që do të vlerësohen në shekuj nga brezat e rinj të Forcave të Armatosura.

Rruga e Arbërit nr. 137

dokumente

KRISTO FRASHËRI: Gollobordasit, *me vullnetin e tyre kanë të drejtën të vetdeklarojnë kombësinë, por* **toka e Gollobordës është tokë shqiptare**

Ditët e fundit, një ligj për minoritetet po diskutohet në komisionet parlamentare. Nisur nga ky fakt, disa shoqata me qendër në fshatrat e Krahinës së Gollobordës, kanë marrë nisma për shpalljen e kësaj krahine si minoritet maqedonas. Ky fakt do ngjallë shumë reagime në komunitetin vendas dhe shoqërinë shqiptare. Ndaj, edhe për informacion te lexuesit, ne po përcjellim një prononcim të prof. Kristo Frashërit 9 vite më parë, më 28 maj 2008, gjatë një ceremonia të marrjes së titullit "Qytetar nderi" i komunës së Arrasit.

"Kohët e fundit po diskutohet në Kuvendin e Shqipërisë Ligji për minoritetet në Shqipëri. Kjo është gjë e mirë. Edhe pjesëmarrja e grupeve të interesit apo minoriteteve në këtë diskutim është normale. Por jo normale dhe e rrezikëshme për shoqërinë shqiptare është tendenca e disa grupeve ekstremiste në Gollobordën e Dibrës që përpiqen ta quajnë Gollobordën e Dibrës si minoritet, në një kohë që nuk është i tillë.

Përgjigjen e këtij pretendimi e ka dhënë historian Hilmi Sadikaj me librin e tij "Gollobordasit e Dibrës" botuar pas viteve 90, ku argumenton edhe arsyet e dygjuhësisë në këtë krahinë.

Përgjigjen e kësaj pyetjeje e ka dhënë edhe historiani Kristo Frashëri që në vitin 2008, përgjigje që do ta ribotojmë edhe në numrin e sotëm.

Përgjigjen e ka dhënë populli trim i Gollobordës me luftërat e tij kundër pushtuesve serbë dhe bullgarë.

Gjatë ceremonisë së akordimit të titullit "Qytetar Nderi" nga Komuna e Arrasit e Dibrës, në Muzeun Historik Kombëtar me datën 26 maj 2008, historiani prof. Kristo Frashëri ju përgjigj edhe një pyetjeje të bërë për Gollobordën.

Pyetja ishte: Gollobordasit janë minoritet maqedonas, minoritet bullgar apo janë shqiptarë?

"Historia shkruhet dhe argumentohet me dokumenta", - theksoi Frashëri. Sipas tij,në Gollobordë banojnë tre grupe njerëzish:

Në Gollobordën Përëndimore ka fshatra shqipfolës, identiteti i tyre as që vihet në dyshim që janë shqiptarë.

Në Gollobordën Lindore ka fshatra dy gjuhë folës, shqip dhe bullgarisht.

Rajoni i Vjetër i Maqedonisë ka qenë përbërë nga helenët, ilirët dhe thrakët. Pra nëqoftëse bëjmë fjalë për maqedonas etnikë, janë ilirët.

Republika Jugosllave e Maqedonisë u krijua pas vitit 1945. Pra varianti i gjuhës maqedonase dhe etnisë maqedonase bie poshtë. Fshatrat e Gollobordës lindore flasin dhe shkruajnë shqip dhe vetëm e flasin bullgarishten e vjetër, e cila për hir të së vërtetës është mbushur me fjalë shqipe. Problemi i dygjuhësisë ka ardhur si rezultat i pushtimeve bullgare. Për këtë problem ka botuar studimin e tij edhe historiani dibran nga fshati Trebisht Hilmi Sadiku. Dyndjet bullgare të shek VII dhe vecanërisht pushtimet bullgare të vitit 1916, raprezaljet dhe vrasjet masive shkaktuan terror dhe frikë në tokat shqiptare të Dibrës dhe vecanërisht në ato të Gollobordës për të pranuar edhe tutelën bullgare, pasi në këtë zonë banojnë edhe sllavë ortodoksë.





HISTORIA E DIBRËS

Akademik Kristo Frashëri: "Unë e mendoj historinë e Dibrës jo si një histori pushke, luftëtarësh, siç e kanë qejf shumë malësorët e Dibrës kur flasin e tregojnë trimëritë. Unë dua bashkë me trimëritë, bashkë me gishtin - si i thonë pushkës, - kam dashur të shoqëroj dhe mendjen. Se Dibra ka pas edhe njerëz të mendimit. Ka dhe një prodhim që është prodhimi intelektual popullor, edhe prodhim intelektual që quhet refleksiv shkencor. Por Dibra në tërësinë e saj ka një pasuri të madhe aspektesh të jetës shoqërore, të jetës familjare edhe të jetës krahinore. Këtë kam dashur të përshkruaj në këtë libër, nuk e di sa ia kam arritur."

"Historia shkruhet dhe argumentohet me dokumenta", - theksoi Frashëri. Sipas tij,në Gollobordë banojnë tre grupe njerëzish:
Në Gollobordën Përëndimore ka fshatra shqipfolës, identiteti i tyre as që vihet në dyshim që janë shqiptarë.
Në Gollobordën Lindore ka fshatra dy gjuhë folës, shqip dhe bullgarisht.
Rajoni i Vjetër i Maqedonisë ka qenë përbërë nga helenët, ilirët dhe thrakët. Pra nëqoftëse bëjmë fjalë për maqedonas etnikë, janë ilirët.

Të ngresh teza të tilla dhe pretendime pa baza se në Gollobordë jetojnë qindra e mijëra bullgarë apo maqedonas, ndërkohë që Shqipëria, Maqedonia dhe Bullgaria janë pjesë e NATO-s dhe e Bashkimit Europian, janë teza shoviniste antishqiptare dhe njëkohësisht antieuropiane, përfundoi përgjigjen e tij Profesor Kristo Frashëri.

Në kuadrin e kartës së OKB, theksoi historiani Frashëri, ortodoksit e zonës së Gollobordës mbi bazën e vullnetit të tyre kanë të drejtën të vetdeklarojnë shtetësinë dhe kombësinë e tyre. Vetëm një gjë duhet patur mirë para sysh se toka e Gollobordës është tokë shqiptare dhe për mbrojtjen e saj nga pushtuesit serbë dhe bullgarë kanë dhënë jetën shumë patriotë të kësaj zone, kanë vdekur edhe gra e fëmijë.

Komisioni Ndërkombëtar i Kufijve pas vitit 1913 i përbërë nga italianë, francezë e rusë që ka vazhduar për ratifikimin e tyre deri në vitin 1920 ka marrë parasysh gjuhën shqiptare dhe kërkesat e kësaj zone me gjithë kundërshtimet e rusëve dhe për këtë ka fakte e dokumente, njerëz që kanë dhënë jetën në mbrojtje të kufijve. Për këtë problem unë kam patur debate edhe me historianë bullgarë dhe maqedonas.

Të ngresh teza të tilla dhe pretendime pa baza se në Gollobordë jetojnë qindra e mijëra bullgarë apo maqedonas, ndërkohë që Shqipëria, Maqedonia dhe Bullgaria janë pjesë e NATO-s dhe e Bashkimit Europian, janë teza shoviniste antishqiptare dhe njëkohësisht antieuropiane, përfundoi përgjigjen e tij Profesor Kristo Frashëri.

libër i ri

Xhafer Martini ka shkruar një libër serioz, me pasion dhe kulturë, me qëllimin e mirë për të ndriçuar një pjesë të rëndësishme të historisë sonë kombëtare dhe tok me të edhe figurën komplekse të Halil Alisë.

"Halil Alia" i Xhafer Martinit, një roman që sjell të vërtetën

Nga **Hysen REPA***

Shkrimtari Xhafer Martini kësaj radhe doli para lexuesve me monografi në e romanizuar, "Halil Alia", kushtuar njërës prej figurave më komplekse që ka nxjerrë historia jonë. Vendlindja dhe aktiviteti kryesor i Halil Alisë është në Dibër, por libri ka një rrezatim të gjerë që e nxjerr atë nga kuadri lokal dhe i jep një rëndësi mbarëkombëtare jo vetëm për mënyrën e konceptimit të figurës, por edhe për faktin që libri është një model i të shkruarit ndryshe të historisë.

Shkrimtari Xhafer Martini është i njohur nga lexuesi shqiptar si poet, kritik letrar, studiues serioz i të drejtës sonë zakonore, mbledhës dhe kodifikues i Kanunit të Dibrës etj. Ka një përvojë edhe si hartues i monografi ve për shumë figura të shquara të kombit tonë. Tek personaliteti krijues i këtij autori, historiani dhe shkrimtari punojnë bashkë, secili me mjetet e veta, në harmoni dhe në funksion të veprës, prandaj në monografi të e tij, krahas anës dokumentare, shikojmë edhe analiza të holla psikologjike të karaktereve, të tipave realë, por edhe të personazheve të krijuara. Zhbirimet në botën e tyre të brendshme i bën ata njerëzorë, me një fat historik të përcaktuar, por edhe të kërkuar, personalitete që nuk kanë ecur në rrugë të shtruara me asfalt, por në theqafje dhe gremina të rrezikshme. Autori i rikthehet figurës së Halil Alisë pas botimit të librit të parë: "Kaq shumë gurë u hodhën përmbi mua" (2007). Rikthimin tek veprat e botuara, Xhafer Martini, nuk e ka si qëllim në vetvete, por për të sjellë të dhëna dhe koncepte të reja.

Në këtë botim, ndryshe nga hera e parë, jeta e veprimtaria e Halil Alisë përmbledh të 34 vjetët e jetës së tij, që nga lindja deri në vdekje. Kapitujt e këtij libri përfshijnë: lindjen e Halilit, fëmijërinë, rritjen, mjedisin që e rrethonte, shkollimin, problemet e fisit të Alieve dhe të krahinës, miqësitë dhe armiqësitë, acarimet dhe pajtimet me krerët e parisë së Dibrës, ndikimi i fesë, marrëdhëniet me shtetin dhe pushtetin, bashkëpunimi me forcat pushtuese, hasmëria me Ndretë dhe Kaloshët, emigrimi, kthimi në atdhe, kuptimi për kolaboracionizmin, veprimtaria e tij ushtarake, besëprishjet, incidentet, atentatet, keqësimi i marrëdhënieve me italianët e të tjera.

Halil Alia, deri në vitet nëntëdhjetë, nga diktatura komuniste është konsideruar si armik i popullit, bashkëpunëtor i fashizmit, bashibozuk dhe kriminel, sidomos për luftën në Gjorm dhe vrasjen e Qazim Koculit. Pas viteve nëntëdhjetë është diskutuar dhe shkruar mjaftueshëm, por "bardhë e zi". "Fanatikët" nuk lëvizin nga konsideratat e dhëna që burojnë prej dokumentacionit dhe propagandës komuniste. Ka të tjerë që e glorifikojnë këtë figurë, duke mos e analizuar në kontekstin e kohës kur jetoi dhe veproi. Këta kanë qëllim vetëm ta lartësojnë Halil Alinë, por e humbasin masën aq shumë, sa e shkëpusin nga tabani kombëtar dhe nga koha në të cilën jetoi, nga njerëzit me të cilët luftoi. Ka edhe prej atyre që figurën e Halil Alisë e shikojnë në një kuadër më të gjerë, si produkt jo vetëm i rrethanave historike, por edhe në marrëdhënie me shumë fi gura të tjera nacionaliste antikomuniste që vepruan gjatë pushtimit nazifashist, në vitet 1939-1945.

Xhafer Martini i përket atij grupimi studiuesish që i vlerëson ngjarjet në kohën kur kanë ndodhur dhe në një terren konkret, në lidhje me mjedisin dhe psikologjinë shoqërore të asaj kohe, në lidhje me traditën dhe marrëdhëniet e atyre që jetuan në të njëjtat situata dhe kaluan nëpër të njëjtat ngjarje, duke dhënë kështu gjeopolitikën dhe politikën e kohës së pushtimit, të zakoneve, të traditave etj. Përshkrimi i miqësive dhe i armiqësive të "më të fortëve" të Dibrës, pesha e tyre në ngjarjet historike, ndikimi i Kanunit dhe i marrëdhënieve fisnore e më gjerë, administrimi dhe administrata, gjendja arsimore dhe kulturore e popullsisë, interesat e tyre ekonomike, të para këto në kompleksitetin e vet dhe me seriozitet, e bëjnë këtë libër bindës, me logjikë historike dhe të kuptueshëm për çdo lexues. Ndërhyrja e shkrimtarit në punën e historianit, nuk e cenon vërtetësinë e ngjarjeve dhe të karaktereve, por, përkundrazi, i afron ato më shumë me lexuesin. Kjo është arsyeja që tek ky libër nuk kemi një monografi të thjeshtë. Studiues, historianë, etnografë, psikologë, por edhe njerëzit e thjeshtë mund të gjejnë në këtë vepër ngjarje, qëndrime dhe fakte që duhen marrë në konsideratë.



Xhafer Martini i përket atij grupimi studiuesish që i vlerëson ngjarjet në kohën kur kanë ndodhur dhe në një terren konkret, në lidhje me mjedisin dhe psikologjinë shoqërore të asaj kohe, në lidhje me traditën dhe marrëdhëniet e atyre që jetuan në të njëjtat situata dhe kaluan nëpër të njëjtat ngjarje, duke dhënë kështu gjeopolitikën dhe politikën e kohës së pushtimit, të zakoneve, të traditave etj.

Më konkretisht, në këtë libër dalin më të evidentuara këto probleme:

1. Lindja dhe ngritja e një figure të fisit të Alieve, fis me histori dyshekullore të luftërave për liri dhe pavarësi, kreu i Malit të Çidhnës; fis që përjetoi lavdinë dhe rënien, ringritjen nëpërmjet një kalvari peripecish; fis me miq, por edhe me armiq të fuqishëm, siç ishin Ndretë dhe Kaloshët, me të cilët e bashkonte historia e lavdishme, por e ndanë dhe e armiqëson një ngjarje e dorës së dytë.

2. Në libër pasqyrohet Kanuni, dhe kultura e Çidhnës me një pasuri të rrallë historike, zakonore, alegorike, etnografi ke; ajo jepet si një zonë që kishte formë vetëqeverisëse parlamentin e përbërë nga 70 shtëpitë e Has Përnezhës, pleq e stërpleq, që ndanin Kanun në gjithë Dibrën, zonë ku pyetej i mençuri dhe jo i forti.

3. Halil Alia del si një individ që e nxori dhe e ngriti krahina e Çidhnës për ta përfaqësuar atë, duke i veshur krenarinë, trimërinë, përkushtimin atdhetar; Çidhna e ndoqi atë kudo pa e paragjykuar, "në të mirë dhe në të keqe". Këtë e tregoi pjesëmarrja e burrave të këtij Mali në tërë veprimtarinë ushtarake të Halil Alisë.

4. Kushtet për të qenë pari në Dibër ishin këto: "Trimëri, mençuri, sofër". Halil Alia nuk e plotësonte kushtin e "sofrës", ai nuk e kishte ekonominë e Ndreve, Kaloshëve dhe Hoxheve. Banorët e Çidhnës, duke qenë krenarë dhe të pabindur, nuk iu nënshtruan forcës së Halil Alisë për ta mbështetur ekonomikisht. Atij nuk i mbeti rrugë tjetër veçse të shfrytëzonte koniukturat politike dhe të përfi tonte nga pushtuesit. Shkrimtari këtë e jep me vërtetësi, pa ia mbajtur anën aspak Halil Alisë.

5. Edukimi arsimor dhe tradicional i Halil Alisë, i patrajtuar deri më sot, në këtë libër vjen në mënyrë kronologjike dhe të saktë. Halil Alia kishte një edukim arsimor, profesional dhe linguistik të kompletuar për kohën. Zotërimi i disa gjuhëve të huaja, përvoja dhe edukimi jashtë shtetit, si në: Jugosllavi, Itali dhe Rusi, i japin atij mundësinë për të qenë lider.

6. Pika më "errët" e kësaj figure - qëndrimi ndaj pushtuesit dhe Luftës Nacionalçlirimtaresqarohet mjaft mirë në këtë libër. Qëndrimi i pushtuesve ndaj Shqipërisë, krijimi i asaj Shqipërie që e ëndërronin dhe e dëshironin shqiptarët, qëndrimi ndaj popullsisë, marrëdhëniet midis krerëve nacionalistë, marrëveshjet dhe kontradiktat midis tyre, aleancat kundër vendosjes së komunizmit në Shqipëri, marrëveshjet e fshehta dhe të hapura të komunistëve shqiptarë me ata jugosllavë, zënë vend qendror në libër dhe të gjitha këto, të marra veç e veç, por edhe në tërësinë e tyre, përcaktojnë sjelljen e çdo individi ose grupesh të mëdha shoqërore, duke mos përjashtuar as Halil Alinë.

7. Veprimtaria e Halil Alisë në Vlorë, në fund të dhjetorit dhe në fillim të janarit të vitit 1943, është një tjetër çështje e nxehtë që komunistët shqiptarë e kanë shfrytëzuar 46 vjet me radhë për ta përbaltur këtë figurë. Aleancat lokale midis Qazim Koculit, Lelo Koçit me partizanët e vendit, bënë që të shkaktohet një luftë vëllavrasëse, megjithëse Halili me komisarin partizan ishin marrë vesh që një gjë e tillë të mos ndodhte. Halili mbas katastrofës që pësoi (iu vranë shumë vetë) vrau Qazim Koculin, Lelo Koçin (prefekt i Vlorës) dhe kolonel Klementin. Qeveria më vonë nxori urdhër arresti për Halil Alinë dhe Selim Xhetan Kaloshin, por ai nuk u zbatua. Dokumentet e kësaj periudhe dhe për këtë problem kundërshtojnë njëri-tjetrin dhe duket se janë prodhim i politikës koniukturiale.

Xhafer Martini e analizon me imtësi këtë periudhë dhe hedh dritë mbi të vërtetën me paanësi. Për vrasjen e Qazim Koculit, Halil Alisë dhe Selim Xhetan Kaloshit iu bë atentat në Tiranë, pa cilësuar cili qe autori ose autorët. Një luftë vëllavrasëse u bë në Dukat të Vlorës pa qenë fare i pranishëm Halil Alia e forcat e tij. Lufta vëllavrasëse qe mbjellë prej tjetër kujt.

8. Lufta civile midis forcave partizane dhe malësorëve, mbështetës të Halil Alisë, në qershor - korrik të 1944-ës, masakrat që bënë partizanët mbi Fushë Alien, pasqyrohen me një dritë të re nga Xhafer Martini. Marrëveshjet e lidhura në Dibër kanë një veçori në krahasim me krahinat e tjera të Shqipërisë. Kur ishte puna për liri dhe pavarësi, krerët e Dibrës bëheshin bashkë, duke ndërprerë çdo hasmëri. Kështu ndodhi edhe në atë kohë, para sulmit partizan mbi Fushë Alie, kur Kaloshët u pajtuan me Halil Alinë dhe i dhanë dorën e besën. Më vonë u pajtuan dhe shuan mosmarrëveshjet krejt krerët nacionalistë për të penguar vendosjen e komunizmit në Dibër. Xhafer Martini, djegien e Fushë Alies në një kohë ku aty nuk kishte jo më këmbë armiku, por as banorë vendas, që morën arratinë nga terrori komunist, e konsideron jo vetëm si luftë vëllavrasëse, por edhe si genocid kundër njerëzimit, kryer nga një ushtri e organizuar, me divizione dhe korparmata kundër një fshati të vetëm.

9. Forcat nacionaliste nuk e pushuan luftën kundër vendosjes së komunizmit edhe gjatë vitit 1945-ë. Markagjonajt, Muharrem Bajraktari, krerët e Malësisë së Madhe vazhduan rezistencën në male. Halil Alia nuk ishte nga ata krerë që braktisën vendin për të jetuar të qetë në Evropën Perëndimore. Ai qëndroi bashkë me ata që nuk iu ndanë asnjëherë, për të organizuar qëndresën kundër komunizmit derisa u vra në Kolesjan të Kukësit.

Megjithëse Halil Alia vdiq, lufta e PKSH-së ndaj Fushë Alies vazhdoi me mjete të tjera, në formën më të ashpër të luftës së klasave. Zona e Çidhnës nxori dëshmorë të tjerë të mospajtimit me regjimin komunist dhe të fjalës së lirë. Burgjet, internimet, pushkatimet u kthyen në simbol të rezistencës së këtij populli për liri dhe demokraci.

Kërkesës së ish-mësuesit tim në shkollën shtatëvjeçare të Fushë Alies për të shkruar parathënien për librin e tij më të ri "Halil Alia", iu përgjigja me kënaqësi, por edhe me njëfarë frike se, a do të isha unë në gjendje për të nxjerrë në pah vlerat e këtij shkrimtari dhe studiuesi, pena e të cilit na ka dhënë shumë libra me vlerë nga të gjitha fushat. Një tjetër vështirësi qëndron në faktin se, duke qenë bir i Fushë Alies, kisha frikë se nuk do t'i shmangesha "konfliktit të interesit". Kam besim se, si unë, si autori, kësaj ia kemi arritur plotësisht. Askujt nuk i duhet një Halil Alia i pavërtetë.

Në fund është lexuesi ai që do të vlerësojë ose kritikojë si parathënien time, ashtu edhe librin e Xhafer Martinit. Por, sido që të ndodhë, unë kam bindjen se Xhafer Martini ka shkruar një libër serioz, me pasion dhe kulturë, me qëllimin e mirë për të ndriçuar një pjesë të rëndësishme të historisë sonë kombëtare dhe tok me të edhe figurën komplekse të Halil Alisë.

* *Gjeneral Brigade në pension.*
Marrë nga parathënia e librit

Rruga e Arbërit nr. 137

Skënderbeun e thirrën shqiptarët të kthehej në atdhe për t'u vënë në udhëheqje, se vendi ynë i pushtuar kërcënohej nga perandoria osmane, por edhe nga venedikasit e krishterë, nga sllavët dhe grekët.

analizë

Për fe apo për atdhe thuri lavdi Skënderbeu?

Nga **Ahmet ÇAUSHI***

Shkruan shumë gazeta, më tepër se për çdo problem tjetër, edhe se për problemet e jetesës. U fol në tërë televizionet, u bë bujë e madhe se myslimanët paskan vendosur një perde para tyre për të shkëputur shikimin nga përmendorja e Skënderbeut. Kujtesa ime fluturoi larg, shumë larg në kohë. Ishte mars i vitit 1953. Isha në shkollë. Aty ku sot ngrihet krenar monumenti i Skënderbeut, qëndronte mbi këmbë guri monumenti i J. V. Stalinit. Ai vdiq e la pas kujtimin e miliona rusëve të vrarë e të persekutuar egërsisht.

Tërë populli i Tiranës mbushi sheshin para monumentit. Kish aq shumë njerëz: burra, gra, nxënës shkollash e të rinj. Të tërë ishin të zymtë; kishin zi. Para mijëra njerëzve, ballë për ballë me Stalinin bronz, ishte vendosur byroja politike me Enver Hoxhën në krye. Edhe ata pasqyronin vuajtjen e madhe të shpirtit të tyre për shpirtin e Stalinit "të madh". Të tërë e kishin përqendruar shikimin te Stalini. Askush nuk fliste. Ishin mbledhur për t'u betuar. Vunë ballin në tokë dhe u betuan para trupit akull të Stalinit se do të ruanin përgjithmonë në zemër bëmat e tij. Do të bënin si ai duke ndjekur atë rrugë në tërë jetën e tyre.

Zotni shkrues i artikullit për përmendoren e Skënderbeut, a thua ishte aty shpirti i Stalinit, a e dëgjoi ai betimin, e nëse e ka dëgjuar, me siguri është kënaqur?! Në rreshtat e parë të turmës ishte edhe udhëheqja e Komunitetit Mysliman Shqiptar. Vetëm këta dhe një pjesë e nxënësve të medresesë nuk e vunë ballin në tokë, e pësuan. H. Musa Basha, ish kryetar i Komunitetit Mysliman u pushua nga puna edhe pse shtëpia e tij kish qenë strehë partizanësh dhe e Enver Hoxhës.

Ne, myslimanët, e kemi ligj të padiskutuar: nuk u falemi as njerëzve, as skulpturave e pikturave. Besojmë një Zot, atë që krijoi qiell e tokë, njeriun dhe gjithçka në hapësira e në thellësi të tyre. Kjo është arsyeja që ndahemi gjatë faljes nga këto objekte me një perde si ajo që kanë vendosur ditën e Bajramit para monumentit të Skënderbeut. Kështu veprohet vetëm gjatë faljes.

Mungesa e njohurive nuk duhet të bëhet shkak për të shfryrë mllefin për fenë islame. Sheshi Skënderbej është i të gjithëve, sepse edhe ne, myslimanët, që përbëjmë mbi 70% të popullsisë shqiptare kemi kontribuar për të. A thua e prisni një ditë që myslimanët të mos kalojnë në këtë shesh?! Gabimi i të shkolluarit është i rëndë e nuk rregullohet lehtë.

A luftoi Skënderbeu për fe e, nëse po, për kë? A e shfaqi Skënderbeu ndonjëherë besimin e tij fetar? – Kurrë jo. Nëse thonë po, gënjejnë e historia nuk thuret me gënjeshtra. Skënderbeu u mor peng nga osmanët kur ishte në moshë të re. U arsimua në medresetë e Perandorisë. Njihte disa gjuhë. Ndërroi me dëshirë fenë dhe u bë synet. Sipas fesë islame nuk ka detyrim për të pranuar e as për të ndërruar fenë (Kur'an, 2: 256). Skënderbeu ishte shumë i zgjuar, trim, besnik, besnik i sulltanit e ky i fundit për merita i dha gradën "Bej". Gjergji u emërua Iskender, pra Skënderbej. Kështu u thirr tërë jetës. Kështu thirret edhe tani, 450 vjet pas ndërrimit jetë. Ai kurrë nuk kërkoi e as nuk pranoi të thirrej Gjergj, pra ruajti emrin mysliman Skënderbej. Me këtë emër mysliman bashkoi shqiptarët pa dallim feje. Lidhjen e Lezhës me këtë emër e bashkoi, fitoi betejën e parë në Torvioll të Dibrës kundër turqve myslimanë; me këtë emër fitoi 24 beteja të mëdha kundër turqve të komanduar nga dy sulltanët më me emër të perandorisë. Pas vdekjes, por edhe sot me këtë emër myslimani ne bashkohemi për interesat e kombit e të vendit tonë. Skënderbeu me këtë emër i kërkoi ndihmë Papës e ky i dha vetëm disa batanije. Me këtë emër ai ndihmoi të krishterët e Napolit kundër të krishterëve të Romës. Me këtë emër ai shpëtoi Evropën. Më këtë emër myslimani Skënderbeu dërrmoi në të njëjtën kohë edhe ushtrinë krishtere të Venedikut, me këtë emër luftoi kundër dredhive serbe, sllave e greke. A nuk donin të krishterët e Venedikut të na merrnin Shkodrën, Durrësin etj.? A nuk qenë të krishterët venedikas që helmuan Skënderbeun?



Foto © B.Karoshi

Mos e trazoni Skënderbeun. Ai e kreu më së miri detyrën e tij dhe ne myslimanët e kemi hero kombëtar, e kemi simbol të bashkimit pa dallim besimi, e kemi simbol atdhedashurie, simbol trimërie, vendosmërie, bese, simbol lirie e pavarësie.

PËR KË LUFTOI SKËNDERBEU?

Skënderbeun e thirrën shqiptarët të kthehej në atdhe për t'u vënë në udhëheqje, se vendi ynë i pushtuar kërcënohej nga perandoria osmane, por edhe nga venedikasit e krishterë, nga sllavët dhe grekët. Frontin e Evropës kundër rrezikut osman e udhëhiqte J. Huniadi. Skënderbeu nuk u bashkua me Huniadin se nuk ishte qëllimi i tij krishterimi. Ai erdhi në vendin e Kastriotëve, në Dibër, e pasi mori bekimin e tij, mori edhe dibranë me vete dhe shkoi në Krujë ku ngriti flamurin shqiptar, flamurin e lirisë e të pavarësisë. Është e vërtetë që fronti shqiptar ndaloi ushtrinë e Perandorisë më të fuqishme të kohës të përparonte në Evropë. Feja islame sot, pa luftë, po përhapet me shpejtësi në Evropë. E po të mos ishin gabimet e myslimanëve të paformuar, numri i tyre do të ishte shumëfishuar në Evropë dhe në botë.

A luftoi Skënderbeu kundër fesë? Kundër cilës fe luftoi? Mllefi dhe injoranca nxisin të deklarosh apo të pranosh se Skënderbeu luftoi fenë islame, luftoi kundër myslimanëve. Jo. Ai luftoi kundër pushtuesve të atdheut, luftoi kundër tradhtarëve, duke përfshirë edhe nipin e tij, djalin e vëllait, Hamzain.

Lexoni me kujdes Kur'anin e do të bindeni se ai të bën atdhetar, trim, të besës, të dashurisë për njeriun. Në suren "Huxhurat", ajeti 13, thuhet: "O njerëz, (Ne) ju krijuam prej një mashkulli dhe një femër, ju bëmë popuj (kombe) e fise që të njiheni ndërmjet jush. Tek Allahu më i miri prej jush është më i devotshmi". Më tej – ndër argumentet më të forta është se secili komb ka gjuhën e tij. Ky urdhër hyjnor secilit popull i siguron liri, pavarësi, pronësi dhe të drejtën për të mbrojtur vendin e tij, për ta zhvilluar popullin e tij. Skënderbeu e njohu mirë Kur'anin, prandaj e kreu më së miri këtë detyrë. Nëse mësimet e Kur'anit do të praktikoheshin, nuk do të kishte pushtime e robëri. Skënderbeun e bënë hero kombëtar. Kush? 70% e popullsisë shqiptare është e fesë islame. Të tjerët së bashku janë 20%. Myslimanët e duan Skënderbeun, gjatë tërë jetës janë udhëhequr nga vepra dhe emri i Skënderbeut. Lidhja e Prizrenit u stimulua e mori forcë nga bëmat e Skënderbeut. Ajo u drejtua nga dibrani Iljaz Pashë Qoku, Haxhi Zeka i Kosovës, Abdul Frashëri i jugut... Qindra e mijëra të tjerë, që kishin mësuar në medresetë islame, u bënë pjesë e Lidhjes së Prizrenit, i dhanë drejtim e forcë luftës për pavarësi. A nuk ishin myslimanët: Ismail Qemali, Haxhi Vehbi Dibra, të krishterët Luigj Gurakuqi, Dom Nikollë Kaçorri, drejtues të luftës për pavarësi?! Ishin mijëra myslimanë e të krishterë që luftuan pushtuesit: turq, italianë, grekë, serbë, francezë, austriakë, gjermanë etj., e së bashku i dhanë lirinë dhe pavarësinë popullit tonë. Mos more Agron Gjikmarkaj, mos e nëpërkëmb shkollën që ke bërë, mos nxit shqiptarët kundër shqiptarëve. Populli ynë i paepur luftoi gati dy mijë vjet e nuk u zhduk, as nuk u dorëzua. Gati 1500 vjet i pushtuar nga të krishterët evropianë dhe afërsisht 500 vjet i nënshtruar nga turqit myslimanë dhe formojnë një raport 3 me 1. Sot jetojmë në kushte të tjera, prandaj duhet të krijojmë baza të reja për të qenë më të bashkuar, se kështu do të jetojmë pa mbarim. Fetë nuk kanë vendlindje tokën, prandaj nuk kanë as atdhe. Atdheu i fesë është zemra e njeriut.

Po prekim një problem tjetër serioz. Ju shkruani në gazetën "Panorama" 2 shtator 2017: "Ata mund t'i mbulojnë gratë e tyre, por jo gratë tona". Zotni, nuk i ndalon askush gratë tuaja të marrin pjesë edhe në konkursin brazilian për të fituar disa dollarë; gjithashtu mund t'i dërgoni edhe në azilin e Parisit, i cili do të ngrihet shumë shpejt për të jetuar atje "nudo". Askush nuk ju ndalon. Gratë tona do të vishen, nuk do të jenë pre e punëkeqit, do të vendosin edhe shami, e cila është edhe pjesë e kostumit tonë kombëtar që nga koha e pellazgëve, e ilirëve, e arbëreshëve dhe sot e shqiptarëve.

Pse kërkohet kaq shumë Skënderbeu nga gazetarë, politikanë e qeveritarë të paformuar apo nga të krishterët? Në vitet e krizës qeveritare 1997-2000 në Shqipëri erdhën nga Evropa qindra misionarë të krishterë për t'i bërë thirrje popullit tonë: "Kthehuni në fenë e të parëve tuaj, në fenë e Skënderbeut". Ndër më aktivët ishte italiani Mark Klark, misionar i Jehovait, i cili nuk përtonte të takonte qindra myslimanë në ditë e t'u thoshte se Skënderbeu ka qenë i krishterë, prandaj edhe ju duhet të mbani fenë e tij. A ishte Skënderbeu i krishterë? Kur e morën Skënderbeun në Turqi ishte i ri. Atë e dërguan në shkollë, pranoi fenë islame, ndërroi emrin nga Gjergj në Skënder dhe u bë synet. Thonë se edhe Gjoni, i ati, e pat pranuar fenë islame. Skënderbeu kurrë, gjatë jetës së tij, nuk iu kthye emrit Gjergj. Me emrin mysliman u bë i famshëm, me këtë emër u kthye në Shqipëri, me këtë emër iu drejtua Papës, me këtë emër dërrmoi pushtuesit e tij, myslimanët turq, me këtë emër e me shpatën e tij luftoi kundër pushtuesve të krishterë venedikas, me këtë emër lindi edhe fëmijë. Skënderbeu futi në kanunin e tij ligje islame. Për gjakmarrje kufizoi vrasjen masive me dënimin vetëm të personit që vret dhe pajtim, siç e thekson Kur'ani.

Në Kur'an ndalohet lufta. Ajo lejohet vetëm kur ta imponon kundërshtari. Lufta fetare është më e tmerrshmja, më e tmerrshme se luftërat botërore, sepse arrin deri në familje e çon në zhdukjen e saj, në zhdukjen e njerëzimit. Nuk duhet nxitur kjo luftë, nuk i duhet fryrë këtij zjarri që fillon nga një gazetar i papërgjegjshëm e përhapet në tërë botën pa përjashtim. Mos e trazoni Skënderbeun. Ai e kreu më së miri detyrën e tij dhe ne myslimanët e kemi hero kombëtar, e kemi simbol të bashkimit pa dallim besimi, e kemi simbol atdhedashurie, simbol trimërie, vendosmërie, bese, simbol lirie e pavarësie.

Mësues pensionist

histori

Në ndihmë të përkatësisë etnike të Vojsava Kastriotit na vijnë dokumente bashkëkohëtarësh të saj, që shprehen se ajo mbante të njëjtin mbiemër (Tribalda) bashkë me Vrana Kontin.

Mbi përkatësinë etnike të **Vojsava Kastriotit**

Nga **Murat KOLTRAKA**

Studiues e historianë sjellin fakte dhe argumentojnë se trojet etnike të shqiptarëve deri vonë kanë qenë mbi 99 mijë kilometër katrorë. Si pasojë e pazareve për të kënaqur lakmitë grabitqare të fqinjëve tanë, trojet tona u rrudhosën deri në 28 mijë km katrorë, ose 28.3% të tyre. Tendenca të tilla shfaqen edhe sot në ditët tona, sidomos në Jug të Shqipërisë çka do të thotë se lakmitë e tyre për të na grabitur edhe më shumë nuk kanë të ndalur.

Studiues e historianë të huaj nga vende shumë të zhvilluara janë shprehur e vazhdojnë të shprehen, se Shqipëria (e zvogëluar) është e ngjarjeve të mëdha në histori. Edhe në këtë fushë tendencat e mohimit, të tjetërsimit, të grabitjes, kanë qenë e vazhdojnë të jenë të etshme, sistematike e të pandërprera. Nga fqinjët tanë na kërkohet deri dhe të ndryshojmë tekstet e historisë sonë, që ata të pastrohen nga patriotizmi, atdhedashuria, që të mohohet dhe kontributi historik i martirëve të këtij kombi të rënë në mbrojtje të territoreve tona në luftë pikërisht me paraardhësit e këtyre pushtuesve. Ndonese për interesat e tyre ata janë nacionalist ekstrem, ne na rekomandojnë dhe na vënë dhe kushte për të qenë liberalë.

Për rreth dy shekuj historianë të vendeve fqinje u përpoqen që Kastriotët e famshëm, që tronditën botën me veprën historike që na lanë, t'i bënin të tyre sllav, apo grek, qe ky kontribut i jashtëzakonshëm i tyre të mos ishte i Heroit tonë e i shqiptarëve, por i sllavëve, apo i grekëve. Dalja në dritë e dokumenteve e dëshmive të bashkohësve të Skënderbeut, si të Gjon Muzakajt, Barletit, studiuesit italian Rafael Volaterano e të tjerë, shënoi fundin e këtij debati, dështimin e tyre. Ky kapitull u mbyll plotësisht nga dëshmia e vet Gjergj Kastriotit, Skënderbeut, në letrën që i dërgoi princit të Tarentit Xhovani Antonio Orsini, më 31 tetor 1460, kur heroi ynë vetdeklaroi origjinën shqiptare të Kastriotëve.

Në histori sillen plot shembuj që shpjegojnë se perandorë e mbretër nga vendet e ndryshme kanë qenë të martuar me gra nga shtresat e larta të kombësive të tjera. Martesa të tilla bëheshin për qëllime politike me interesa të ndërsjelltë. Nuk kemi lexuar, as informuar nga të tjerët, të jetë debatuar mbi përkatësinë etnike të ndonjërës nga gratë e tyre, siç është debatuar mbi përkatësinë etnike të Vojsava Kastriotit, të shoqes së Gjonit, të ëmës së Skënderbeut. Në thelb të çdo orvatje të fqinjëve tanë qëndron e njëjta strategji, tendeca e mohimit të çdo vlere shqiptare, tjetërsimi, dhe më pas përvetësimi i saj prej tyre.

Kush shërbeu si bazë rreth debatit mbi përkatësinë etnike të Vojsava Kastriotit?

Së pari, autorët bashkëkohës të Skënderbeut si Gjon Muzakaj, Barleti, Volaterano e të tjerë, në shkrimet e tyre nuk u shprehën mbi përkatësinë etnike të Vojsava Kastriotit, jo se nuk e dinin, por ngaqë dihej nga të gjithë për kohën e tyre, e quajtën të panevojshme. Kjo u dha shkas studiuesve të mëvonshëm të ndaheshin në dy grupe. Disa prej tyre janë shprehur për Vojsavën si arbëre, të tjerë e paraqesin atë si sllave.

Së dyti, mendimet e disa autorëve mbi Vojsavën si sllave i përkasin kohës kur debatohej edhe për Kastriotët si sllav, pasi ende nuk kishin dalë në dritë dokumente autentike e dëshmi bashkëkohëtarësh mbi përkatësinë etnike të Kastriotëve. Për inerci, por edhe për interesa të caktuara, ata ecën në këtë linjë duke e paraqitur Vojsavën të përkatësisë etnike sllave.

Së treti, disa studiues janë mbështetur në burime jo të sakta. Të tjerë nuk janë treguar të saktë e real, për shkak të distancës së largët, mosnjohjes së terrenit, administrimit të tij, sidomos të Pollogut, që zotërohej nga i ati i Vojsavës.



Burimet historike flasin për kohën e ardhjes së grekëve e të sllavëve në Gadishullin Ballkanik (Ilirik). Për shqiptarët nuk ka një informacion të tillë, pasi nuk janë ardhacakë, por autoktonë në trojet e tyre etnike, që kur lindi jeta në këtë rajon.

Shpreh shqetësim dhe keqardhje, kur në mediat e shkruara, ndonjë pedagog i yni, pseudoanalist të ushqyer nga kuzhina antishqiptare rreth nesh, paraqet Vojsava Kastriotin me origjinë serbe...

Së katërti, edhe trajta sllave e emrit të saj ka ndikuar në animin e tyre mbi përkatësinë etnike sllave të Vojsavës. Por, shqiptarët në asnjë periudhë, ashtu si në ditët tona, ne përdorimin e emrave nuk janë ndikuar nga përkatësia etnike së cilës i përkasin emrat.

I pari që flet për Vojsava Kastriotin është Barleti (1508). Ai shkruan, se ajo ishte e shoqja e Gjon Kastriotit, bija e princit fisnik të Tribaleve, por nuk përcakton përkatësinë etnike të saj.

Muzakajt kishin lidhje miqësore të ndërsjelltë me Kastriotët. Gjon Muzakaj mik i familjes së Skënderbeut, bashkëkohës i tij, në "Memorada" shkruan: "Gjon Kastrioti, i ati i zotit Skënderbeg, pati për grua zonjën Vojsava Tribalda, me të cilën lindën katër fëmijë meshkuj edhe pesë fëmijë femra". Sipas Fan S. Nolit, është Gjon Muzakaj i pari që përmend mbiemrin Tribalda të Vojsava Kastriotit. Gjon Muzakaj shkruan: "E ëma e të thënit zotit Skënderbeg, gruaja e të thënit zotit Gjon, pati emrin Vojsava Tribalda dhe vinte nga një derë e fisme".

Lind pyetja; Pse Gjon Muzakaj nuk u shpreh mbi përkatësinë etnike të Vojsava Kastriotit? Ai ishte mik i kësaj familje, kushëri i parë i Donika Kastriotit sipas prof. dr. Kristo Frashëri. Përkatësia etnike e Vojsaves ka qenë e ditur jo vetëm prej tij, por edhe nga të tjerët bashkëkohës të Muzakës, të trashgimtarëve të tyre, rrethit miqësor e të tjerë. Është një arsye për t'u bashkuar me mendimin e disa studiuesve seriozë rreth këtij problemi, të cilët thonë se, meqenëse dihej përkatësia etnike e saj nga Muzakaj e të tjerët në kohën e tij, nuk ka qenë e nevojshme të trajtohej më tej problemi i saj, përkatësia e saj etnike.

Është momenti të ndalemi në një çështje. Historiani nga Zvicra O. Shmitt në librin e tij "Skënderbeu", botimi i vitit 2007 rezulton të ketë shfrytëzuar shumë burime arkivore, sidomos sllave rreth Kastriotëve. Mbi përkatësinë etnike të Vojsavës ai nuk arriti të gjejë ndonjë dokument të besueshëm e bindës, por u detyrua të bazohej në një supozim të paargumentuar (përrallë), kur në fq. 37 të librit të tij shkruan: "...duhet supozuar se Vojsava do të ketë qenë e bija e Grgur Brankovicit". Mbi bazën e këtij supozimi ai nxjerr edhe përfundimin absurd: "...princi Gjergj Brankovic, padyshim kushëri i Skënderbeut" fq. 55. Pra sipas tij Vojsava Kastrioti duhet të kishte mbiemrin (Vojsava) Brankoviç dhe jo (Vojsava) Tribalda siç shkruan Gjon Muzaka. Kush ka të drejtë Gjon Muzaka, që ka jetuar me Vojsava Kastriotin, apo ky O. Shmitti nga Zvicra, që ka lindur 6 shekuj pas tij. Ja sa qesharake përpara shkencës së historisë bëhen historianë të tillë si dhe ky Zvicerani, që falsifikon historinë për interesa të caktuara.

Në ndihmë të përkatësisë etnike të Vojsava Kastriotit na vijnë dokumente bashkëkohëtarësh të saj, që shprehen se ajo mbante të njëjtin mbiemër (Tribalda) bashkë me Vrana Kontin. Gjon Muzaka për Vrana Kontin shkruan: "Një princ shqiptar me titullin "Markeze" di Tribalda, i cili rronte në Itali pas vdekjes së Skënderbeut, kishte gjak prej të Muzakajve". Pra ky komandant i shquar në ushtrinë e Skënderbeut, që shkëlqeu edhe në ushtrinë e mbretit të Napolit, duk i Ferandines dhe "Markeze" i Tribaleve, që ishte gjak i pastër arbër, mbante të njëjtin mbiemër me Vojsavën, mbiemrin Tribalda. Kjo do të thotë, se ata ishin të një gjaku, arbër, kishin të njëjtën përkatësi etnike dhe që të dy vinin nga një degëzim i familjes fisnike të Muzakajve.

Zotëruesi i krahinës së Pollogut nga disa studiues na jepet i ati i Vojsava Kastriotit. Këtë dëshmojnë autorët; Anonimi në veprën: "Punët e ndritshme të zotit Gjergj Kastriotit Skënderbeu" (1539), Françesko Sansovani (1568), Lavardini (1577) e të tjerë. Këta shprehen se Vojsava ishte e bija e princit të Pollogut.

I cilës etni ka qenë princi i Pollogut, i ati i Vojsavës?

Pas vdekjes se Stefan Dushanit dhe shembjes së perandorisë së tij serbe, sipas disa burimeve historike, fisniket arbër u ngritën dhe rimorën territoret e tyre të humbura. Prof. Pëllumb Xhufi në studimin e tij "Zotërimi i Gropave të Dibrës në shek. XIII-XIV, "na sjell një fakt interesant. Pas vdekjes së S. Dushanit zotëruesi i trevës së Dibrës përmendet zhupani i madh Andrea Gropa. "Ky arriti të presë monedhën e tij, gjë që tregon se ai kishte mundur të ngrejë një principatë mjaftë të fuqishme". Më tej autori shpjegon se A. Gropa i shkoi në ndihmë despotit të Beratit, vjehrrit të tij, Andrea Muzaka, për marrjen e Kosturit, i cili sundohej nga princi serb Marko Krajleviç. Me rënien e tij, Kosturi u kaloi Muzakajve, kurse Andrea Gropa u bë sundimtar dhe i Ohrit. Të njëjtin fat me atë të M. Krajleviçit patën edhe princër të tjerë serb, që sunduan në territoret shqiptare, të ardhur në pushtet gjatë sundimit të S. Dushanit.

Studiues e historianë të kësaj periudhe, ndër këta Fan S. Noli argumentojnë, se gjatë shekujve XIII-XIV fisnikët arbër sundonin deri në rrjedhën e sipërme të Vardarit, që nga Balshajt, Gropajt, Muzakët, Kastriotët e të tjerë. Brenda këtij territori përfshihej edhe Pollogu, zotërues i të cilit ishte i ati i Vojsavës. Sipas tyre princi i Pollogut duhet të ishte arbër, pasi një princ serb nuk mund të ushtronte pushtetin e tij në një territor të rrethuar nga fisnik arbër. Rreth popullimit të këtij rajoni me shqiptar, shkrimtari ynë i madh Ismail Kadare është shprehur: "Është absurde, që shqiptarët nga majat e larta të Shqipërisë të mos e kishin vërejtur një fushë aq pjellore para hundës së tyre, e serbët gjoja e paskan parë këtë fushë të begatshme, që përtej Danubit, nga Rusia e largët".

Mbi përkatësinë etnike të princit të Pollogut na sjell një informacion më shumë interes studiuesi dibran Hilmi Sadiku. Në studimin e tij ai pohon se Andrea Engjell Flav Komneni, Vojsava Kastriotin e nxjerr nga familja e Muzakajve. Po në këtë punim të tij rreth përkatësisë etnike të Vojsavës thuhet se Kostandini, djali i Gjon Muzakës, mbështetur në gjenealogjinë që i dërgoi Andrea E. F. Komneni i bëri një shtesë kronikës së të atit (Gjonit), për t'ua lënë pasardhësve në të cilën thuhet: "Vojsava jepet e bija e Momcinit, që u bë shoqja e Gjonit, të cilëve u lindi Gjergj Kastrioti". Kostandin Muzaka princin e Pollogut na e paraqet të kombësisë arbëre, për pasojë i kësaj etnie rezulton edhe e bija e tij Vojsava.

Aleksandër Cutolo në veprën e tij "Skënderbeu" fq. 20 botuar në Milano në 1940 shkruan: "Gjoni mori për grua princeshën Vojsava, të bijën e një kreu tjetër shqiptar të shkëlqyer, zotit të Pollogut". Ky autor zotin e Pollogut, të atin e Vojsavës e paraqet arbër të shkëlqyer.

Fan S. Noli, në punimin e dytë mbi "Skënderbeun" 1947, duke iu referuar K. Hoph në "Croniques"fq. 308 shton: "Muzaka thotë se Vojsava ishte shqiptare nga gjaku i Muzakajve".

Mbështetur në dëshmitë e Muzakajve rreth Vojsava Kastriotit (Tribalda), në burimet që flasin për sundimin e fisnikëve arbër në lindje deri në rrjedhën e sipërme të Vardarit përfshirë këtu edhe Pollogun, në atë që na sjellin Andrea E. F. Komnen, Fan S. Noli, A. Cutolo e të tjerë, si dhe në mungesë të ndonjë dokumenti argumentues dhe bindës të kundërt me këta, mendojmë se hidhet mjaftueshëm drite për të pranuar se Vojsava Kastrioti, e ëma e Skënderbeut, i përkiste etnisë arbëre dhe jo asaj sllave. E bëra këtë studim mbështetur në disa burime rreth kësaj çështje me dëshirën për të hedhur sado pak dritë rreth këtij problemi.

Shpreh shqetësim dhe keqardhje, kur në mediat e shkruara, ndonjë pedagog i yni, pseudoanalist të ushqyer nga kuzhina antishqiptare rreth nesh, duke paraqitur Vojsava Kastriotin me origjinë serbe, tradhtojnë interesat e kombit të tyre dhe insistojnë që Skënderbeun ta bëjnë dhe gjak serb për t'u faturuar atyre, jo pak nga vlerat e mëdha të historisë së heroit tonë kombëtar. Nuk është normale që intelektualë të këtij niveli, mbi bazën e konstatimeve të sipërfaqshme e të pabazuar, ose të qëllimshme sipas detyrave të dhëna, të sjellin dëshmi të tilla. Ata kanë për detyrë të mbrojnë historinë e kombit të tyre, për shkak të profesionit që ushtrojnë dhe pozicionit që kanë.

Rruga e Arbërit nr. 137

kulturë

Hahn në Kala të Dodës

Nga **Metush SKEJA**

Hahn.G.J. është emër i njohur për lexuesin tonë.E njohur është edhe vepra shumë-vëllimëshe e tij.Unë do të sjell në kujtesë për gazetën "Rruga e Arbërit" udhëtimin e Hahn në Radomirë. Konsulli i absburgëve e ka vizituar Radomirën më 1863. E ka bërë të njohur në gjuhën gjermane më 1867 "Udhëtim nëpër viset e Drinit e Vardarit".Në shqip është përkthyer më 2001. Ka një kapitull për Radomirën me 21 faqe.

Emrin Kala e Dodës e përmend shtatë herë. Emër vendi Kala e Dodës ka ekzistuar shumë kohë më parë se të vinte Hahn. Ka një të vërtetë që toponimet janë të qëndrueshme dhe nuk ndryshojnë kollaj, ndoshta me shekuj. Ka sot shkrime që togfjalëshin Kala e Dodës e kanë zevëndësuar me togfjalësha të tjerë. Këto të fundit janë krijesa artificiale dhe nuk përkojnë as me të dhënat historike e as me të folurit e kujtesën e banorve të saj.Hahn nuk ka qenë njeri i thjeshtë. Emërtimin Kala e Dodës e ka gjetur dhe e ka shkruajtur siç e ka gjetur.

Hahn nuk ka parë kala. Por ai na jep të dhëna interesante.1- "Duhet thënë që ne patëm rastin të kalojmë vetë pranë vendeve ku gjenden gjurmët e qyteteve te hershme". 2-"Në viset përqark njihen gjithashtu edhe shumë vende të tjera ,ku dikur kanë ekzistuar kisha të krishtera". 3-"Banesat pranë të cilave ne patëm rastin të kalojmë,dëshmojnë pothuajse të gjitha që banorët e tyre gëzojnë një mirëqenie ,e cila e kalonte në mënyrë të ndjeshmë parashikimin që mund të bëhej duke pasur parasysh tokat e tyre bujqësore." 4-"Burime të tjera të jetës së tyre."(Hahn G. J. Udhëtim nëpër viset e Drinit e Vardarit, Tiranë, 2001, f.221)Në faqen 209 janë tokfjalshat impozant "rrënoja kishash të vjetëra" dhe "ndërtime të mëdha."

Banorët e Kalasë Dodës burimin e mirëqenies në periudhën osmane e kanë pasur nga blektoria. Hahn nuk i ka parë tufat e mëdha të deleve, pasi kanë qenë në bjeshkë. Kalaja ka pasur afro një milion krerë dele. Në Kala gjenden shumë kisha katolike ku Han ka kaluar afër tyre,si kisha e Qinamit, kisha poshtë Kroit të Damallit në Vasije, dy kisha në Ploshtan, dy në Ceren kisha e madhe mes arës së Qerim Skejës e Imer Kadiut dhe kisha e vogël të Dardha e Kadisë, kisha e Tallamazit, kisha në Ujëmirë, kisha e Gramës, kisha në Kullas etj.

Hahn në Ploshtan ka takuar Has Begun guvernatorin e Kalasë i cili kishte ardhur nga afër Drinit dhe Sebuli Agë Radomirliun presidentin e këshillit krahinor nga Radomira. Nga Ploshtani në Radomirë e ka shoqëruar Sebuli Aga.Hahn ka fjetur në Radomirë te shtëpia e presidentit.(termi presidet është i Hahn). Sipas meje, ka bujtur në lagjen Stërdok dhe jo në Kullas siç thotë Kristo Frashëri.

Interesant është personaliteti i Sabuli Radomirliut."Kishte shëtitur në vende të ndryshme të botës. Ai kishte njohur Ali Pashë Tepelenën dhe princat e tjerë të fundit të Shqipërisë, kishte luftuar shpesh herë në More kundër grekëve.Kishte një fytyrë me tipare të imta e një mjekër të bukur bojë argjendi." (Po aty f. 220) Princat



Banorët e Kalasë Dodës burimin e mirëqenies në periudhën osmane e kanë pasur nga blektoria. Hahn nuk i ka parë tufat e mëdha të deleve, pasi kanë qenë në bjeshkë. Kalaja ka pasur afro një milion krerë dele. Në Kala gjenden shumë kisha katolike ku Han ka kaluar afër tyre,si kisha e Qinamit, kisha poshtë Kroit të Damallit në Vasije, dy kisha në Ploshtan, dy në Ceren kisha e madhe mes arës së Qerim Skejës e Imer Kadiut dhe kisha e vogël të Dardha e Kadisë, kisha e Tallamazit, kisha në Ujëmirë, kisha e Gramës, kisha në Kullas etj.

e tjerë të fundit janë Bushatllitë. Sabuli Agë Radomirliu ngjason me një ministër të jashtëm. Sot ka djem e vajza të kësaj zone përfesionistë të shkolluar për marrëdhënie ndërkombëtare dhe diplomatë kariere.

Personazhi i tretë që përmend Hahn është Derven Aga. Në udhëtimin e parë të Hahn i ishte thënë se Kalaja e Dodës ndodhet rrëzë Korabit dhe është selia e Derven Agës, i cili konsiderohej si më trimi dhe më i fuqishmi i gjithë krahinës,por Hahn nuk e ka takuar.

Po të më pyetësh mua si mësues i vjetër se çfarë mësimi kanë mësuar më mirë në shkollë djemtë e Kalasë Dosës unë do të përgjigjem "Udhëtimet e Kristofor Kolombit."Djemtë e Kalasë Dodës i gjen sot nga Alaska deri në Australi.Demokracia u krijoi shanse të jashtëzakonshme.Dhe kanë ditur t'i shfrytëzojë në hapësirat e lirisë, e cila u lejoi të çlirojnë energji të papara.

Tiranë, shtator 2017

Regjisori Bajram Torba vë në skenë "Fjala gdhend gurin"

Në mbrëmjen e 29 shtatorit në Pallatin e Kulturës Kamëz u zhvillua takimi i interpretuesve nën moton: "FJALA GDHEND GURIN".

Aktiviteti pati karakter konkurrues të fjalës artistike, me poezi të përzgjedhura nga poetë shqiptarë. Ideja dhe regjia e këtij aktiviteti ishin nga Bajram Torba, ndërsa moderimi u bë nga Eltona Lakuriqi.

Në këtë aktivitet morën pjesë 16 konkurrentë recitues: Sibora Huta, e cila ishte më e reja nga të gjithë konkurentët pjesëmarrës, e cila vinte nga Tirana, pastaj vinin: Lediona Braho, Dritan Thomorai, Artiola Hoxha, Fjola Gjonaj, Xhiliola Lamaj, Adela Hila, Elsard Ngjeci, Netida Mata, Gerta Cano, Klea Rrapaj, Emelinda Sheti, Eglantina Babqori.

Juria, e cila ishte e përbërë nga: poetesha Lola Shehi, Fejzi Murati dhe nga aktori Franc Bregu, akordoi disa çmime.

Çmimi i parë u fitua nga Gerta Cano, e cila performoi me Monologu i Plakës Nicë. Çmimi i dytë iu akordua Enida Shehit, e cila recitoi "Lakonti" të I. Kadaresë. Ndërsa çmimi i tretë iu dha Lediona Brahos.

Në fjalën e tij të hapjes, ideatori dhe regjisori i këtij aktiviteti, Bajram Torba u shpreh: "Ky aktivitet, me grupmosha të ndryshme, të rinj e të reja, shërben për mëtej të nxisë fjalën artistike, e cila nga dita në ditë po sfumohet."

Gjatë aktivitetit u recituan poezi të Ismail Kadaresë, të Martin Camajt, Ali Podrimjes etj.





"Me këtë trupë amatore dhe me këto shfaqje, së pari ngre emrat e poetëve të cilët kanë ngelur në hije dhe së dyti, për të përzgjedhur elementë të rinj artistikë. Vlen të theksohet se kjo shfaqje u bë pa vlera monetare", - thotë regjisori Torba.

"Ditët e sotme nuk nuk punohet me fjalën artistike. Nga ana tjetër fjala është gjë e shtrenjtë, sepse edhe Ezopi e Homeri, me anë të fjalës bënin magji", shton më tej ai.

Regjisori Bajram Torba shprehet se me trupën amatore teatrore "Rikthimi", synojmë rikthimin jo të veprave të huaja me autorë të huaj, por të vetë veprave dhe dramave shqipe, me dramaturgë, shkrimtarë dhe poetë të vendit tonë.

Këto elementë janë përzgjedhë nëpër shkolla dhe nuk janë një trupë statike, sepse secili ka angazhimet e veta. Por unë kam bërthamën 7 artistësh, ku dy prej tyre janë instrumentistë. Sigurisht që në të ardhmen synojmë ta zgjerojmë me përzgjedhje të reja

E gjitha kjo bëhet në kuadër të ndërtimit dhe të rikthimit të traditës së trupave amatore jo vetëm në Kamëz, por edhe në vende të tjera të Shqipërisë.

Alban TUFA



portret

Një vit pa
Profesor Mahmud Hysën

Një herë në njëqind vjet lind Dibra e Madhe...

Nga **Hysen KOSOVRASTI**



Mahmud Hysa: "Të jesh larg Dibrës përmallohesh, të shkosh në Dibër pezmatohesh..."

Prof. Hysa tashpërtash është i papërsëritshëm, emri i tij nuk do të harrohet sa të jetë jeta, njerëzit e tillë i ndriçojnë veprat, do të mallëngjehet Dibra e Madhe ku lindi dhe u rrit, do të mallëngjehen nxënësit e studentët ku ai shpërndau dijen. Do të mallëngjehemi të gjithë dhe përgjithmonë.

Jeta i ka të papriturat e saj dhe shpesh na befason edhe atëherë kur nuk e pret. Kështu ndodhi me mësuesin tim të klasës së tretë të vitit shkollor 1952/53, në Shkollën "Skënderbeu", sot shtëpia e Zimi Hames. Ishte një çun i ri. Mësues me përkushtim. Energjik. Kurrë nuk u ul në katedrën e tij. Nga fillimi i orës e gjer në fund të saj, vetëm se fliste, për të na dhënë dije në të gjitha lëndët, duke e mbushur dërrasën e zezë me sqarim. Kur mbaronte ora, shkuma i dilnin nga goja.

Mësuesi im vdiq para një viti në moshën 82 vjeçare. Për vdekjen e tij më lajmëroi Dr.Afrim Maqellara, që ishte edhe mjek familjar i tij. Edhe pse kaloi një vit që s'është më, në Dibrën e Madhe ku lindi dhe hodhi shtat, shpeshherë kur kalojmë nga bulevardi, kthejmë kokën në dyqanin e Ilmiut, ku ai bënte pushimin dhe ç'malleshte me shokët. Po kush ishte mësuesi im, që doktoroi në vitin 1980 në Universitetin e Prishtinës dhe fitoi të gjitha titujt e gradat akademike deri në profesor i rregullt. Prof.Dr. Mahmud Hysa u lind në Dibër të Madhe më 1934. Filloren e mbaroi në vendlindje, tetëvjeçaren në Tiranë, të mesmen, normalen në Shkup dhe Tetovë për tre vjet, sepse ishte nxënës ekselent. Pas mbarimit të normales punoi një vit shkollor në Forinë të Gostivarit, sipas emërimit të Ministrisë së Arsimit. Vitin tjetër transferohet në Dibër. Studimet i vazhdoi në Beograd në Fakultetin Filozofik, Dega e Albanologjisë, ku u diplomua në vitin 1957. Pas diplomimit ligjëroi në tetëvjeçare në Dibër, gjersa u hap gjimnazi. Vitin e parë në gjimnaz punoi vullnetarisht bashkë me Prof.Nehat Bellçishta, Bardhyl Cami, Muhamet Paçuku, Zhivko Sarevski etj., pa të cilët nuk do të hapej gjimnazi si shkollë e mesme në Dibër. Hapja e gjimnazit ishte një sihariq për Dibrën, sidomos për ata nxënës që nuk kishin mundësi financiare të shkolloheshin jashtë qyetit. Këtu Prof. Hysa dha një kontribut shembullor se si duhet të punojë një pedagog kur ka vullnet të ligjërojë edhe lëndët jashtë specializimit. Gjenerata jonë, po edhe ato pas nesh, në mungesë të profesorëve për disa lëndë si histori, psikologji, logjikë, rendin shtetëror etj., ai i ligjëronte shkëlqyeshëm, sepse edhe i tillë ka qenë gjatë gjithë shkollimit. Ai shpesh na thoshte se për këto lëndë unë përgatitem një ditë më parë sikur të jem para profesorëve. Kjo na jepte vullnet. Dhe ne, të gjeneratës së parë, me plotë bindje themi se çdonjëri të ishte regjistruar në akademi apo fakultet për gjuhë dhe letërsi, të gjithë do të kishin suksese...

Prof. Hysa nxori gjenerata e gjenerata, të cilat dhanë dritë për kombin, që aq i mungonin. Por rezultatet e profesorit janë edhe në veprat studimore që arrijnë mbi 25, përmbledhje të veprave të shkrimtarëve shqiptarë dhe botërorë . Shkrimet e tij shkencore janë me qindra e qindra të shpërndara nëpër gazeta e revista. Jetonte me letërsinë dhe për letërsinë, duke kontribuar në mënyrë dinjitoze me një stil të veçantë. Ka marrë pjesë në shumë simpoziume. Si profesor në Prishtinë në vitin 1990 u kyç në aksionin për pajtimin e gjaqeve, që i printe Profesori i nderuar i folklorit Anton Çeta. Sukseset nuk munguan edhe pse policia serbe i përcillte në çdo hap. Në një rast, në bisedë me shkrimtarin e madh Ibrahim Kadriu ndër të tjera do të shprehet: "...Kemi marrë pjesë në pajtimin e gjaqeve në Krushë të Madhe, në Drenicë, në Rugovë, Rahovec e shumë vende të tjera, por si pajtimtar i gjaqeve kam qenë në Smirë të Vitisë, ku i pajtova mbi 20 gjaqe... Mbajta fjalimin qendror dhe e kreva pajtimin."

Veprimtaria letrare e Prof. Hysës është shumë dimensionale. Ka shkruar për ngjarjet e realitetit politik në Kosovë e Maqedoni. Librat me tema të tilla janë: "Prokrusti modern", "Orët e liga" dhe "Një Kosovë e Vogël në Dibër të Madhe", i cili është si dokument i vetëm i rëndësishëm për shqiptarë të Kosovës në pranverë në vitit 1999.

Prof. Hysa sa herë takoheshim më pyeste për dibranët në Amerikë . Edhe ai ka njerëzit e vet atje. Miq, fëmijë të Nehatit, Atliut, Edipit, me qindra nxënës. I dhimben dibranët në Amerikë, në vendlindjen e re. Sa herë ka shkruar për shqiptarë e Amerikës me theks për dibranët. I dhimbeshte Dibra, Dibra e Madhe që zvogëlohej vazhdimisht, por e mbante shpresa se një ditë ky trend do të ndalet. Megjithatë, në një shkrim për gazetën "Fakti", që shtypeshte dikur, do të shprehet: "Ka jo me qindra, por me mijëra njerëz në Dibër, por jo vetëm në Dibër edhe në viset tjera te banuara me shqiptarë që jetojnë në shtëpinë e vet si në shtëpinë e huaj, shtëpi vetëm për pleq e plaka apo shtëpi vetëm për minj..." New Yorku ka dibranë sa dy Dibra... Të jesh larg Dibrës përmallohesh, të shkosh në Dibër pezmatohesh..." Ka të drejtë Profesori. Unë këtë e ndjej në lëkurën time, sepse me një përllogaritje, atje më dalin më shumë se sa në Dibër vëlla, fëmijë, nipër, mbesa, kushërinj etj., janë me qindra e qindra, të shpërndarë në New York, Conektiukum dhe New Jersi.

Në një bisedë rasti me z.Ruzhdi Lata, shokun dhe mikun më të ngushtë, recensent dhe redaktor i disa librave shkencorë të Prof. Hysës, u pajtuam se profesori ka pasur (singotme) parandjenjë për jetën e tij. Unë ia kujtoj rastin e vdekjes të Prof. Eminit. Në fjalën mortore me rastin e vdekjes së Prof. Emin Pustinës, që e kishte titulluar "Lamtumira e enciklobedistit të njohur kombëtar" në pesë faqe përfundon: "Dhe ne shokët, dashamirët, bashkëpunëtorët, bashkëqytetarët, mësuesët, arsimdashësit, kemi pasur një goditje të rëndë, një shok, një sulm, pse sot duhet të ndahemi nga një njeri, i cili më shumë vepronte, mendonte dhe krijonte se sa fliste". Pushon për disa sekonda. I përlotur heq fletët nga duart. Duke soditur dheun mbi varr shpërthen: "Shok-vëlla Emin, tani e kam radhën unë, se kam mbetur i vetëm nga gjenerata jonë. Heshtje varri siç thoshte Migjeni. Xhemati e shikonte i habitur... Ndoshta kishte një parandjenjë se po i "sosen" ditët, e pyes z.Latën që është edhe teolog, kryetar i Dibrës.

- Me të vërtetë e kam pasur mik dhe shok të mirë Prof. Hysën, - fillon rrëfimin z.Lata. Me Profesorin unë shpesh kështillohesha. Na lidhte interesi për të kaluarën, të tashmen dhe ardhmërinë e Dibrës në shumë lëmi, në veçanti arsimimi i dibranëve. Prof.Hysa ishte i prerë. Ai që nuk shkollohet, nuk është dibran. Ai duhet të trajtohet si mësues i madh i Dibrës dhe i gjithë trojeve shqiptare. Pasuria më e madhe e Prof.Mahmudit ishte libri, studimi dhe shkrimi me vepra shkencore. Ishte vital dhe vitaliteti i tij u tregua me krijimtarinë studimore që nuk u ndal deri në ditët e fundit të jetës. Shkroi shumë vepra, të cilat më janë të njohura dhe gjenden nëpër të gjitha bibliotekat. Takimi i fundit është shumë interesant. Amanet ma la që të varroset në Dibër, sepse pa Dibrën, ai nuk jetonte. Kjo ishte ditë e diell, pesë ditë para se të largohet nga kjo jetë. Atë ditë m'i kishte sjellë të gjitha librat që i kishte botuar, bashkë me disa artikuj që i kishte botuar nëpër gazeta dhe revista të ndryshme. Të njëjtën ditë pasdite më sugjeron të shëtisim disa nga fshatrat e Dibrës. Nuk ia prisha. Hypëm në makinë dhe ia filluam nga fshati Krifcë që ka mbetur me një shtëpi, në Hame me tre kryefamiljarë, Banjisht, Bllatë, Spas, Sollokiç dhe Bohmovë. Në të kthyer vizitojmë bregun e liqenit dhe objektin e ri të gjimnazit, që është me të gjitha kushtet bashkëkohore të një shkolle të mesme. Zemra iu bë mal. Kujtonte vitet 1960/61, kur u hap gjimnazi,në Shkollën "Hoxhë Vogli"me bankat e filloristëve ku u jepte mësim gjeneratës të parë të gjimnazit. Krahasimi ishte si dita me natën. Vizituam edhe të gjitha lagjet ku ai e kishte për zemër të pijë ujë në çezmë në Budulecit. Edhe në këtë shëtitje foli për jetën e tij, sidomos për shkollimin në Tiranë, pastërtinë e gjuhës shqipe... Në postin që e kam si kryetar i komunës, kështilltar kryesor e kam pasur zotni Mahmudin. Kërkesat e tij, që të kemi një Dibër ndryshe, ishin shumë të mëdhaja, sepse e deshte qytetin të përparojë, të ketë punësime, të mos largohet rinia, sepse e ngritëm një Dibër në Amerikë. Thuajse binte në depresion kur përmendej emigrimi. U gëzoheshte punimeve në infrastrukturë në qytet. Personalisht jam krenar që Dr.Hysën e kam pasur shok dhe mik të mirë, sepse në shoqëri me të kam mbaruar një fakultet të dytë. Dhe mirë bëra që ia plotësova dëshirën e fundit për Dibrën, sepse ndoshta sikur e ndjente vdekjen se i është afruar, - përfundon z.Lata.

Edhe miku i ngushtë, shkrimtari Ibrahim Kadriu, në komemoracionin kushtuar Prof. Hysës foli gjerë e gjatë për krijimtarinë studimore, me qasje për letërsinë dhe përmendi se profesori ditën e vdekjes kishte bërë shëtitjen e fundit në sheshin e Prishtinës, të cilin e krahasonte me Tiranën, kryeqytet i Shqiptarëve. Kjo na shtyn të mendojmë se ai ka pasur një parandjenjë se do të largohet nga kjo botë pa bërë zhurmë.

Ndaj mund të themi se Prof. Hysa tashpërtash është i papërsëritshëm, emri i tij nuk do të harrohet sa të jetë jeta, njerëzit e tillë i ndriçojnë veprat, do të mallëngjehet Dibra e Madhe ku lindi dhe u rrit, do të mallëngjehen nxënësit e studentët ku ai shpërndau dijen. Do të mallëngjehemi të gjithë dhe përgjithmonë.

Në varrim e përcollën gati gjithë qyteti i Dibrës, miq, shokë , nxënës e studentë, thujase nga të gjitha trojet shqiptare si nga Shqipëria, Kosova, Maqedoni gjer edhe nga Presheva. U varros në lëndinën pranë shokëve të idealit si: Prof. Emin Pustina, Bardhyl Cami, Lutfi Marku etj.

Kortezhi ishte i gjatë, nga rruga e Peshkopisë gjer të çezma e varrezave, që përcilleshte nga një re e zezë nën qiell.

...është koha për t'u pajtuar...
KONTRIBUO PER GAZETEN
merr kopjen tende
email: rrugaearberit@gmail.com
vetëm 600 lekë në vit

Rruga e Arbërit nr. 137

Alfred Moisiu: Rifat Malaj, ishte dhe mbetet një model në sjellje, kulturë, një mik i familjes.

profil

Ushtaraku dhe intelektuali i gjurmëve të fisnikërisë

Nga **Mevlud BUCI**

Kur mëson gjurmët e një ushtaraku, apo intelektuali, duket sikur je përpara një kurore luleshumë, përpara një bukurie a pasurie të çmuar. E kjo pasuri janë gjurmët... Vetëm gjurmët, dëshmi e djersës, përkushtimit e humanizmit, vetëm gjurmët e korrektësisë, urtësisë e paqëtimit, e lartësojnë njeriun dhe bëjnë që të rrezatojë fisnikëria.

Kështu të ndodh kur mëson për birin e Lisit të Matit të barotit, major Rifat Haziz Malajn. Kisha dëgjuar për këtë ushtarak dhe intelektual, më kishin folur me gjuhën e shpirtit ushtarakë lisdanë e intelektualë. Dhe prej kohësh mbaj peng se si të gdhend, qoftë dhe pak radhë. Shembulli dhe vepra e njerëzve të mirë, të zot e vitalë si Rifat Malaj, nuk mund të skaliten me një shkrim modest si ky, sepse mund e duhet të shkruhen monografi, poema, esse, e pse jo, triologji jete. Sepse këto u bëjnë nder brezave që do të vijnë, se këto dëshmojnë e lartësojnë vlerat e një treve, vlerat e çmuara të kombit.

-Është intelektual i rrallë, i përkushtuar, ushtarak i përvojave, i thjeshtë dhe i talentuar, dashamirë për njerëzit, i lidhur ngushtë me familjen, shoqërinë, miqësinë e kohën. Shok me virtyte, me prova pune e guximi, me fëmijë të kulturuar, me dashuri e krenari të zjarrtë për traditat, ushtrinë ku shërbeu dhe Lisin që e lindi dhe e burrëroi, -thotë biri i Shkallës së Xibrit, mjeku Kurt Kurti.

Emri dhe puna, shembulli dhe drejtësia, guximi dhe maturia e Rifat Malajt janë shkruar në sytë dhe zemrat e kolegëve, në frontet ku ai ka shërbyer. Ata dëshmojnë dritën e fisnikërisë.

* * *

Rifat Haziz Malaj u lind më 14.09.1950 në fshatin Lis të Matit. U rrit dhe u edukua nga një familje e urtë, bujare e punëtore, me plot vështirësi ekonomike. Të parët e familjes Malaj, gjyshi dhe stërgjyshi, emigruan në Turqi për çështje ekonomike, me të cilët lidhja nuk u arrit.

Familja në Lis iu kushtua bujqësisë e blegtorisë, gjithnjë e vlerësuar për mikpritje dhe urtësi, për vlera të çmuara nga rrethi shoqëror e miqësor. Haziz Malaj, së bashku me bashkëshorten, Shyqyrie Malaj



Rifat H. Malaj

(Ballabani), rritën dhe edukuan 10 fëmijë, 6 djem e 4 vajza. Që të gjithë jetojnë, të martuar e me fëmijë. Rifatin, djali më i madh, me interesim të familjes e për zgjuarsinë që kishte, më 1964 e dërgojnë në gjimnazin e Burrelit e më pas në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve, dega e kimisë.

Rifat Malaj ishte ndër më të dalluarit në mësime. Më 1970 fillon detyrën oficer aktiv në Burrel, komandant toge, deri shef kimie në brigatë e divizion. Ushtarak i kudondodhur, pranë ushtarëve, pranë llogoreve, në ballë të oficerëve, gjithnjë i palodhur, studiues, organizator e komunikues i rrallë, njohës i mirë i profesionit, i terrenit dhe i traditave.

Përkrah e në ballë të shokëve u rrit emri i Rifat Malajt. Në vitin 1996 doli në reform me gradën major. Gjurmët e shkollimit e të punës, të provave prej ushtaraku të denjë, flasin shumë, rrezatojnë fisnikëri e dritësim të vlerave njerëzore dhe intelektuale.



Me nipër e mbesa

Ushtarak e prind shembullor, gjithnjë i thjeshtë e virtuoz, i dashur dhe i prerë aty ku e do puna dhe drejtësia. Ka tre fëmijë si yje, siç i thonë fjalës, secili i dalluar dhe i përkushtuar. Jo më kot në lagje e më gjërë të thonë: "Si fëmijtë e Rifat Malajt! Lum Rifati që ka pozitën dhe pasurinë më të çmuar, fëmijtë e kulturuar e të zgjuar!" Dhe vërtetë fëmijët janë e mbeten pasuria më e madhe, pozita më e lartë, sepse ata lartësojnë prindërit, veten dhe kohën.

* * *

Ushtarak e prind shembullor, gjithnjë i thjeshtë e virtuoz, i dashur dhe i prerë aty ku e do puna dhe drejtësia. Ka tre fëmijë si yje, siç i thonë fjalës, secili i dalluar dhe i përkushtuar. Jo më kot në lagje e më gjërë të thonë: "Si fëmijtë e Rifat Malajt! Lum Rifati që ka pozitën dhe pasurinë më të çmuar, fëmijtë e kulturuar e të zgjuar!" Dhe vërtetë fëmijët janë e mbeten pasuria më e madhe, pozita më e lartë, sepse ata lartësojnë prindërit, veten dhe kohën.

Së bashku me Jetën, mësuese e nderuar, bijë e mësuesit Abaz Fizmani të Suçit, rritën dhe edukuan tre fëmijë. Vajza Albana ka mbaruar Fakultetin e Histori-Gjeografisë. Në vitin 1999 filloi mësimdhënien në shkollën e Komësisë, ku është dalluar në edukimin e nxënësve. Djali i madh, Agroni, është me akademi ushtarake dhe akademi sportive. U caktua oficer në Gardën e Republikës deri në vitin 2013. I shquar për pasion e sedër, korrektësi e përgatitje për komandim dhe operativitet.

Kreu dhe specializime në Egjipt, Itali dhe Turqi. Nga viti 2013 e në vazhdim kryen detyrën e drejtuesit të OSHE-së për pesë rrethe, me qendër në Burrel. Shembulli dhe shpirti krijues, takti e lidhja me njerëzit, kanë bërë që ai të dallohet dhe si kryetar i PS-së Mat e koordinator politik për njësitë qeverisëse Mat e Klos. Me pasionin prej intelektuali të vendosur ka përfunduar studimet e larta në Fakultetin e Drejtësisë dhe Master Shkencor për Marrëshënie Ndërkombëtare.

-Agron Malaj, -thotë specialisti i nderuar i elektrikut në Dibër, Jashar Uka i Luznisë, -është kuadër i kohës, i prerë, i duruar dhe mjaft korrekt, modeli i drejtimit, shembëllimi i korrektësisë së fjalës, i punëve të realizuara.

Së bashku me bashkëshorte Aldën, e familjes së Kujtim Gjokës, kanë tre fëmijë: Melisën, Enesin dhe Inën. Tek Agron Malaj i Matit zë vend shprehja: "Bëm baba, të të ngjaj". Ai i ngjan të atit, Rifatit, por dhe kohës e dajave. Tek ai rrezatojnë fjala e shembulli, shkenca dhe tradita, kultura e lartë, kërkesa e llogarisë, durimi dhe rreptësia. Ndaj dhe dallohet në krye të punëve.

Fëmija i tretë i Rifatit është Fatosi, i cili ka përfunduar Fakultetin Ekonomik për administrim biznes në Tiranë. Është administrator i kompanisë "Global, Siguri, Grup", që merret me aktivitet ndërtimi e tregëti gazi, intelektual që mëson e vepron çdo ditë, kurdoherë në ballë të punëve, i thjeshtë e vetveprues, organizator e shpirtbeharë, duke rrezatuar kulturën e familjes, kulrurën e shkollimit.

* * *

- Njeriu, -thotë filozofi Sami Frashëri, -nuk është i përjetshëm, ndaj le të përpiqet të jetë e palodhshme ajo që do të thotë dhe ajo që do të bëjë.

Rifat Malaj ka një jetë epopè për diturinë në frontin e ushtrisë, një jetë epopè e plot frute në edukimine fëmijëve, ka prova jete e nderim për shokët e miqtë. Kujtimet e major Rifatit shpërfaqin plot emra, ngjarje, episode, moment, prova, shembëllim prej intelektuali të shquar e lisdan i nderuar, prova shembulli e fjale, prova guximi. Lum kush mbart në shpirt e jetë dashurinë dhe nderimin për shokët, miqtë, për gjurmët e jetës, gjurmët e mirësisë. E Rifat Malaj kujton me krenari shokët e llogoreve, ushtarakët e nderuar që nuk jetojnë më: Binak Kërtoçi, Agim Likmeta, Nazif Barhani, Allaman Hystuna, kuadrot gjurmëlënës Muharrem Muça, Gani Elezi, Hysni Gegolli, Kadri Domi, Sefer Duka, Agim Gjyla, Hidër Kola, Besim Gjika, Shefqet Hysa, Xhemal Gjunkshi, Dan Dedja e plot të tjerë. Të paharruar mbeten dhe shokët e gjimnazit, të cilët Rifati i kujton me krenari, si Qemal Lena, Bajram Barlika, Kurt Kurti, Halil Peci, Hajdar Cakoni, Fiqiri Bushi, Filloreta Zervoi, Selim Demiri, Aleksandër Shalësi, Bardhyl Kondi e të tjerë.

Çdo emër ka një histori, një kujtesë, rrezaton dritë e mirësi te Rifat Malaj. Vërtetë shokët e miqtë janë drita e jetës, janë si vetë krahët e shqipes, janë pasqyra njerëzore, e cila gdhend provat, djersën, shpirtin, diturinë. Janë ata që të çmojnë e lartësojnë më fort edhe se diplomat.

-Rifat Malaj, -shprehet kryetari i Klubit të Shkrimtarëve dhe Artistëve "Pjetër Budi", kryeredaktor i gazetës "Mati", poeti Hamdi Hysuka, -është ushtarak i provave të drejtësisë e guximit. Ai ka udhëhequr, ka vepruar e gjithnjë ka ndihmuar, ka mbrojtur të vërtetën. Me sinqeritet e drejtësi mbrojti të vërtetën për gjeneral Alfred Moisiun kur erdhi me dënim në garnizonin ushtarak të Burrelit.

Dhe Alfred Moisiu, ky gen i atdhetarisë shqiptare, gen i ushtrisë çlirimtare, nuk e harroi guximin e nderimin e Rifat Malajt. Lum kush ndan drejt, lum kush vepro për drejtësi!

-Alfred Moisiu, -thotë diku në kujtime Rifat Malaj, -ishte dhe mbetet një model në sjellje, kulturë, një mik i familjes. Mirësia shprehet me mirësi. Këtu i ka rrënjët e drejta, e vërteta, rrezatimi i fisnikërisë. Rifat Malajn e gëzojnë e krenojnë edhe gjashtë nipër e mbesa, dashuria për vendlindjen, Lisin, atje ku tek ish-kulla do të ndërtojë përsëri shtëpinë, atje ku flakëron zjarri i mallit për brezat, për traditat, fisin e lisdanët e nderuar. E thonë faktet, provat, puna, se Rifat Malaj është ushtaraku dhe intelektuali i gjurmëve të fisnikërisë.

SHABAN DERVISHI, një jetë me krenari dhe dinjitet

Nga **Faik XHANI**



Shaban Dervishi doli në pension i nderuar dhe i qetë. Edhe gjatë kësaj periudhe nuk u mbyll brenda mureve të shtëpisë. Ishte mësuar të rrinte me burra dhe me burra u mor. U anëtarsua që në themelim në Shoqatën "Bashkimi i Përgjithshëm i Pensionistëve të Shqipërisë"

Më 31 korrik 2017 pushoi së rrahuri zemra e Kryetarit të Nderit të Shoqatës "Bashkimi i Pergjithshëm i Pensionistëve të Shqipërisë" Shaban Dervishit.

Shaban Elez Dervishi lindi më 2 tetor 1936 në Lugjej (Dardhë) të Dibrës. Rrjedh nga një famije me tradita patriotike dhe bujarie.

Babai i tij, Elezi, kryesisht u mor me blegtori. Ai gjatë Luftës Nacionalçlirimitare u lidh me lëvizjen dhe ndihmoi me sa mundi për çlirimin e atdheut. Kryesish u njoh dhe ndihmoi komandantin e Çetës së Dibrës, Haxhi Lleshin dhe Gaforr Korçën etj., të cilët jo vetëm s'e harruan, por edhe e ndihmuan gjatë rrugëtimit jetik të tij dhe kryesisht Shabanin.

Shabani kreu mësimet e para në vendlindje, pastaj një shkollë profesionale 1 vjeçare për kohën dhe fitoi profesionin e karpentierit, me vonë kursin e kuadrove dhe atë tremujor të Partisë.

Që në moshë të re mori rrugën e kurbetit dhe punoi si shërbyes në familjet e mëdha tiranase, thuajse për kafshatën e bukës. Veçanërisht shkolla profesionale i dha mundësi për t'u punësuar dhe për të shpalosur aftësitë e tij profesionale, organizuese e formuese.

Fillimisht punoi në Ndërmarrjen e Përpunim Drurit në Peshkopi, më pas në Ndërmarrjen Bujqësore Kamëz. Atje -ish drejtori, Gafurr Korça, një kuadër me emër dhe i përkushtuar, e ndihmoi jo vetëm për të punuar, por edhe per t'u bërë një veprimtar i dalluar.

Në vitet 1955-1957 u mobilizua ushtar. Nga viti 1957-1959 punoi në Përpunim Druri, pastaj 4 vjet magazinier në tregti.

Për 9 vjet drejtues lokal, sekretar e kryetar lokaliteti, ku punoi me ndërgjegje e përkushtim, duke gëzuar simpatinë dhe respektin e komunitetit.

Lidhi jetën me Amedije Ferrën nga Blliçja e Dibrës, me të cilën lindën, rritën dhe edukuan 5 fëmijë, secili më i mirë e më i zot se tjetri; tre djem: Besniku, Dëfrimi e Vladimiri dhe vajzat Flora e Drita.

Në vitet 1973-1975 Shaban Dervishi mori drejtimin e kooperativës bujqësore të Zall-Dardhës, një nga kooperativat më me probleme. Por Shaban Dervishi, i ndërgjegjshëm, inciator e organizator, u bëri ballë më së miri atyre vështirësive, duke e çuar vlerën e ditës së punës nga 1.8 lekë në 8-10 lekë.

Në rrugëtimin e tij jetik kaloi një kalvar të vështirë në sajë të cmirës e të thashethemeve. Viti 1975 rezultoi fatal për Shaban Dervishin. Ai, padrejtësisht, përjashtohet nga partia. Lirohet dhe nga detyra e kryetarit të kooperativës. U ndëshkua rëndë, por nuk u dorëzua. Ishte i sinqertë dhe i pastër, prandaj qëndroi i vendosur në kërkesat e tij për t'u rehabilituar.

Pas disa peripecish nuk u kthye në parti, por në punë. Nuk pranoi të marrë përgjegjësi.

Të gjithë ata që e ndëshkuan, u penduan për çfarë i kishte ndodhur Shaban Dervishit, por nuk mundën t'i jepnin atë që meritonte. I dhanë të drejtën e punës deri në përgjegjës sektori, por ai nuk e pranoi.

Luftoi me të gjitha padrejtësitë, duke fituar dinjitetin e nëpërkëmbur dhe fitoi. Nuk mori detyra me përgjegjësi, por punoi kryesisht magazinier, duke qenë vazhdimisht i pastër dhe menaxher i talentuar, pa i lëvizuar asnjë qindarkë gjatë gjithë kohës që punoi me vlera materiale.

Veçanërisht tranzicioni e vuri në provë të vështirë. Ai nuk u tjetërsua, nuk pranoi detyra në këmbim të dinjitetit.

Veçanërisht iu besua administrimi i magazinës së furnizimit me drithërat e bukës të Shqipërisë së Veriut në Stacionin e Trenit Milot, në periudhën më të vështirë 1990-1994. Dhe Shaban Dervishit, edhe pse plumbat i vërtiteshin orë e sekond nga trupi, nuk u përkul, qëndroi burrëror, trim, iniciator, i përkushtuar e i devotshëm, derisa në fundin e vitit 1994 e mbylli karrierën e tij të punës si më i miri, me faqe të bardhë.

Doli në pension i nderuar dhe i qetë. Edhe gjatë kësaj periudhe nuk u mbyll brenda mureve të shtëpisë. Ishte mësuar të rrinte me burra dhe me burra u mor. U anëtarsua që në themelim në Shoqatën "Bashkimi i Përgjithshëm i Pensionistëve të Shqipërisë".

E filloi që kur ishtë kryetar Prof. Hasan Banja e deri para pak kohësh kur u sëmur. I kaloi të gjitha shkallët, nga anëtar i thjeshtë, anëtar kryesie, sekretar i përgjithshëm dhe për disa vite kryetar i "BPPSH", gjithmonë i papërtuar, i ndërgjegjshëm e i përkushtuar. Kryesia e përgjithshme e ka shpallur "Kryetar Nderi" të Shoqatës "BPPSH" dhe të tillë do ta kemi gjithmonë.

Shaban Dervishi qe një kuadër i devotshëm, një veprimtar shembullor, një familjar i rregullt, një qytetar i civilizuar e një prind shembullor, që do na mungojë përgjithmonë.

Ngushëllime familjes, që aq shumë e deshën e bënë për të.

I paharruar kujtimi dhe ndihmesa e Kryetarit të Nderit të Shoqatës BPPSH!

Rifat Asllan Vrenezi, njeriu i sakrificave

Nga **Dilaver MURRA**



Të gjitha shkollat i ka përfunduar rme rezultate të shkëlqyera. Mbas kthimit në Shqipëri është emëruar si oficer në funksione të ndryshme në repartet e aviacionit ushtarak, në fillim në qytetin "Stalin", më vonë sipas nevojës dhe kohës të mbarimit të shkollave si shef stërvitje me komandën e aviacionit në Rinas, si zëvendës komandant për degën mësimore në Akademinë Ushtarake "Mehmet Shehu" në Tiranë.

Rifat Asllan Vrenezi u lind në fshatin Staravec të Peshkopisë në një familje atdhetare të lidhur me Luftën Nacionalçlirimtare. Pas çlirimit të vendit ai mbaroi në Peshkopi në shkollën fillore dhe shkollën 7-vjeçare në Tiranë. Si kudo, edhe rinia e Staravecit u inkuadrua me gjithë popullin në punë për ndërtimin dhe rindërtimin e vendit në bujqësi, për pjesëmarrje në aksione dhe punë vullnetare.

Rifati u zgjodh sekretar i organizatës së rinisë dhe bashkë me shokët e organizatës shkoi vullnetar në Minierën e Kromit të Bulqizës, ku punoi 3 muaj dhe u kthye me fletë nderi dhe me stimulim sulmues.

Pas shkollës 7-vjeçare mbaroi shkollën e mesme ushtarake "Skënderbej". Rifati pas shkollës së mesme ushtarake "Skënderbej" shkoi për studime në Moskë në shkollën e nivelit të lartë të aviacionit, vazhdoi akademinë ushtarake "Zhukov" të aviacionit, ku vazhdoi 3 vjet, dhe kur u prishën marrëdhëniet e shtetërore me BRSS u kthye në atdhe. Të gjitha shkollat i ka përfunduar rme rezultate të shkëlqyera. Mbas kthimit në Shqipëri është emëruar si oficer në funksione të ndryshme në repartet e aviacionit ushtarak, në fillim në qytetin "Stalin", më vonë sipas nevojës dhe kohës të mbarimit të shkollave si shef stërvitje me komandën e aviacionit në Rinas, si zëvendës komandant për degën mësimore në Akademinë Ushtarake "Mehmet Shehu" në Tiranë.

Rifati ka qenë një prind shembullor që ka ditur me bashkëshorten të edukojë 2 djem të mrekullueshëm, Edin dhe Mondin, të cilët kanë shërbyer me përkushtim në sektorë të ndryshëm të vendit.

Mbas daljes në pension u anëtarësua në Organizatën e Veteranëve të LANÇ në njësinë administrative nr. 8, zona nr. 8, duke qenë kryetar i këshillit zonal Nr. 8 të veteranëve, ka qenë i përkushtuar në zbatimin e detyrave, në mbrojtjen e vlerave të LANÇ, si dhe propagandimin e tyre në radhën e brezit të ri. Për kontributin e dhënë i është dhënë titulli i lartë: "Nderi i organizatës së Veteranëve të LANÇ, nga Komiteti Kombëtar i Shqipërisë.

Për punë të mirë është dekoruar nga Presidiumi i Kuvendit Popullor me disa medalje dhe urdhra.

U nda nga jeta më 19.09.2017 dhe u përcoll në banesën e fundit me të gjitha nderimet.

Dëshironi të BOTONI PAK KOPJE

LIBRI, por nuk mundeni sepse shtypshkronjat ju kërkojnë të paguani për një tirazh të madh...
Tani nuk është nevoja të prisni...

JU OFROJMË BOTIME NGA 1 KOPJE E VETME!

Njëlloj si në shtypshkronjë... Çmime të favorshme dhe shpejtësi!
Telefono: **068 65 08 441** ose shkruaj email: **mbbotime@gmail.com**

Bashkia Dibër, Drejtoria e Bujqësisë dhe ALCDF
në kuadër të Projektit
"DIBRA: TURIZËM DHE TRADITË"
organizojnë
"Festa e të Vjelave 2017"

Panair i produkteve tipike dibrane!
7 tetor 2017
Bulevardi "Elez Isufi", Peshkopi

Veprimtaria realizohet në bashkëpunim me CNVP, Agritra Vizion dhe World Vision.

Jeni të mirëpritur të festojmë së bashku!







USAID FROM THE AMERICAN PEOPLE
SWEDEN
ALBANIAN LOCAL CAPACITY DEVELOPMENT FOUNDATION
World Vision
CONNECTING NATURAL VALUES & PEOPLE

cyan magenta yelloë black